

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XVIII

R.

radhë f. «rresht, rend; rresht i shkruar a i shtypur; kategori njerëzish, klasë shoqërore, *s'është i radhës sonë*; në Kalabri *aradhë*, më fort për rresht ushtrie; *radhó*, *radhít*, *radhós* «vë (në) radhë». Nga gr. e re *ῥάδα*, *ἀράδα*, G. Meyer EW 360, AS IV 19 e NS/IV/13, Weigand 73. Fjala greke pas G. Meyerit nga lat. **radia* f. «rreze» (në vend të *radius*), pas Hatzidakit nga *οὐράδα*: *οὐρά* «bisht», pas Pernot-it nga ven. *arada* «grumbull drithë në lëmë», sh. Andriotis 21.

Fjalë e Shqipërisë jugore e të mesme (dñe e *ῥαδία* në Gregisë e t'Italisë), e cila nga dialektore që ishte është bërë e mbarë gjuhës. Vajpërdorimet e saj sh. sidomos Pedersenin f. 182 e FGS. Huazim relativisht i ri, mungon tek autorët e vjetër të Veriut. Duket të ketë hyrë sëpari si term ushtarak me kuptimin e arbërishtes së Italisë; me këtë kuptim, si *aradhe* «radhë ushtrie», është rimarrë e përgjithësuar në gjuhën letrare. Nga *radhë* është formuar *radhaník* m. «një farë byreku, i cili kripet përsipër me sheqer dhe hahet si ëmbëlsirë» (FGS), me sufiks *-ník*, i shpeshtë sidomos në emra petësh e ëmbëlsirash (sh. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 70). Poashtu popullore është edhe *radhúa* *radhói* m., pl. *radhónj* te Kristoforidhi «*τὰ πεζούλια τῶν πετρώδων ὀρέων*» te burimet që jep Manni dhe «grumbull gurësh» edhe «radhë», në gjuhën shkollore neologjizëm (sot i vjetëruar) për «defter, fletore»; formim me *-ua -ue*, për të cilën khs. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 96 v. Mbase të gurrës popullore janë edhe *radhas* e *rádhazi* «me radhë, pas radhës; hpush, zakonisht». Nga verbi *radhit*, sipas Kristoforidhit fjalë e ligjërimit të Përmetit, është formuar termi *radhitës* m. (më i rrallë *radhonjës*) i tipografisë. Për *ravë* «radhë» sh. te *ravë*. — Fjala greke nuk ka pasur fuqi rrezatimi të madhe. Ajo përveç se në shqipen ka hyrë vetëm dhe në aromunishten, si *aráδα* «ordre; file; couche; ligne, lettre», edhe si ndajfolje, «l'un après l'autre», Papahagi 126. Për këtë të fundit khs. shq. *radha*, në shprehje si *tri dit radha*; është një marrje drejtpërdrejt nga gr. *ἀράδα*, që përdoret me këtë formë dhe si ndajfolje. — Për fjalën greke etimologjia latine e G. Meyerit është më afër menç se gjithë të tjerat. Mjafton ta krahasojmë me frgj. *raie* «vizë, hulli, shtek i flokëve», e cila rrjedh edhe kjo prej lat. **radia* dhe piqet aq fort në kuptim me fjalën greke.

rangë f. «punë, punë shtëpie», *rangët e shpisë*. Mungon te G. Meyerit. Del që te Buzuku me kuptimet «nevojë; punë shtëpie; shkak», bashkë me verbin *rangëtonem*, «kujdesem»: *Zoti ynë ká rangë n sish* «Dominus his opus habet, il Signore ne ha bisogno»; *Aj qi anshtë lanë, s'ká rangë*

me u lām «Qui lotus est, non indiget ut lavet»; *Për të mitunë u fëdikshë, e pā ndonjë rangë, e për të mitunë u bdora fuqinë teme* «In vacuum laboravi, sine causa, et vane fortitudinem meam consumpsi»; *E Marta ish n̄xanë ndë shumë rangë* «Martha autem satagebat circa frequens ministerium, Marta intanto si affannava tra le molte faccende di casa»; *e tue mos u rangëtuom pr oratë të Tinëzot; e aj të mos rangëtonetë për ndonjë kafshë të këti shekulli* «et spoliis non indigebit» (LXIII/2, Mateu 21,3; LVII/2 = LXVII/2, Gjoni 13, 10; LXXXVI = LXXXXVI, Isaia 49,4; LXXXVIII/2 = LXXXXVIII/2, Luka 10,40; XXII b; LXXXVII/2 = LXXXVII/2, Libri i Proverbevet 31,11). Budi RR 40 *prāshtu tue ditunë se s ashtë aqë ndjerë nd anët ajo rang e madhe, s'desha këtu as me e vūm. . .*, pra me kuptimin «punë, çështje». Bogdani (II 39, 2; 49, 18; 61, 11; 73,7) *e silla punë atyne nukë epetë, tue e lypunë për këtë rangë e arrësye* «il che viene loro negato cercandolo precisamente per questo fine»; *ndëshkoj dhandërrinë për se kishte mbluem venën' e mirë, mbas gjithë rangësh, e gazëmendesh* «riprese il sposo, perché havea servato il vino dopo tutta la funzione, e allegrezze»; *të sijtë n̄xanë ndë rangë të kësaj jete* «li quali occupati da negotij mondani»; *kujtoj se ranga e tī ishte me grishm të ndaleshinë* «penso esser sua incombenza di doverli invitare a continuare nel dimorare». Nga burimet e reja, Junggu 196 ka *rang-a* «incombenza», *Bashkimi rangë* «affare, incombenza», *Buseti për* «affare, faccenda, incombenza», *Cordignano rangë f. e rang m.* për «affare, compito, incombenza», *e rangët e shtëpisë* «faccende domestiche, occupazioni domestiche». Kuptime të afra dhe te Godini, Leotti e te fjalori dorëshkrim i Xanonit. Rrota HD I 43 *sa rangë e punë*, Nikaj (Shkodra e rrethume 1961 f. 25) *s'mendonte rangë tjetër, veçse me mbushë fyshekët*, Kurti I² 102 *për rangë të shpīs, në një vajtim për një grua prej Reçi* (Folklori III, 1940, f. 62) *I kjan rangë edhe i kjan punë*. Shumësi i mashk. *rang* është *rangje*, te Logoreci *rrangjet e shtëpis*; me gjith' atë ky emër te Buzuku (e te të tjerët autorë të Veriut) është *rangë*, prandaj dhe shumësi jo *rangjetë* (Mann), po *rangëtë*. Neologjizëm është *rangtore f.* «punishte» te Cordignano² «officina», te Fishta (Mrizi i Zanavet 1924 f. 53) *Rangtore inzhenjerit*.

Për historinë e fjalës ka rëndësi që kjo është edhe e toskërishtes, pra e mbarë gjuhës. Kështu Kolea në fjalorin dorëshkrim frengjisht-shqip ka *rangë rëngë* «besogne» e *rëngë* «affaire, occupation», e cila është trajta toske e fjalës. Kështu edhe verbit geg. *me rangue* «me bâ rangët, it. accudire agli affari, thanë për rangë të shtëpisë» te Gazulli, në Curraj Epër pas Q. Haxhihasanit *As kurr baçicat ndër ju mos rangoshin* me kuptimin e «rregulloj punët e stanit», për punët shtëpiake të gruas edhe në Malsi të Gjakovës — i përgjigjet prej Toskërie *Njeriu është i shtrënguar që të punojë, që të rëngojë, që të rëndojë dhe të përpiqet* (Dielli 25.VII.1916, f. i shtylla 2), trajta e pazgjeruar *Nuk duhet rëngeni* «të mundoheni». Emri *rëngë*, i cili i përgjigjet *rangë-s* së gegërishtes, na del në arbërishten e Siqelisë (Piana dei Greci) me kuptimin «pena, mundim, brengë, gajle» te Skirò Ca. trad. 389. Në toskërishten, *rëngo* mund të jetë zhdukur nga puna se përbën një farë homonimie e njëkohësisht dhe sinonimie me *rëndo*. I të dyja dialekteve është edhe një tjetër kuptim i kësaj fjale, ai i së rrafshëtës: *Bashkimi me rangsue* «livellare», me neologjizmat *rangsí f.* e *rangsím m.* «livellamento», poashtu edhe Elçija V 52, *Buseti s.v.*, Godini te *ebnen*, Lako Bimët e këqia 111 *rangsinë* «à niveau», tosk. (Pogradeci) *Pashaj kish hambaret rëngë me grurë e thekër e ndonjë kamës që i ka qypet rëngë* (Kuteli, Xinxifilua 110, 213). Nga këto shëmbëlla shihet se dy

kuptimet kryesore të fjalës janë «punë» e «rrafshim». Kuptimi i kujdesit e i shkakut (te Buzuku) rrjedh nga ai i punës, khs. përdorimin e *punë-s* për «shkak». Duke u nisur nga «mundim» si kuptim bazë, mund të mendohet një burim i vjetër nga italishtja; khs. më një anë *rángola* «affanno nel respirare; preoccupazione, sollecitudine» *arrangolare* «darsi fatica e pena, affannarsi, arrovellarsi», më anë tjetër reflekset e lat. *rancor*, si lomb. *rangōn* «ankim» etj. te Meyer-Lübke REW 7041. Për zhvillimin kuptimor nga «mundim» në «punë» khs. grupin e it. *travaglio* frgj. *travail*, e rum. *muncă* «punë» nga sllav. e vj. *mōka* «mundim», nga shqipja vetë fjalën *punë*, ku jepen dhe shembëlla të tjera.

rasë f. «rast; ngjarje e veçantë e një lloji të caktuar: *tri rasa tifoje*; si term gramatikor «casus». Mungon te G. Meyeri. Në thelb është një me *rast* nga turq. *rast* «rencontre, réussite, chance», po nga variantja pa *-t* e kësaj, si te *rasgele rastgele* «gand, rastësisht». Si e tillë del sëpari te Junggu: *ras-a* «occasione, destro». Termi gramatikor *rasë*, bashkë me kuptimin e «casus» si te *tri rasa tifoje*, në *çdo rasë*, janë formuar pas it. *caso*, frgj. *cas*, gjerm. *Fall*. Aty ka një lloj përkthimi, duke u mbështetur fjala (gjoja) te verbi *me ra*, ashtu si *caso cas* në fund lidhen me *cadere*, e *Fall* me *fallen*. Ky kuptim i fjalës u formua prej klerit të Shkodrës, në kohën pas G. Meyerit e Junggut. Kështu Bashkimi është i pari që jep *rasë* «caso, occasione».

rashë f., një petk grash, në Malsi të Madhe me Kelmend, shqiptohet *rash-a*. Në Shkrel është një xhubletë me rrathë të bardhë që veshin vajzat, në Kelmend një fund që lidhet në brez me pulla a me lastik, në Theth (J. Kastrati) «havër gjysë, fund». Në Rrilë të Bregmatës, ngulim që e ka burimin në Kelmend, pas Q. Haxhihasanit «linjë e bardhë që veshin gratë nën xhubletë». Logoreci «këmishë e mëndafshtë», Cordignano «camicia di seta che si dà alle donne quando si maritano». Një nga ato fjalë për të cilat nuk mund të ndahet në mënyrë të prerë nëse rrjedhin prej latinishtes a prej italishtes, sh. dhe Rev. de Ling. VII 1 175 vv. Khs. më një anë lat. *rasum* «lloj atlas», e cila ka shkuar edhe në greq. të re (**ράσων** «serge, froc, haire», G. Meyer NS III 55, Triandaphyllidis 122 e 125, Andriotis 213); më anë tjetër it. *rascia* «lloj cohe», bergell. (Grizonët, Zvicër) «petk grarisht». Që të dyja fjalët i përgjigjen asaj së shqipes. Po përhapja gjeografike e kufizuar e më anë tjetër dhe trajta femërore e fjalës janë kritere që flasin më fort për një huazim më të ri, prej italishtes. Në atë drejtim dëshmon edhe fakti që kemi të bëjmë më fort me një fjalë të modës së grave. — Trajta *rasë* «sottana, tonaca, gabbiano, zimarra de'preti» e Leottit, te Lambertzi «Priesterrock», e cila duket të jetë e toskërishtes, vjen pas gjase prej gr. së re **ράσων**, Andej rrjedh dhe arom. *rasă* «soutane de prêtre», Papahagi 903 (rum. *rasa* «mantel i gjatë i priftit ortodoks» merret për fjalë sllave, DLRM 689), rus. bullg. serbokr. *rasa* etj., sh. G. Meyer NS III 55, Vasmer REW II 492. It. *rascia* te Meyer-Lübke REW 7071 e te Migliorini 461 merret si një fjalë me burim nga *Rasha*, emri mesjetar i Serbisë (në fillim i Sanxhakut të Novipazarit). Po m'anë tjetër gjerm. *Rasch* që ka një kuptim të afër, Kluge-Goetze 24,469 e bie të ardhur nga emri i qytetit Arras të Francës. Na duket e vështirë të ndahet it. *rascia* nga gjerm. *Rasch*, me gjithë se nga Arras spiegojnë një tjetër fjalë të italishtes, *arazzo* «gobelin», sh. Migliorini 35.

rashë, forma supletive e aoristit të verbit *bie*; participi geg. *rā*, *ranë*, *rām*, tosk *rarë*, *rënë*, e të dy dialekteve edhe *ratë*. G. Meyeri (f. 35, 361, 371 v., AS III 17, 65, 73) e lidh përbrenda shqipes me *rrah*, dhe — duke u

nisur sigurisht nga kuptimi që ka *i bie, i rashë* «rrah» — e afron më tej me sllav. e vj. kishtare *u-raziti* «percutere». Spiegim i kundërshtuar nga Pedersen f. 111, i cili nga ndërtimi sintaktik i *rashë* e i *rrah* pa se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Për këtë arsye Jokli (IF 43, 49 v.) jep një tjetër spiegim të *rashë*, duke e afruar këtë përbrenda shqipes me *resh* e me *dragë* 'ortek bore», e më tej me gr. ῥοοῦω «mësyj, derdhem, lëshohem» lat. *ruo* «i lëshohem, i bie përsipër; përmbys», irl. *ruathar* «sullem» etj. Mendim i pëlqyer te Tagliavini 240, kurse Vasmeri REW II 485 kombinon etimologjinë e G. Meyerit me të Joklit. Nga një bazë **enaksom* nisët për *rashë* Bariçi I 77, duke e përqasur këtë me gr. ἐνεγκειν «me bartë», sllav. e vj. kishtare *neso* «sjell, bie» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LVIII = LXVIII, Gjoni 18, 6; LXIV/2, Mateu 26,51) *u hoqnë përhapëtë e rënë për dhë* «abierunt retrorsum, et ceciderunt in terram»; *e tue rām sherbëtorit së krenëvet priftënet, i përeu një vesh* «et percutiens servum principis sacerdotum amputavit auriculam eius». Për përdorimin e saj sh. sidomos Pedersenin në vendin e cituar dhe FGS te *bie*. Karakteri i butë i *r*-së dëshmon që kjo në krye të herës nuk ka qenë nistore, sepse një *r* nistore rregullisht forcohet në shqipen. Për këtë arsye nuk qëndron afrimi me *rrah* e më tej me sllav. *u-raziti*. Për arsye fonetike të tjera nuk mund të mbahet as krahasimi me gr. ἐνεγκειν Spiegimi i Joklit nuk ka zënë vend nëpër fjalorët krahasimtarë. Me gjith' atë është fonetkisht pa të metë dhe i mundur edhe nga ana kuptimore. Po khs. dhe *rusem* e *ryj*.

ravë f. «rrugë dhish në mal, dhiare; gjurmë në borë». G. Meyeri 36 e jep, pas Rossit, si «gjurmë këmbësh», dhe e lë pa spieguar. Kundra afrimit me sllav. *noga* «këmbë» nga ana e Bariçit (I 78) sillet me të drejtë Vasmeri 54. Ai vetë e vendon fjalën te grupi sllav. e vj. kishtare *rovъ* «gropë, hendek» lat. *ruo* «gërmoj, rëmoj» etj., po jo pa vënë në pah vështirësinë fonetike të ruajtjes së *v*-së intervokalike te *ravë*; më vonë (REW II 525) ky dijetar nuk e përmend më fjalën e shqipes. Kundra spiegimit të tij Bariçi (Arhiv I 216) thekson pikërisht këtë vështirësi fonetike.

Fjalë e gegërishtes, ndihet më fort si *ravë* e si *rravë*. Bashkimi ka *rravë* «traccia attraverso la neve», Cordignano «traccia sulla neve, sentiero, vi, rrugë», Godini *ravë* e *rravë* «Fährte im Schnee, Schneespur». Fjal. shq.-serbokr. e ka për serbokr. *prtina, kolovoz, trap*: «rrugë e hapur nëpër borë», «rrugë qerresh, vrragë e qerres» e «gjurmë e rrotës së qerres». Në Mirditë pas ER (te Manni) deminutivi *rravëz* f. «hulli». Te Lambertzi edhe verbi *ravís*, në *ta ravisi rrén* «ta tregoi rrugën». Këto përdorime të fjalës përmbliidhen në kuptimin e përgjithshëm të një vije të gjatë e me një farë gjerësie, të një rrypi a rruvie. Një kuptim të tillë jep për *ravë* dhe Logoreci, «vi, vizë, shteg». Aty shpie dhe shprehja e Fishtës (Lah. e Malcís 412, Kënga XXV, Gjaku i marrun = HD XI 245) *Me do krye tanë rava rava Varrësh s'taganit*, ku fjala shënon mbresat -rruvi të taganit në krye. Në këto kushte *ravë* *rravë* shihet se është *varrë*, fjalë që përveç kuptimit të plagës ka dhe atë të një rrypi, dmth. të një vize të gjatë e me një farë gjerësie, të një cope të gjatë e të ngushtë, në Dibër *vara-vara* për një basmë a një stofë me vizatime rrypa-rrypa. Metateza te *ravë* *rravë* nga *varrë* ashtu si te *rruvi* nga *vërrí*; sh. këto fjalë, khs. edhe *vajzë*. Për identitetin e *ravë-s* me *varrë* dëshmon edhe kjo, që për vizën që lë rrota e qerres në rrugë, përveç *ravë-s*, pas Godinit (te *Wagenspur*) dhe

«shteg nëpër borë», *raja* e *feluskës* «shêj qi len feluska tue rrshqitë mbi ujna, it. scia della nave» e *rrajë* «ravë, shteg qi çilet nëpër borë, *me çilë rrajën*; vazhda qi lën landa e lisat e ngrehun rrëshqanë tue i ulë teposhtë, it. scia», në ato anë edhe *rrä-ja* (me e të hapët, khs. më sipër *ta ravisì rrën* të Lambertzit), Puka *rrae*, etj., në këto rrethana duhet të jenë sekundare, përfutuar më fort me rrugë analogjie; khs. *Dumbrë* nga sllav. *dobrava*, *postahë* nga *postava* etj., te Jokl IF 49, 278 e 288. Në thelb nuk ka gjë të bëjë me këtë *ravë* fjala *ravë* «radhë» e dialektit të Tiranës e të Pogradecit. Është një trajtë e *radhë-s*, me ndrimin e spirantit interdental në labiodentalin. — Prej *ravë-s* rrjedh pas gjase arom. *rauã* «shtek i bardhë që duket në kokë kur bien flokët», te Papahagi 128, 149 e 903 *rauã arauã* e *aroauã* «perçe, zullufe, boucle de cheveux près (de) l'oreille, côtelletes», pa etimologji. Spiegimi i kësaj prej lat. *rallus* «qethur rrafsh, pa qime» (për tunikën) nga ana e Puçcariut DR V 409 v. nuk është bindës, ate s'e përmënd as Papahagi. Fjala aromune me kuptimin e parë të saj në afrohet aq fort me shq. *ravë*, sa nuk mund të ndahet prej kësaj. Në aromunishten ka disa elemente të shqipes që i përkasin (o i afërohen më shumë) gegërishtes.]

ravgój, *rravgój* «shkoj andej-këtej, endem posht e lart». Fjalë e geg. veriore që s'e ka G. Meyeri. Logoreci *me ravgue* «me dalë jashtë rruget, me humbë udhën»; ai jep dhe një «iterativ» *me ravgarue*, të cilin e përmënd edhe Jokli Arch. Rom. XXIV 37, po që gjan të jetë një neologjizëm i Logorecit. E ka si *ravgój ravgój* edhe Manni. Fishta-Lacaj *aderro, -are*, «sillem, endem, ravgój». Lidhet në analizë të fundit me *ravë*, po me një rrugë tërthore. Rrjedh nga *ravgë* «rrugë malore për këmbësorë» që njihet për të folët e Dukagjinit. Kjo është një zgjerim me -gë i *ravë-s*. Khs. p.sh. *lëvozhgë* : *lëvore*, *plizhgë* : *plish*, *vozgë* : *vozë* te Xhuvani-Çabej Prapashtesat 46.]

razakí : *rrush razakí* «rrush kokërrgjatë, i kuq a i zi, e me cipë të trashë». Mungon te G. Meyeri, me gjithë se është fjalë e mbarë gjuhës. S.R. Dine 342 ka *razake* «një soj rush që quhen razake, që janë në shullë e i pjek dielli mirë» : *Me razake duke ngrënë*. Me të drejtë Manni 424 e cilëson shkurt si huazim turk. Vjen prej turq. *razakí* «specie di uva dagli acini lunghi e bianchi», kjo prej arab. *razzākī*. Fjala turke ka hyrë në rumanishten (*razachie*, Lokotsch 1715), në serbokroatishten (*razaklija* «roter Traminer» pas Vukës në Mal të Zi) e në greq. e re. Në shqipen fjala me rrugë të etimologjisë popullore u kryeqëzua me *zi*, duke dhënë me metatezë *ragazí*, në një këngë popullore prej Rrile në Breg të Matit *Ban rrush t' bardh' e ragazí*; në Malsi të Madhe pas Gazullit *rrush rrogazí*, *hardhi rrogazezë*. Prej *ragazí* u formua per extensionem dhe *ragabardhë* «rrush i bardhë këpujëmadh» (Ed. e Re Seria III viti I = VII, Nr. 10, f. 395). Te Ed. e Re jepet dhe një tjetër formë me metatezë, *zarakí*, ku ka ndikuar *rakí*-a. Me gjith'atë kjo nuk është një huazim prej sllavishtes, si mendon Manni 574, po përsëri një trajtë e *razakí*-së, mbase ndikuar prej sllavishtes me një etimologji popullore. — Për fjalën greke mendimi i Andriotisit (f.212, 216) që kjo me trajtën *ροζακί* të vijë prej turq. *razakí* e kjo prej gr. *ροζακί*, e që *ροζακί* të ketë dalë prej shumësit *ροζακιά* e kjo prej lat. *rosacea*, nuk është bindës. Kundra buriimit latin të fjalës greke flet çfaqja e vonë e saj në greqishten e m'anë tjetër edhe fakti që lat. *rosacea* nuk ka zhvilluar as në gjuhët romane një kuptim të tillë. Nuk mohohet ndërkaq që te trajta *ροζακί* të ketë ndikuar, me etimologji popullore, dhe it. *rosa*, nga puna e ngjyrës së ve-

çantë të kokrrave të razakisë. Një i tillë ndikim mund të mendohet dhe për shq. *rrozikí* që jep Bashkimi pranë trajtës *rrezigí*.

rē rē f. G. Meyeri (f. 362, AS III 37,90), duke menduar një zhvillim fonetik **rougi- *raugi- *rāgi- *rēgi-*, e krahason me gjerm. e lartë të vj. *rouh*, sot gjerm. *Rauch* «tym». Ky krahasim citohet te Walde-Pokorny II 357 e te Pokorny I 872, po pa mbajtje qëndrimi. Me të drejtë Tagliavini 235 sillet kundra Bariçit (I 78), i cili *r-në* e *rē-së* e mendon si të dalë prej një *n-je*, duke e afruar fjalën kështu me gr. *véφος* «re», sllav. *nebo* «qiell» etj., mendim pa mbështesë fonetike. Kështu do gjykuar dhe afrimi me bask. *odei* që bën Oštiri (Arhiv II 187), duke e menduar *-d-në* e fjalës së baskishtes të rrjedhur prej një *r-je*. Si e vuri re Jokli (Archiv f. slav. Phil. 31, 238, Reallex. d. Vorgeschichte I 86, Arch. Rom. XXIV 35 v.), kjo fjalë ka e nazale dhe lidhet si e tillë me enotr. (si fjalë ilire e Italisë) *ρίνός, ἀχλύς* «errësirë». Mendim i pranuar te Walde-Hofmann I 418, Rosetti ILR II⁴ 58, A. Mayer II 95, Krahe Die Sprache der Illyrier I 38; sh. tani dhe vrejttjet tona në Rendic. Ist. Lombardo 99 (1965) 216. Afrimi që bën Ribezzo (Riv. d'Albania I 140 shën. 4) midis *rē-së* e mbiemrit *errët* është i drejtë, vetëm se *errët* është sekundare ndaj *rē-së* e se të dy fjalët nuk kanë lidhje me gr. *ἔρεβος* (sh. *err*).

Fjalë e mbarë gjuhës Buzuku (XXXII, Isaia 45,8) e *retë kthjellnjënë gjyqitë* «et nubes pluant iustum»; Bardhi Nubes *Rëtë*, Nubecula *Rēza*. Përbrenda gjuhës *rē-ja* përveç se *err errët* ka formuar dhe verbin *rrej* me rrjedhojat e tij. Për historinë e *rē-së* ka rëndësi kjo, që ajo nis me *r* të thjeshtë; *err errët* e *rrej* kanë *r* të fortë sekundare, e cila buron nga një geminacion ekspresiv. Për etimologjinë e fjalës kjo do të thotë se ajo në krye të herës nuk ka nisur me *r-*, sepse kjo do t'u kish forcuar në *rr-*, po ka pasur një tingull para likuidës. Ashtu si te *i randë i rëndë*, te *ruaj* me *rē roe* e ndonjë tjetër, ky tingull ka qenë një *u-* (*v-*). Kështu si bazë e *rē rē-së* do të mendohet një **uren- *vren-*. Kjo piqet mirë me *ρίνός, ἀχλύς*, duke parë ne te *ρίνός* një *Ροινός*. Brenda shqipes *rē rē* përveç se me *err errët* e me *rrej* piqet dhe me *vrër vrërët vranët*, e cila ndërkaq ka një *v-* sekundare, një prefiks. Afërsinë e këtyre dy fjalëve e vuri re sëpari Hahni I 250. Pas tij Kupitori (*Ἀλβανικαί μελέται* 49) krahasoi *vrërët vranët* me *ρίνός ἀχλύς*. Edhe Jokli (në një kumtim me gojë) *vrërët vranët* e lidhte me *rē-në*, sh. dhe vrejttjet e tij në Arch. Rom. XXIV 40. Lidhjen e *rē-së* me *vrërët vranët* e vërteton dhe trajta *ro-ja* e atij emri në Vuno të Himarës, që pas karakterit të atij dialekti pasqyron një *rē* e dëshmon me këtë për ekzistencën e një vokali nazal rrjedhur nga vokal + *n*.

rē roe f. : *vē rē* «shikoj me kujdes, i vē mendjen; ma zë syri, më bie në sy», e *pashë*, po *s'e vura rē*. G. Meyeri 362 bashkon me këtë fjalë me të drejtë dhe *vërej vrej* (sh. këtë), po *rē-në* vetë e spiegon nga lat. *gravis* «i rëndë», si të thuash *vē rē* «i jap rëndësi», me një ndrim të grupit *gr* në *r* në ballë të fjalës që ai pranon dhe për *rëndë*, sh. këtë fjalë. Pranuar te Puçariu EW 735, po përndryshe kundërshtuar. Wiedemanní (B XXVII 210) e afron fjalën me lit. *regėti* «me pa», irl. *réil* «i qartë». Jokli (Studien 75 v., LKU 207) e pranon këtë etimologji indoeuropiane, po ndërkaq përcakton format dhe afëritë e fjalës përbrenda gjuhës: *re* është formë kontraktioni e *roe-s* dhe etimologjikisht afrohet me *resë* e me *ruaj*. Krahasimin me lit. *regėti* e pranon Pokorny I 854, po nuk e shënon Fraenkeli 712 v.

Fjalë e mbarë gjuhës, po me trajta dialektore të ndryshme. Budi

(DC 8, SC 8) *ta vëmë roe e ta njofmë; këto kafshë fort janë për të vëm roe* (po SC 113 *rë*, a gabim shtypi?). Bogdani (Parathënia, I 55,4) *Ma le të venë roe i kështeni* «Ma rifletta il Lettore Christiano». *le vëmë re* dhe te Kupitori prej Greqie, G. Meyer AS V 50. Si e kemi shënuar dhe te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 3 (1958) 83, nga variantet fonetike të fjalës, më e plota, *roe*, ruhet në ndonjë krahinë të Veriut si në Zadrinë; *rō* përdoret në anët e Shkodrës e në Dushman (Cimochowski 7, 63), *rē* në pjesën më të madhe të gjuhës; *rō* është e geg. verilindore e lindore, në Dibër *s'i vndova rō* «nuk e vura re» (me objekt dativ). Trajta *oroë orō oré* është e përbërë me prefiks *o-*. Ky pas Joklit është një formant i moçëm, i krahasueshëm me ind. e vj. *ā* në *visa ā* «drejt popullit», gjerm. e lartë të vj. *ā* në *āwahst* «shtim, shtesë», gr. *ἦ* në *ἦμέρα* «ngadal». Pas mendimit tonë është një shtesë e re, përfutur për hir të «bisilabizmit» në fjalë, të shkurtëra në shqiptim të gegërishtes veriore, si *obrókth*, *i odokët*, *oputë*, *oroë*. Fakti që kjo e fundit te autorët e vjetër të Veriut del me trajtën *roe*, flet për karakterin e vonë të *oroë-s*; në këtë drejtim dëshmon dhe ruajtja e *o-së* në këtë formë, e cila, po të ishte e vjetër, atë do ta kish humbur me kohë. — *roje* e gjuhës së shkrimit buron prej gegërishtes, khs. *vë roj* «vë re» te Weigandi 74; aty shihet prania e një *j-je* përkundrejt *roe-s*, tingull që ka hyrë kundra hiatit. Bogdani përveç *roe-e* në frazën *le të venë roe* ka dhe emrin më vete *ronjë* me kuptimin e rojes. Popullore është *rojës i mavzeres* «sigurecë e m.» e mbase edhe *rojtës* «ruajtës, bekçi», neologjizëm është *rojtár*. Një ndërtim poetik gjan të jetë *rë-fjuturuar* «con pensieri volanti» e *rë-tretur* e de Radës (Poesie alb. II 191, 79).

regëzinj «gris, çjerr, shkyej». Fjalë e Buzukut: *E regëzini zemërenë: taj, e jo petëkatë tuoj* «Et scindite corda vestra, et non vestimenta vestra»; *E si pat zgjedhunë regji i Isarelit letërenë, regëzini pekëtatë e tî* «Cumque legisset rex Israël litteras, scidit vestimenta sua»; *Ashtu atëherë aj i pari i priftënet regëzini petëkatë* «Tunc princeps sacerdotum scidit vestimenta sua» (XLI, Joeli 2,13; LI, Mbretërit IV 5,7; LXIV/2, Mateu 26,65). La Piana (Studi ling. albanesi. Varia 41) sjell për krahasim *rragëzinë* «rreckë» të Kosovës. Më afër me verbin e Buzukut qëndron për nga forma *regzinë* «shpërgâ» te Bashkimi, të Cordignano «fascia, pannicello, taccone, shpërgâ», për Mirditë, te FGS *rrekëzinë* «sukulla që vihet nën këmbë në opingë», figurshëm e *bani rrekëzinë* «e bëri leckë, e poshtëroi». *regzinë* ndaj *regëzinj* si *shamtinë* ndaj *shamtij*; sh. për *-inë* prej foljesh Xhuvani-Çabej Prapashtesat 55. Etimologjikisht *regëzinj* mund të ketë dalë nga metateza e një **gërzinj* e kjo të jetë një zgjerim me *-inj* i *gris*, si *kërpinj*: *krip*, *mbëllij*: *mbyll*; khs. dhe *përshij*: *prish*. *r-ja* nistore e forta te *rrekëzinë* me geminacion ekspresiv.

regj m. «mbret»; *regjëni*, kal. *regjëri* f. «mbretëri»; *regjinë* f. «mbretëreshë». G. Meyeri këtë fjalë më parë (Gr Gr I § 12) e spiegonde nga lat. *rëgem*; po pastaj (EW 362) *regj* e nxirte nga lat. *rëg(u)lus*, *rigë* «mbret në lojën e letrave» (me *rigatë* f. «mbretëri») nga gr. e mesme dhe e reja *ῥήγας* e *renjój* «mbretëroj» (me *renjī* f. «mbretëri») nga it. *regnare*. Meyer-Lübke (Gr. Gr. I² 1044) për *regj* i mbahet spjegimit të parë të G. Meyerit nga lat. *rëgem*. Gjithashtu Helbigu 29. Kundra një burimi nga it. e vj. *rege* që del nëpër dokumente siciliane të vjetra, si mendon N. Resuli (Studi albanesi III-IV 211 vv.), ne mbrojmë mendimin e rrjedhjes së fjalës nga lat. *rëgem* (Li. Posn. VIII 116).

Fjalë e vjetër e mbarë gjuhës, sikurse del nga prania e saj më një anë në literaturën e Veriut e në gjuhën fetare katolike të Shkodrës (*regj*

«mbret, *regjineshë* «mbretëshë, Sh. Mëri», te Ati ynë *Ardhtë regjina jote*), më tjetër anë në dialektet e Greqisë e t'Italisë; ashtu edhe *regjënî regjërî* është Veriut dhe e Kalabrisë, poashtu dhe *regjënóy regjëróy*. Nga shkrimtarët e vjetër khs. prej Buzukut (LI, Mbretërit IV 5,5; XIII/2, Salve Regina; LXXXVI=CVI, Mateu 5,3, XXXVIII a) *E i tha regji i Sirjesë: Ecë, e u të dërgonj një letërë regjit Israelit* «Dixitque ei rex Syriae: Vade, et mittam litteras ad regem Israël»; *Zotynë t u n̄faltë, o Regjina e mishëriersë* «Salve, Regina, mater misericordiae»; *Bekuom të vobegj(i)të n̄ pak shpirti, përse e tyne anshtë regjënja e qiullet* «Beati pauperes spiritu, quoniam ipsorum est regnum caelorum»; *qi me t̄y gjellin e regjënnon* «Qui tecum vivit et regnat», pranë *renjoj*, sh. këtë fjalë. Budi (RR 341, 15) *Nabukondonosornë të paganënë, e shumë të mënishiminë Regjnë e Babiloniesë; aspak s munë hinjë ndë Regjënî të qiullet*. Bardhi Rex *Regj*, Salamon Iu: Rex fili: David *Salamoni, i biri i Regjit David*, Sceptum *Shkopi i Regjit, o i Perëndorit, Regalis Dhunëti e denjë për zot, o për Regj*, Regaliter *Possi Regj, Regia Pëllasi i Regjit, Regilla Petëk(ë) Regji, Regina Regjinë, Regio Regjënî*. Bogdani (I 110, 1; 112, 9; 127, 2) *Salomonë... kje birî Davidit Regjit e i Bersabesë* «Salomone... fu figliuolo del Re David e Bersabea»; *Kur erdh Regjënsha Savë me pām Rejnë Salomon* «Quando venne la Regina Sabba a vedere il Re Salomone»; *Profetixoj ende... Regjëninë e Krishtit Messî* «Predisse parimente... il Regno di Christo Messia». Përhapja e madhe territoriale e fjalës dëshmon me fort për një burim prej latinishtes sesa prej italishtes, sh. dhe *Revue de Ling VII 1 175*. Ndërkaq baza s'është **rëg(u)lus*, e cila nuk rron as në gjuhët romane, po është *rëgem*. Kjo me hiferezën e rregullt të -e-së i mjafton si bazë gjithsesi fjalës së shqipes, kurse **rëg(u)lus* do të kish dhënë diku (te Buzuku, në arbërishten e Italisë edhe gjetkë) **regull* ose **regl*, khs. *avunculus: ungj e ungl*. Historikisht *regj* nga *rëgem* gjan të jetë një huazim më i ri se *mbret* nga *imperator*. Kjo e fundit pas gjithë gjasësh rrjedh nga koha e perandorisë romake, ajo nga latinishtja kishtare e mbarimit të antikitetit a e fillimit të mesjetës. Relativisht e re, mbase dhe më e re se *regj*, është *regjinë*. Këtë e dëfton ruajtja e *gj-së* intervokalike, e cila në një huazim të moçëm do të kish rënë. Mbase kemi të bëjmë me një element latino-italian. -Nga *rig*, *rigë* është formuar *rigatë* f. «mbretëri», e cila tregon se fjala ka pasur dikur kuptimin e përgjithshëm «mbret». Fjala greke ka hyrë dhe në rumanishten, Sandfeld 30 shën. 1.

regj «punoj lëkurët e shtazëve; bëj turshi specë, kastraveca, domate; krip e ndreq ulla; *regjem* «stërvitem, fitoj përvojë; mësohem me një punë të vështirë»; *i regjur: lëkurë e regjur*; figurshëm «i rysun, i rryem»: është *i regjur në këto punë*. G. Meyeri 362 sheh këtu refleksin e serbokr. *redjati* «me renditë, me rreshtue», *redjenje* «gatitje e lirit, pastrim i drithit etj.» Selišcevi me të drejtë këtë fjalë nuk e përmend ndër huazimet sllave të shqipes.

Fjalë e mbarë gjuhës. Kundra kësaj etimologjie flasin arsye formale e kuptimore. Formalisht vihet re se verbet sllave me -ati paraqiten në shqipen si verbe më -as -at, si *vikati: vikás vikát, šetati: Buzuku shetatën*. Përkundrazi *regj* bën pjesë në klasën e verbeve shumë të vjetra, e të fondit autokton, që paraqiten sot pa sufiks, si *sgardh, zbardh*, për të cilat khs. Jokl Slavia XIII 299. Përveç kësaj fjala sllave ka hyrë në shqipen si *rendit redit*, nga perfektivi *rediti*, gjë që nuk lë vend edhe për një huazim paralel nga imperfektivi *redjati*. Nga pikëpamja semantike është vështirë që nga «rendit, rreshtoj» e «gatit lirin, pastroj drithin» të arrihet në «regj lëkurët». Është fjalë vendi e shqipes, e afër me gr. *ῥέγον*

Ἔργον «vepër, punë», gjerm. *Werk* «vepër», av. *var ʷa* «veprim», arm. *gorc* «vepër» etj. Kjo fjalë edhe në greqishten ka dhënë ndër të tjera një kuptim si të shqipes, gr. e mesme dhe e re **ἐργάζω** «regj lëkurët», e cila si *ergás* ka hyrë dhe në shqipen. Edhe në gjuhët sllave të regjurit e lëkurëve shprehet me fjalë që duan të thonë «veproj, përpunoj», khs. rus. *вЫделѣтѣ*, obravivat. Baza e shq. regj është **uerǵ-*, e cila me metatezë të likuidës dha **ureg-* e më tutje *regj*; khs. *ḍrēkē* përkundrejt *darkē* e *darsmē*. Po *regj* mund të krahasohet formalisht dhe me gr. **ρέζω** «bëj» **ἄρεκτος** «i pabëmë», që shkon me **ἔργον**, sh. për të Boisacq 271, Hofmann GEW 90. Në çdo rasë të *regj*, ashtu si dhe te *i rëndë*, te *rē*, te *roe* etj., *r*-ja jo e fortë është një shenjë që fjala në krye të herës ka nisur me *ur-* (*vr-*), jo me *r-*, sepse *r*-ja nistore zakonisht ka dhënë *rr-*. Ndërkaq sot fjala ndihet dhe *rregj*.- Palatali *gj* te *regj* mund të ketë dalë nga një *-g* (*reg-*) në veten e dytë, ose është më i lashtë, nga një **uregiō-*. Sh. dhe *rrëgjoj*.

rekës m. «gjigant», pas Reinholdit në shqipen e Greqisë. G. Meyeri 363 e lë pa spjegim etimologjik, vetëm përmend slloven. *orjak* «gjigant», që e lidhin me *orjaš* = magjar. *oriás*.

Kuptimi i parë gjan të jetë «atlet që mundet me një tjetër, mundës, përbaltës». Është një postverbal i *rrek* «lodh, mundoj, mërzit», *rrekem* «përpiqem, mundohem (për t'i arritur një qëllimi)», fjalë që ka pasur një kuptim më konkret (sh. *rrek*). Morfologjikisht *rekës* është, ashtu si *përbaltës*, një nomen agentis më *-ës*, «ai që mundet».

rem m. «bakër», *i remtë* «i bakërt», *remtár* m. (neologjizëm) «bakërxhi». Për këtë fjalë nuk ka dyshim që ka hyrë prej Italisë, vetëm se ka ndryshim mendimesh për kohën e depërtimit të saj. Miklosichi AF II 687, G. Meyeri 360, Helbigu 128, Vasmeri 29 e Tagliavini 234, duke u mbështetur sidomos dhe më trajtat me *-a-* (*ram* m., *rame* f.), e spiegojnë nga it. *rame*. Përkundrazi G. Meyeri më parë (Gr Gr I § 10), Meyer-Lübke Gr Gr I² 1042, Pušcariu EW 107, Weigandi 73, Philippide II 631 dhe Jokli Arch. Rom. XXIV 35 e bien të ardhur prej lat. *aerāmen arāmen* «bronc». Sidomos Jokli sjell për dëshmi të vjetërsisë së këtij huazimi trajtën e ablativit *rembje* të Bogdanit, me *-e-në* e saj për *-a-*, me *-mb-* për *-m-* e me kuptimin e broncit në vend të atij të bakrit.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që të Buzuku (XXXII, Isaia 45,2; XL/2, Korintasit I 1,1): *e të nthenj dyertë n rembje, e dryenëtë n hekuri t i këputinj* «portas aereas conteram, et vectes ferreos confringam»; *u jam bā pors i një remb qi bije, o pors i një cimbalë (çimbalë) për të gëzuom* «factus sum velut aes sonans, aut cymbalum tinniens». Budi (SC 133) *E kush të gjindëj se tha Meshë me ndōnjë kalçind të remtë, o të plumtë o n druj, o n kristali...* Ndërsa Bardhi lat. *aes* e jep shqip me *bruncë*, Bogdani (I 114, 18) *ka si bani Mojsesi Gjarpëninë rembje* «come fece Moisè del Serpente di bronzo». Nga dy trajtat e fjalës, ajo më e përdorura sot është *rem*. E ka përveç Veriut edhe Jugu, Çorraj i Kurveleshit (*ena*) *zuri rem* «zuri bakër», prej nga atje edhe verbi *remoset*, *u remós* po me këtë kuptim (A. Dhrimo); *enë remje* «enë bakri» te FGS. Përhapja e fjalës në mbarë gjuhën është edhe kjo — përveç atyre që shënon Jokli — një indic që te *rem* kemi të bëjmë më fort me një element latin se italian. Atë gjë dëshmon dhe *r*-ja e butë në ballë të fjalës, e cila si e tillë tregon se rrjedh nga pozicioni në trup fjale, pra nga *aerāmen*, kurse *r*-ja nistore e moçmja është forcuar në *rr-*, lat. *rota* : *rrotë*. Përhapja e fjalës dhe në rumanishten (*aramă*, po jo në të gjitha dialektet e asaj gjuhe, sh. tani Papahagi 126)

do t'ishte një dëshmi që *aerāmen arāmen* ka ekzistuar dhe në latinitetin ballkanik. Prania e dy trajtave të shqipes për ne spjegohet kështu, që kjo fjalë — ashtu si shumë të tjera, sh. *Revue de Ling.* VII 1 177 v. — ka depërtuar në gjuhën shqipe dy herë: më parë nga lat. *aeramen*, më vonë nga it. *rame*. Në të dyja rasiat dha në fillim *ram*; kjo te huazimi italian ruajti trajtën e saj (khs. *rame*, *i ramtë* te Kristoforidhi), po te huazimi latin iu shtrua metafonisë e dha *rem*. Spiegimi thjesht fonetik që i jep kësaj metafonie Meyer-Lübke (Gr Gr I² 1042), duke u mbështetur më dy shembëlla të vetme, *rem* «bakër» e *rremb* «degë», e duke menduar një ndrim vokalik *a : ë* në pozicion nazal e pastaj më tej *ë : e*, nuk është bindës. Të dyja fjalët përdoren shpeshherë në shumës, khs. *rême-t* «bakrat», te Junggu «rami, utensili di rame». Prandaj te *rem* e te *rremb rrëmb* «degë» kemi të bëjmë më fort me shumëse të singularizuara. Njëjësi i ri te *rem* «bakër» paraqitet ku si mashk. *rem-i*, ku si fem. *rem-ja*, prej si edhe *remb-ja* e autorëve të vjetër të Veriut, me shtesë të një *-b-je* si tingull homorganik pas *-m-së*. Gjinia femërore këtu spjegohet me faktin që neutret latine, përveç se si neutre a mashkullore, paraqiten në shqipen dhe si femërore: *aerāmen: remb-ja, caelum: qiell-ja, inferum ferr-a ferrë-a*, sh. BSS 13 (1955) 43 v., *Revue de Ling.* VII 1 190; një trajtë *rembe* nuk ekziston. It. *rame* nuk pësoi metafoini, më sa pësoi *altar* përkundrejt më së vjetrës *lter, pras* nga greq, e re përkundrejt më së vjetrës *presh*. — Ky spjegim i *rem-it* si formë retrograde prej shumësit na duket më i drejtë se ai i Joklit, i cili gjen aty veprimin e akuzativit që dha nominativin e ri, dhe *rem* e *ram* — ashtu si Meyer-Lübke — i bie të ardhura të dyja prej një baze *(*ae*)*rēmē*, ku *ë* në disa kushte të caktuara u ndryshua në *e*, në disa të tjera në *a*. Sh. dhe *i rimtë*.

remë f. «vija e ujit të mullirit, jazi». G. Meyeri 373 e shënon si *rrem* m. «shtrat lumi, përrua pyjesh; damar në gur, në sy», geg. *remë* f. «vijë e mullirit, rrymë», dhe e spjegon nga gr. e re ρέμα = ρεῦμα «vijë uji; rrjedhë, përrua, lumë, rrymë». Kështu më parë dhe Kamarda (I 53), e më vonë Weigandi 73, i cili jep dhe adverbën *rema-rema* (për një lumë).

Pas Kristoforidhit është fjalë e Elbasanit, me kuptimin «vi uji që shkon ndë mullit të drithit, τὸ ρεῦμα τοῦ μύλου, αὔλαξ ὕδατος». Nuk është gjë tjetër veçse *rremb* «degë» (nga lat. *ramus*). Kjo shënon dhe rrjedha uji: *rrem uji* «krah lumi», e m'anë tjetër dhe një damar, në shprehje si *mermer rremba-rremba; njeri me rremba; e ka një rremb marrie*. Te *rrem rremë* nuk u zhvillua pas *-m-së -b-ja* që del te *rremb-i*. Edhe Manni (f. 425, 434) te *remë* çon te *rrembë*, e te *rrëmë* shënon *rremb, rrem*. — Me spjegimin e *remë-a* bie dhe ai i *rrëmët-it* (sh. këtë fjalë).

resë f. I. «zili, nakar, smirë; ai vend në lumë, ku ruajnë natën për të gjuar peshkun kur rreh; pusí, pritë, roje *i vuna resë*. Këtë fjalë të gegërishtes, e cila mungon te G. Meyeri, Jokli (Studien 76) me të drejtë e lidh me *ruaj*. Për të parin kuptim sjell për krahasim lat. *invida: video* «shoh», sllav. e vj. *zavistъ* «zili, ndezë: *vidëti* «me pa»; në të dytin gjen një «përgjim, pritë» si kuptim bazë. Për morfologjinë e *resë-s* ndaj *ruaj* ai përqs gërresë-n ndaj gërruaj.

Del, me kuptimin e parë, që te Budi (DC 117): *E j gjashti mkat murtār ashtë zmiri, e resa e keqe*. Afërinë e *resë-s* në kuptimin e rojes e të vendit të gjuajtjes së peshkut, me *ruaj*, sikundër e kemi shënuar në BSS 3 (1954) 59, e vuri re dhe Kristoforidhi 350. Nga *resa e keqe* e Budit (e e popullit) e nga mbiemri *reskéq* «ziliqar» (pranë *restár*) mund të mendohet që *resë* ka pasur një kuptim më të gjerë e që në përdorimin e sotmë arriti me anë

të një elipse, duke mbetur jashtë atributi *e keqe*. Logoreci bën dallim midis *resës* e *smirës*. Morfologjikisht *resë*, si një fjalë më fort e geg. jugore, mund të ketë dalë nga *re-ja*, e cila më tej lidhet me *ruaj*.

resë f. II. «kallame lidhur si trinë që i vihen çatisë së kasolleve, e mbi të cilat shtrohet kashta si mbulesë», *resa* e *çatisë*; petavrat që shtrohen mbi çati e mbi të cilat vihen tjegullat; thurimë a trinë kallamash; në Mifol një lloj rjetë peshkimi. Në Seman «kallama a kundje të lidhura radhë; përdoren për tavane, për të nderë pambuk, etj., për t'i vënë në anët e qerres, kur mbajnë misër, pleh, etj.», J. Thomaj BUST 4, 1961, 151. Është një me *res* m., pl. *resa* «fijet e gjata që lëshon bima para se të lidhë», *resat* e *shelgut* në Pogradec. Rrjedh, bashkë me *rezhdë* (sh. këtë), nga sllav. *resa*; pas përhapjes gjeografike nga bullg. *resa* «gath, vastak, mustak (i misrit), thekë, xhufkë» *resna* «thekë». I gabuar spjegimi ynë nga *rrasë*, si një plural i singularizuar, Li. Posn. VII 197.

resh: *po resh borë* «po bie borë», *po resh shi* «po bie shi». G. Meyeri 363 jep pas da Lecces *reshën*, pas Rossit *resh* «bie borë», dhe duke e menduar fjalën si të dalë nga një **vresh*, këtë nga **vers-*, e krahason — me dyshim — me ind. e vj. *varsá-* «shi», gr. *ῥέσση ἕρση* «vesë», irl. e mesme *frass* «shi, shi rusgjer». Më vonë (AS III 86) çfaq dyshime. Jokli më parë (Studien 73v.), mbi të dhënat e Bashkimit: «navigare, metaf. spargere; me reshë thohet edhe zjarm, hi etj. qi vin prej qiellit», gjen te kjo fjalë një kuptim më të gjerë, dhe e lidh kështu me sllav. e vj. kishtare *rosa* lit. *rasà* «vesë», ind. vj. *rasā* «lagështirë», lat. *ros roris* «vesë» etj. Më vonë (IF 43, 52 vv.), duke u nisur nga shprehja *resh borë* për «bie borë», këtë fjalë bashkë me *rreshme* «ortek bore» e «vend gurishte i pjerrët (terreno pietroso e sterile)» e afron përbrenda shqipes me *rashë*, aoristi i verbit *bie*, e me *dragë* «ortek bore». Bariçi (I 79) mendon për këtë fjalë — si dhe për disa të tjera të shqipes — një ndrim të vjetër *n : r*, dhe kështu e krahason me lat. *nix nivis* «borë», gr. *νείφε* «bie borë» etj. Nga fjalorët krahasimtarë asnjëri s'e përfill më krahasimin e G. Meyerit. Atë të dytin të Joklit e pranon Walde-Pokorny I 149, Pokorny I 336, si dhe Sandfeldi 73 e Pușcariu Limbă română I 180. Etimologjia e Bariçit mbështetet më një ndrim fonetik *r : n* që nuk vërtetohet gjekundi në shqipen, dhe kështu eliminohet vetvetiu.

Kjo fjalë ka një sferë përdorimi më të hapët. Ndërsa Bardhi e jep me kuptimin e sotmë: Ningere *Me mbdoruem*, *me reshunë bdorë*, Budi e ka si transitiv e me domethënien «spërkas»: *mbasi ta kietë përsipëri reshunë me ujë të bēkuom; Prifti . . . të bēkonjë ujëtë e rī, me të cit të reshenë e të përkitenë kërshitenimi qi vinjënë mb atë ditë; u dhashtë ashtu ende aj Zot i mëshëriershim gazimendit e ngushëllimi cë kësaj jete, e u reshtë voese cë qiellit e undyre cë dheut; tue u reshunë e tue u lëshuom përsipëri uj cë djersëvet e ncë lotet* (RR 115, 125, 170, 192, 197, SC 231). Bogdani (II 46,2) *sa ende ndër ditt' tona mbë Maletë Arbënit reshi hīn fort shumë* «che anche à giorni nostri nei monti di Albania nevicò cenere in grandissima abbondanza». Shprehje e figurshme e *reshi me të mira* «e mbushi me të mira». — Në pikëpamje formale do vënë re se një *r* në pozicion nistor që në krye të herës, do të paraqitej sot si *rr-*. Këto dy rrethana: kuptimi që ka Budi dhe forma e fjalës, na shpjen përsëri te baza **ures-* **vres-* e te etimologjia e G. Meyerit: ind. e vj. *varsá-* «shi» *vársati* «bie shi», gr. *ῥέσση*, irl. e mesme *frass*. Si për fjalën greke e keltiken, edhe për shqipen do të pranojmë një metatezë të likuidës, si te *drekë*, *regj*, pra një zhvillim **uers-* në **ures-*. Këtë metatezë për keltishten Pedersenit (Kelt. Gram. I 176) e shpie lart gjer te perioda indoeuropiane. Për kupti-

min do shtuar se nga «spërkas» u zhvillua «bie borë», këndeje edhe *reshme rreshme* «ortek bore; vend gurishte i pjerrët», *reshpe* «ortek bore, reshme». Një neologjizëm yni është *reshje* «precipitacione atmosferike». — Trajta *reshën* e da Lecces është një prezent i zgeruar në *-enj -ën*, i shpeshtë në literaturën e vjetër e në disa dialekte brenda e jashtë Shqipërisë.

rezhdë f. «lapéja, vathi që i varet dhisë nën gushë; emër i dhisë që ka nën gushë dy vathë të tillë». G. Meyeri 373 jep një *rrezhdë* «asht» dhe e bashkon me *rreshtë* «rrasht, asht», duke i spieguar të dyja nga lat. *arista* «thak i kalliut, kalli, kreshtë, halë peshku». Nga këto, *rreshtë* është plurali i singularizuar i *rrasht-it* (sh. *rrasht*). Sa për *rezhdë*, kjo është një me *rezdet e dhive*, në Pogradec *resat e dhive*, te Kristoforidhi *rrëshdatë ose rreshtat e dhisë* «të dy vathët e dhisë që i kanë ndënë nofullat» (në Zagori te një këngë, *Moj ftujë bardhë me zile, Moj ftujë bardhë me reshta*), e më tej me *rezhde rezhdë* «livarzë, gath» (i disa bimëve, si shelgu, lajthia). Rrjedh prej sllavishtes: serbokr. *resa* «rezhde, thak, vath i dhisë», bullg. *resa* edhe «gath, vastak, mustak (i misrit), thekë xhufkë», sh. Li. Posn. VII 186. Prej kësaj gurre të sllavishtes G. Meyeri 373 nxjerr një tjetër fjalë të shqipes, *rreckë*. Te *reshdë rezhde* ndrimi i s-së sllave në *sh (zh)* tregon se kemi të bëjmë me një huazim mjaft të vjetër. Më e re është *rës* «gath, lat. amentum, gjerm. Kätzchen e «pluhuni qi shkundet prej do lisash (p.sh. plepit) kur janë në lule, gjerm. Staubblatt» që jep Gazulli për Malsi të Madhe. Kjo është një me *resë* II., sh. këtë fjalë.

rëmër m., pl. *rëmënj-të* «Vllah, bari, fshatar, bujk», në shqipen e Greqisë. Mendimi i G. Meyerit (f. 365) që kjo bashkë me rum. *rumîn* istororum. *rumar* rrjedh prej lat. *Romanus*, pranohet te Meyer-Lübke Gr Gr I² 1049, te Puşcariu (EW 1474, Studie istro-române II 6, Limba română I 299), Tagliavini Arhiv III 206 vv., T. Papahagi Grai si Suflet I 203 vv. Tagliavini sillet dhe kundra Capidanit (Româniî din Peninsula balcanică, i cili te arom. *ramân* gjen një ndikim nga ana e shq. *rëmënj*).

Huazimet latine të shqipes përgjithësisht kanë një përhapje në mbarë gjuhën, sh. dhe Revue de Ling. VII 1 175. Në këto rrethana është vështirë të pranohet që një fjalë sporadike e një dialekti të shkëputur, e që mungon në pjesën më të madhe të truallit të shqipes, të jetë vazhdimi i drejt-përdrejtë i emrit të Romakëve. *Rëmër*, pl. *Rëmënj* te shqiptarët është emri i Aromunëve. Prandaj pl. *rëmënjtë* i Greqisë është një me emrin topik *Rëmënj* të Shqipërisë, një në rrethet e Gramshit, një në të Pogradecit, e me emrin e Katundit *Ermenji* në Skrapar, emra që s'janë gjë tjetër veçse plurale me kuptimin «Aromunë», sh. Li. Posn. VIII 86. Këto emra, bashkë me *rëmer*, *rëmënj-të* të shqipes së Greqisë, rrjedhin prej aromunishtes, arom. *armîn arumîn*. Për kuptimet që ka fjala te elementi shqiptar i Greqisë: «Vllah, bari, fshatar, bujk» le të kemi parasysh se në Greqi, sikundër na mëson dhe G. Meyeri, Βλάχος e «bujk» janë një, dhe se edhe në Rumani *romîn* pas Puşcariut dikur ka dashur të thotë «shërbyes, skllav, bujk».

rëndë (i) randë (i). Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri 365 e spiegon nga lat. *grandis* «i madh», me rënie të *g-së* nistore para *r-së*, dhe këtë mendimi i mbahet dhe në AS III 8, po në AS IV 25 e vë në dyshim, për arsye të kuptimit. Mendimi i tij pranohet te Meyer-Lübke Gr Gr I² 1054. Jokli përkundrazi (Studien 74) gjen aty një fjalë vendi të shqipes, e afër me lit. *riéju rieti* «stivoj, vë stivë» (drutë), dhe për kuptimin siell si krahasim gjerm. *Last* «barrë»: nord, e vj. *hlaða* «vë stivë», rus. *klad* «barrë»: *kladù* «vë, vendoj»; morfologjikisht *rëndë randë* mbeturinë e një participi të vjetër me *-ent- -ont-*. Fjalë vendi dhe pas Bariçit (I 86 v.,

Arhiv I 43), po si një particip më *-ont- *uront-om* e afër me gr. *ἀείρω ἀίρω* «ngrë», lit. *sveriù* «peshoj» *svarùs* «i rëndë», gjerm. e lartë e vj. *swāri swār* «i rëndë» e përbrenda shqipes me *vjer, var*. Nga këto dy etimologji Tagliavini 234 v. parapëlqen të Joklit. Etimologjinë latine e lëfton dhe La Piana SLA I 116.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LXIV, Mateu 26, 43; IXL/2, Mateu 20, 12; XVI/2, Psalm 31,4) e i gjet se po *nflinjinë, përse sytë e tyne ishnë fort të randë* «et invenit eos dormientes: erant enim oculi eorum gravati»; e i bani (bane?) *pār porsì na qì na bartim të randëtë e gjithë ditësë e të vapësë* «et pares illos nobis fecisti, qui portavimus pondus diei et aestus» (Grigori *mundimn'e ditësë*); *Përse natë e ditë u randuo dora jote përmbi muo* «Quoniam die ac nocte gravata est super me manus tua»; Budi (DC 12, 48, RR 49, SC 50,111) *aj mpkatì tyne mbatëherë aqì randë e j madh. . . , zoti e përandori qì ashtë aqë i randë e j madh; e kuptonj të randëtë e asaf kryqsë madhe; e pā ndonjë të randë ò përtesë; E ashtë ende grātë e ngarkuome e të randa; A mos të kish. . . verbuom e randunë përtesa e të pākujdestë. . .*; Bardhi Praegravis *Fort i randë, Praegravare Me e randunë, Segnis I randë, Vonues, Poltrū*; Bogdani (I 99,4) *Apostujitë çelnë sýtë randuem gjumit* «Gli Apostoli aprirono gli occhi gravati dal sonno». Në dy dialektet kryesore trajtat e fjalës janë shumica paralele: *randë rëndë (më vjen rëndë, e kam randë); të randë-t të rëndë-t n. (të randët e dheut: të rëndët e dh.), randësinë rëndësinë f. «peshë, të rëndët», randësi rëndësi f.,* tosk. popullore më fort për «sjellje serioze, gravitas», me neologjizmin *i randësishtëm i rëndësishtëm*. E gegërishtes është *randesë f. «taksë» e randësh* «për një njeri me trup të trashë e të rëndë», e tosk. jugore (Gjirokastrës) *rëncohem* «rëndohem në trup, plogështohem (nga mosha); bëhem më rëndë (për një të sëmurë)». Kuptimi «të fikët, vilani» që ka të rëndë-t në tosk. jugore (Hahn 132 e rënda «Sucht») del më një farë mënyre dhe në gegërishten, *ka marrë të randë* «është shkalur», *tërana* «epilepsia», H.I. Dalliu Diturija II 107, H. Xhemali poaty 64, khs. gr. e re *βαρύος βῆρος* «i rëndë» për një vend me hie, me xhinde, B. Schmidt Volksleben der Neugriechen 93 shën 3; prov. dhe frgj. dialektore *lourd* «i rëndë» edhe për një që goditet shpesh nga vilania, Brück Miscellanea Schuchardt 57. Verbi *rëndem randem (më rëndet, më randet* etj.) paravendon një aktiv *rënd, rand*, i cili me mungesën e çdo mbarese, paraqet një tip të moçëm të formimit verbal të shqipes, si *sgardh*, khs. për këto forma Jokl Slavia XIII 299, me literaturë. Po ekziston dhe trajta e zgjeruar *rëndój* «vij i rëndë në peshë, peshoj», që ndër të tjera përdoret dhe për «punoj punë të rënda», *punon e rëndon* «punon shumë, punon rëndë», te Pedersen 182 *u rëndua* «i erdhi rëndë, s'u përmbajt dot më». Verbi *me merandue* «me peshue një për një mbë të dyja anët, me kjenë n'ekuilibër» me *merandim* m. «ekvilibër» që jep Gazulli për geg. veriore, mundet që përmban fjalën *randë*, sh. *merendój*.

Për etimologjinë e fjalës do vënë re se *r*-ja nistore e thjeshta nuk mund të ketë rrjedhur nga një *r*- e hershme e thjeshtë, sepse një *r* e tillë në këtë pozicion do t'u kish forcuar në *rr*. Për këtë arsye fonetike etimologjia e Joklit nuk mund të mbahet. Karakteri i sotmë i *r*-së paravendon ekzistencën dikur të një fenomeni nistor që i printe. Në këto rrethana spjegimi i Bariçit paraqitet mjaft bindës. Kuptimisht fjala shqipe afrohet më fort me lit. *sveriù* «peshoj» *svarùs* «i rëndë», gjerm. *schwer* «i rëndë» etj. Si formë bazë mund të mundohet — me Bariçin — një **uront-* ose një **urent-*, ku *e*-ja në pozicion nazal dha më në fund geg. *a* tosk. *ë*. Ndërkaq

nuk përjashtohet për *rëndë randë* një lidhje afërie me participin *rënë ranë* të verbit *bie*, si një zgjerim i tij me *-t-*. Kështu *i rëndë* do t'ishte në thelb «që bie». Khs. për kuptimin zhvillimin e kundërt në lat. *levis* «i lehtë»: *levare* «lehtësoj, ngrë». E për të *rëndë-t* «të fikëtit, vilania» gjerm. *Fallsucht* «epilepsi» (*fallen* «me ra»), it. *mal caduco* (*cadere*), serbokr. *goropad, padavica* «epilepsi»: *padati* «me ra» etj. Etimologjia e Bariçit ka më të gjarë.

rënxó «bëj që të dëkohet»; *rënxák* «i rënxuar, i dëkuem, i pjetun». G. Meyeri 365 e merr si një **ërnëzónj rnxónj*, duke e nxjerrë prej it. *ernia*, mendim i pranuar dhe te Helbigu 118. Nuk është gjë tjetër veçse *rrënxohem*, një formë e *rrëzohem*, khs. *thëllëzë e fëllënxë*. Te Tase *rrënxanák rënxanák* «i rënxuar, që i kanë shkarë». Dozoni përveç *rënxak*-ut të Hahnit jep dhe (për të folët e Fierit) *rënxýerë, të rënxýeritë* «hernie».

rërë ranë f. «kum». Sikundër dihet, vjen nga lat. *arëna*, me aferezë të *a-së*; Miklosich AF II 26, G. Meyer 420 e AS IV 17, Meyer-Lübke Gr Gr I² 1047, Pušcariu EW 120, Weigand 73, Tagliavini 234 me literaturë, Rosetti ILR I⁴ 75. Për ndrimin lat. *e*: shq. geg. *a* tosk. ë sh. Meyer-Lübke poaty 1044, Jokl LKU 281 e Arch. Rom. XXIV 35, khs. edhe *tendë*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi Arena, *Sabulum Rana, Sabulosus Plot me ranë*. Mbiemri tosk. *i rërtë* «prej rëre», me sufiksin *-të* të mbiemrave lëndorë, Geg. *ranishtë* është përgjithësuar në gjuhë; çfaqet dhe në toponimi, sh. A Gazetteer of Albania 141. M'anë tjetër në Toskëri është mjaft i shpeshtë *Rërës Rërëza* si emër fshattrash, në Mallakastër *Rërës*, te Seineri 97 *Rërëzi* afër Vërbasit të Fierit e *Rërëza* pranë Roskovecit në krahinë të Beratit, te A. Gazetteer of Albania 143 *Rerës, Rërëzë, Rersi Rerza, Rrërëzë*. Nga njëri prej këtyre katundeve duhet të ketë dalë kapedani *Dhimitër Reres (Rërës)*, në dokumentet italiane *Demetrio Reres*, i cili bashkë me të bijtë e me njerëzit e tij u shkul për në Itali aty nga mesi i shek. të XV. Sh. për të Skirò Canti trad. IX vv. - Në shqipen pranë *zall*-it si fjalë vendi dhe *kum*-it si huazim prej turqishtes, ka dy emra të rërës me gurrë latine, *ranë rërë* e *shūr zhūr* nga *saburra*. Me këtë të dytën shqipja piqet me gjuhët romane të Perëndimit; këtë ndërkaq, me gjithë se nuk e ka rumanishtja, duhet ta ketë pasur latinishtja ballkanike, sepse e ruan shqipja e përveç kësaj dhe greq. e re. Me rumanishten shqipja ka të përbashkët *arena*: *ranë rërë* rum. *arină anină*. Pušcariu LR I 212 gjen te *arină anină* një fjalë marginale (anësore) të latinitetit, të ruajtur në rumanishten e në iberoromanishten, në kundërshtim me *sabulum*, fjalë sipas tij qëndrore e më e re, e cila i mungon rumanishtes. Shtojmë se as shqipja nuk ka reflekse të *sabulum*.- Sh. edhe *rrnok*.

rienj, reva «vuaj». Fjalë e arbërishtes së Siqelisë (Piana dei Greci), që ka mbetur e paspieguar te G. Meyeri 367 (*rjenj*).

Përdoret në atë dialekt si *rienj, reva* «vuaj». Te Ungjilli i G. Kamardës (17, 15: 27, 19) *se e zë xëna e rien keqë* «quis lunaticus est, et male patitur»; *se disā reva sotë n'ëndër për atë* «multa enim passa sum hodie per visum propter eum»; po te ky autor (A Dora d'Istria gli Albanesi 107) *Nën ci vóit e Turkut shkret Sa kopose Arbreshi rien* «Sotto il giogo degli Ottomani quanti sofferse travagli l'Epirota». Është fjalë e mbarë gjuhës, me qenë se përveç se në Itali del dhe në geg. veriore, si *ryej* e *rryej*: pas Gazullit në Spac, në Shkodër e në Malsi të Madhe *me rye* «me pësue, hjekë keq, vuetjtë: *po ren e s'po des; na po rej më; shum e reve, moj nânë!*, në Hot e në Malsi të Madhe *me rrye* «me vuetjtë, m'u stërkeqë, me ardhë rryeshëm, me ngurrue në të rritun, it. intristire, stentare»: *po rryejnë pemët; rrye-*

shëm «me të rryem, me të stërkequn, me të vuejtun»: *me folë rryeshëm, me ardhë rryeshëm, me ndëjë rryeshëm* «mit Mühe, kaum, it. a stento, stentatamente, con stento»; FGS *rryej rreva* «lodhem me... , vuaj»: *rreva me të, rryejnë pemët* «rriten rryeshëm, mezi rriten», *rryeshëm rryetas* «me ritm të ngadalshëm e me zor»: *puna vete rryeshëm*; te A. Sindani (HD XVII 335) *nuk ka rye për mish të vet* «nuk kursehet», te Logoreci 100 *s'ren për mish të vet*. Gjer ku janë popullore shprehjet letrare *maje një carani t'rryeshëm, karmave t'rryeshme, rrmores s'rryeshme* që jep Lambertzi 173, mbetet për të hetuar. Në mbështesë të zhvillimit kuptimor që shihet te *vuaj: i uuar, përvojë*, kjo fjalë brenda gegërishtes është një me *i rryem* «i stërvitur mirë në një punë, i rrahur me një çështje, i regjur» (FGS), te Bashkimi *ryhem, u ryha, m'u rye* «esercitarsi». Më tej fjala me këtë kuptim lidhet me *rys* «stërvit, e bëj të regjur», *rysem* «stërvitem, regjem, fitoj përvojë; shtrohem, bindem» (sh. këtë fjalë). Ndër format *rienj ryej rryej rys* primarja si për vokalizëm, si për mbaresë është *rienj* e Siqelisë, e kjo është rezultati i diftongimit të një baze *ren-*, khs. *derë: dyer, feçkë: fyell*. Fakti që në arbërishten e Italisë, e cila e ruan *rr-në*, kjo fjalë nis me *r-të* thjeshtë, dhe që edhe në gegërishten pranë *rryej* ka *ryej* dhe *rys*, tregon që trajta me *r-* për gjendjen e sotme është primarja, dhe që *rryej rryeshëm* përmban një geminacion ekspresiv. Meqë m'anë tjetër një *r* nistore e hershme është forcuar me kohë, del se fjala në krye të herës, poashtu si *i ri, ruaj, rê*, etj., nuk ka nisur me *r-*, po me një *v-* ose me vokal. Kështu baza shqiptare *ren-* rrjedh nga një parashq. **vren- *uren-* ose vokal + *ren-*. Burimi i parë i fjalës mbetet ndërkaq i errët.

rij «njom pak, lëmek», *rij petkat; rihem* «lëmekem, njomem pak»: *u ri toka, u ri gota* «u vesh gota nga jashtë si me vesë»; *i ritë* «pak i lagët, i lëmekët» (për ndresa, petka). Për këtë fjalë të gegërishtes (veriore) Jokli (Studien 74 v.) nisat nga *i ritë*, e vetmja formë që dihej në atë kohë, sheh aty me të drejtë zgjerimin me sufiks *-të* të një verbi nazal, dhe e afron këtë me ind. e vj. *rināti* «lë të rrjedhë» *rinah* «rrjedhës, që zë të rrjedhë», sllav. e vj. kishtarë *rinoti* «me rrjedhë» *reka* «lumë», lat. *rivus* «përrua, vijë uji» etj. Etimologji e pranuar te Walde-Pokorny II 140, Pokorny I 330, Vasmer REW II 507 (me literaturë).

Kuptimi i parë i fjalës është «bëj të pikojë, stërpik». Në një këngë prej Kraje *Rina bor'e rina shi*, në Lufaj të Matit në një përrallë *Ai qith e dashi ri lesh*. Prej andej «njom pak, lëmek», te Gazulli *me ri e me ritue* «m'u lagështinue», *m'u ri* «me marrë lagështinë», *qenka ri arka*; te Logoreci «m'u njomzue, me u lagsue sidomos për ënë kur i derpton ujët» (ngatërruar prej tij me *rihem* «bëhem i ri edhe një herë, përtërihem»). Për historinë e fjalës peshon kjo rrethanë që ajo nis me *r-ë* të thjeshtë, e cila pas një rregulle të fonetikës historike të shqipes nuk mund të jetë qëmoti e tillë, sepse *r-ja* nistore rregullisht forcohet; sh. dhe *rë, rê, resh, i ri, ruaj* etj. Kështu *rij* mund të jetë refleksi i indoeur. **uren-* e të afrohet me gr. *ραίνω* «stërpik» *ραγίς* «pikë», të cilën e lidhin tani me sllav. e vj. kishtarë *iz-roniti* «me derdhë lot», sh. Boisacq 833, Vasmer REW II 535, Hofmann GEW 294, përkundrajt Walde-Pokornyt I 139, 320. Në këtë rasë *rij* mund të jetë një verb me *-inj*, si *r-inj, rê-inj*, sh. edhe *kij*. Nga (*i*) *ritë* është formuar denominativi *ritoj*, me *ritue* «me lagështinue» te Gazulli, te Manni «water, irrigate, soak».

rikë f. «zog rose, rosë e re; rosë; pulë deti, pulkë». Këtë fjalë G. Meyeri e shënon në dy vise: f. 369 si *rik* f. «rosë», duke e krahasuar me serb. *rička* «lloj rose»; f. 362 si geg. *rrigë* f. «pulë deti», duke menduar

— me dyshim — një burim të përbashkët me *regj* «mbret». Jokli (LKU 301) shton *riká* m. «rosak».

Është një fjalë e vetme. Jo e mbarë gjuhës, po fjalë dialektore e me kuptime të ndryshme, dhe si e tillë një formim relativisht i ri. Është një nga ato emra të shtazëve shtepiake (për «anitra domestiça» e ka *rikë-n* Bashkimi) që kanë dalë nga thirra me të cilën i ndjellin; pas Kristoforidhit me *rik rik rik* ndjellin rosat. Nga një e tillë thirmë ka dalë dhe kal. *rikaz ríkëzë* «dirk» (sh. këtë fjalë). Prej së tjerash gjuhë khs. frgj. *riquiqui* e *ricochet* «cicami, çerr» te Meyer-Lübke REW 7315b.- Geg. *rrigë* paraqet sonorizimin e ditur të okluzivit në silabë fundore.

rimtë (i) «i kaltërt, i bruztë, bojë qielli e mbyllët». G. Meyeri 367 e jep pas Skiròit si *rimtë rrimt* «dunkelblau, i bruztë», dhe e lë të paspieguar. Afrimi me ags. *nīpan* «me qenë errët» që bën Bariçi (I 80) mbështetet në mendimin e padrejtë të një rotacizmi edhe në ballë të fjalës, sh. për këtë dhe të *rë*.

Del sëpari te Xylanderi (glosar) si *rimtë rimbte* «dunkelblau». E ka edhe Hahni 108, si *rimtë* «dunkelblau», *rimtë e hapëtë* «hellblau». Prej atij mund ta ketë marrë dhe Skiròi. M'anë tjetër e ka shqipja e Atikës: *Ma ljargoj ajo e dita Tërë ljúleza të rimta* (Sotirios, Leographia I 89), ku nga përkthimi *Μά άνοιξε έκεινο τό τρίτο "Όλο λουλούδια άνοιγμένα* del ç'kuptim ka fjala atje. - Është një me i *rëmtë* «esmer, zijosh» që përdoret në Malsi të Madhe (Hot): *a kë në pak i rëmtë ftyret* (N. Daka), që është i *remtë* «i bakërt». Edhe në të tjera gjuhë emrat e bakrit e të broncit kanë dhënë kuptimin e disa ngjyrave të mbyllëta, khs. *i bruzdë*. Fonetikisht geg. *i rëmtë* është rregullt, *i rimtë* me *i*-në e saj nuk është e qartë.

Rinas m. «katund në fushë të Tiranës». Shqiptimi lokal është *Rrihnas*. Është një me *Rrihna*, *Rrihnat*, emra topike në Vukël, Skvinë të Berishës, Kozmaç, *Rrihnat e Beshkozës*, *Rrihnat e Qerretit* në Kçirë (Folklorë II 244, 113, 128 v., 138). Baras me apelativin *rrihna* pl. «vend i çilun rrah; livadhe» te Gazulli, në Sulovë *rrira* (Q. Haxhihasani, Bul. për Shk. Shoq. III 1954, f. 161). Është plurali i *rrah*-ut, me metafoni *a : e : i*, sh. Li. Posn. VIII 124 v. *Rinas* paraqitet si një emër kolektiv më -as, poashtu si *Ferras*, *Fikas*, *Misras* e si apelativet *grenas*, *vashas*, *vorres*; sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 21.

riqe f. «Erica arborea, shqope», në Kalabri. Pas G. Meyerit 366 nga gr. e re *ρείκια*, shumësi i *ρείκι*, prej gr. së vj. *έρείκη*.

Një huazim prej shumësit, rrugë që G. Meyeri ndjek dhe te *gjel* (sh. këtë fjalë), nuk ka të gjarë. Si e kemi shënuar dhe në Li. Po VIII 94, kemi të bëjmë me një proces të brendshëm të shqipes. Gr. e re *ρείκ* dha rregullisht *riq*, trajtë që dëshmohet te Çekrezi 70 e te Cordignano s.v. *erica*. Trajta më -e, *riqe*, ose është shumës i singularizuar, ose i detyrohet prirjes së shqipes për të bërë femërore emrat e bimëve, nga të cilat edhe vetë *bimë* është femërore.

rogë f. «vend në bjeshkë me bar e pa lisa; rudinë e vogël»; *bie bora roga-roga* «b. b. vise-vise». Fjalë sot e gegërishtes, që s'e ka G. Meyeri. E jep Bashkimi si «spazio intramezzato da pini e selve», Cordignano si «sp. intr. da pini e selve». Pas Joklit (Zeitschr. f. Ortsnamenforsch. X 188) e afër me gjerm. e lartë të vj. *riuti*, gjerm. e sotme *Reute* «vend rrah».

Logoreci 99 e ka për «luginë e vogël e më tepër ndër male», Gazulli më saktë «vend, log ndër bjeshkë i pa lisa, por me bar». Ed. e Re (Ser. III, viti VII — Nr. 6, 1930, f. 240) jep për Lumë «vend djerr», veçse do

thënë se në atë krahinë fjala thuhet *rogjë* (Illyria, te Manni), me ndrimin *g: gj* si në të folët e Mirditës. Ashtu dhe në Lurë, ku ndërkaq kjo fjalë shënon viset pa borë në një vend mbuluar me borë, bashkë me verbin *rogjohet bora* «bëhet lara lara, duke shkrirë vise-vise». Zgjerime janë *rogajë* f. «livadh» (Logoreci) e *roginë* f. «vend rogë» (Manni), kjo me *-inë* më fort pas *rudinë-s*. Prej *rogë-s* është formuar me *c- (=s-)* *crog* «xhvesh një copë vend nga drurët; heq qimet, rjep (një shpend)», te Gazulli *mal i crogët* «mal pa lisni»; sh. për *crog* Xhuvani-Çabej Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 70. Si e kemi shënuar dhe te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 2 (1958) 60, 1 (1962) 221, VII Congr. Internaz. di Scienze Onomastiche 1961 f. 244, *rogë* është një postverbal më *-gë* i *rruaj*. Lidhja e *rogë-s* me *rruaj* shihet dhe nga *vend i rrúarë* «ein kahler Ort» te Hahni 111 e m'anë tjetër nga *qethë roga-roga* «qethur shkalla-shkalla». Edhe në të tjera gjuhë emrat e rogave kanë dalë nga «rruaj»; khs. it *radura*. Ndërkaq për ne nuk është e pamundur një lidhje afërie e gjerm. *Reute* gjerm. e lartë e vj. *riuti* me grupin e lat. *radere rodere* etj. ku bën pjesë edhe shq. *rruaj*, me gjithë se fjalorët krahasimtarë i ndajnë këto dy grupe fjalësh. Në atë rasë spjegimi që jep Jokli qëndron. — Sh. dhe *rukë*.

rókëzë f., pas Reinholdit një lodër fëmijësh tek Arbëreshët e Greqisë, që është një të ecur me duar. G. Meyeri 368 mendon — me dyshim — për një huazim nga gr. e re *ροκα* «furkë», kjo prej it. *rocca*.

Më fort një postverbal i *rrok* «e kap me dorë dhe e mbaj», te Kristoforidhi «*ἀπτομαι (κυρίως διὰ τῆς χειρὸς ἐπὶ ἀψυχῶν καὶ ἀκίνητων)*» «*χειροαγωγῶ*». *rok* për *dore*. Në shqipen e Greqisë mbizotëron *r-ja* e thjeshtë.

rokominë «njeri i tharë, i thithur prej pleqërie». Këtë fjalë të Mitkos G. Meyeri 368 mendon — me dyshim — ta spjegojë prej it. *rocca del camino* «shkorsë e oxhakut», spjegim që nuk mund të mbahet gjekundi. Është një me *rrogominë-a* «veskeq, i mbrapshtë, epshuer» te Godini («Wollüstling, Wüstling»). Si e tregon edhe forma e kësaj, kemi të bëjmë me një emër femëror kthyer në mashkullore, me një abstrakt që u bë konkret, e te forma e Mitkos me një emër përdorur si mbiemër. *rokominë rrogominë* është një postverbal i *rrogomís gorromís* «rrëzoj, gremis», *gorromím gramí* «greminë, humnerë» që përdoret në arbërishten e Italisë. Kuptimi i parë i fjalës së Mitkos është pra «rrëzim, plak i rrëzuar prej moshe»; khs. për këtë lat. *caducus* «i rënë, epileptik»: *cado* «bie», gjerm. *hinfällig* «i drobitur, i thyer prej pleqërie»: *falle* «bie», frgj. *déchu, décadent* etj. Për konkretizimin e abstraktit khs. p.sh. gjerm. *Wrack* «mbeturinat e një anie të thyer» dhe figurshëm «njeri i shkallmuar».

rotár m. «shërbyes, shërbëtor». Për këtë fjalë që jepet për gegërishten, mendimi i G. Meyerit (f. 369) që e bie të ardhur nga sllav. (serbokr., slloven.) *ratar* «bujk», pranohet te Selišcevi 178 e 326, Vasmeri 55 e Jokli Slavia XIII 307 v.

I vetmi burim që e jep është Rossi (I 47, 213, 243, 244, 472, 617, 759), me kuptimet «*mozzo, servo per le cose vili; domestico, familiare, servo; fante, garzone, servidore; ragazzo, servo di vili esercizi*» etj. Burimi i fjalës prej sllav. *ratar* është i pamundur, për arsye fonetike dhe kuptimore. Në një fjalë të geg. veriore si kjo më shumë do të pritej që një *o* paratheksore të kthehej në *a* sesa të mos ruhej një *a* paratheksore e të kthehej në *o*. Kuptimisht kalimi nga «bujk» në «shërbëtor i punëve më të vështira të shtëpisë» nuk është afër menç. Është një me *rrogëtár rrogtár* «shërbëtor», te Bashkimi «servente, mercenario», khs. *punoj e rrogoj* «punoj gjithë kohën, derdh mund të madh». Trajta *rotár* e Rossit, në qoftë se ka ekzis-

tuar me të vërtetë si e tillë, ka dalë nga një *rogētār rogtār roktār* me *r-* të thjeshtë, si e kanë Buzuku, Junggu, Tagliavini e të tjerë, sh. *rrogë*. Në grupin *gt, kt* ra okluzivi gutural para dentalit.

ruaj ruej, G. Meyeri 369 e spiegjon nga sllav. e vj. kishtare *chraniti* «me ruejtë», dhe me të mendon të bashkojë dhe *proj* «mbroj» e *trua*, të cilat s'kanë të bëjnë me të. Etimologjia sllave nuk ka gjetur pëlqim as në lagje të sllavistëve. Jokli (Studien 75 v.) vuri re lidhjen e fjalës me emrat *rē* (*vë re*) e *resë* (sh. këto fjalë); për *rē* ai pranon krahasimin me irl. *réil* «i qartë» që bënte Wiedemanni BB XXVII 210. Këtë spjegim e miraton dhe Pokorny I 854, po s'e përmend Fraenkeli 712 v. Pas Barićit (I 88) *ruaj* ka dalë nga një bazë **urāniō*, duke u afruar me gjerm. e lartë të vj. *biwarōn* «me ruejtë», lat. *vereor* «shikoj me frikë e me nderim, nderoj, druaj», gr. *ἐπί* (F) *ὄρονται* «mbikëqyrin» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku p.sh. (XLVIII/2, Gjenezë 37, 11; LII, Mateu 12,2) e *i ati po e ruon një zemërë fjalënë* «pater vero rem tacitus considerabat»; *Për qish punë dishipujtë e tū nukë ruonjënë ordhëninë e pleqet...?* «Quare discipuli tui transgrediuntur traditionem seniorum?». Budi (DC 3, SC 55) *posikūr bariu grigjnë me ruojtunë; ndë ligjt plakë e porësi, qi printë të jënë ndërunë e ruojtunë*. Bardhi *Servare Me e ruetunë, me e mbluem*. Fjala përveç «conservare, servare», sidomos në tosk. jugore e në dialektet e Italisë ka dhe kuptimin «vështroj, shikoj, këqyr»: Pedersen 41, 61 *Vajz e mbretit ruanej nga penxhereja, që të shij plakënë; edhe prëmë ruajmë, e të shomi, se çish do jet ajo pun, në Gjiro-kastër, Çamëri e gjetkë e ruaj në si* «e shikoj drejt në sy» (me dashamirësi); në Kalabri (K. Serembe, Leka III 375) *Lartë te çukat sarkodheja Rrotull ruan edhe gëzohet*; për Molise khs. Lambertz KZ 53, 297. Ky përdorim është më i përhapur, duke e pasur dhe Shpati (kumtim i A. Xhuvanit), Pogradeci e Tomorrica; khs. dhe prej Mirdite *po biejm e e ruejm për* «e shikojmë» (Donisa, Circa II 165). Dhe në greq. e re *φυλάσσω* ka të dyja kuptimet, «ruaj» e «vështroj».

Trajta fonetike e fjalës dhe kuptimet që ka tregojnë se nga etimologjitë që janë dhënë për të, i vetmi i drejtë është spjegimi i Barićit. *ruaj* me *r-* në e thjeshtë të sajne dëshmon se ky tingull nuk ka qenë në pozicion nistor që në krye të herës, sepse atëhere do t'u kish forcuar rregullisht në *rr-*, khs. përkundrazi *rruaj* që shkon me lat. *radere*; kjo flet në të mirë të një baze me *ur-* *vr-*. Kuptimisht fjala bashkon dy përdorime kryesore: më një anë të bërët roje, të shikuarit me kujdes që mos vejë humbur e të prishet një njeri a një send (*ruaj të sëmurin; ruaj vreshtat, shtepinë, të hollat*), më anë tjetër të vështruarit në sy, bashkë me *vë rë*. Kështu kjo fjalë, si verb edhe si emër (*ruaj, rë roe, resë*) është afër me gr. *ὄραω* «shoh» *ἐπί ὄρονται* «mbikëqyrin» *οὔρος* «rojtar», lat. *vereor*, gjerm. *wahre bewahre* «ruaj» gjerm. e lartë e vj. *wara* «roe, re» *wart* «rojtës, rojtar,» let. *veru vert* «shikoj, vë re» etj. Veçanërisht me lat. *vereor* krahasohet të jetë ndërunë e ruejtunë e Budit, ku *ruejtunë* pas zakonisht të këtij autori është sinonimi i *nderunë*. Formalisht *ruonj ruaj ruej* reflekton një **roniō*, kjo një bazë **uroniō* **vroniō* (kjo mbase nga një më e vjetër **urāniō*), me diftongim të *o-* në pozicion nazal. Abstrakti *roe rë* është *rō-e*, ku *ro-* = *ro-* të **roniō ruanj* dhe *-e* sufiksi i femërores: *roje* me *-j* kundra hiatit. Emri tjetër *resë* me të gjitha kuptimet që ka është i geg. jugore, e ka dalë nga forma e kontraktuar *rë*. Sh. *rë roe resë*; khs. dhe

qëndima; kokërr qelqi më e madhe, që u varin foshnjeve e kalamajve, ose kuajve, në ballë, për t'i mbrojtur gjoja nga syri i keq». G. Meyeri e shënon në dy vise: f. 370 pas Reinholdit si *ruazë* «perlë, margaritar» për shqipen e Greqisë, duke e nxjerrë — me rezervë — nga një **prllazë* e rindërtuar, deminutiv i it. *perla*, duke krahasuar për fonetikën *pumbë* për *pllumbë*, *puarë* për *pllarë* «përrallë» po në Greqi. Në f. 371 *Ruezatë e shpinësë* «renes» te Bardhi, te Rossi *ruza të shpinës* e lidh — me dyshim — me *rusë* «kurorë» të Rossit, duke i çuar të dyja fjalët te serbokr. *rusa* «trëndafil» prej lat. *rosa*; *rruzare* f. e spiegon drejt prej it. *rosario*. Helbigu (f. 65, 86) e kundërshton spiegin e fjalës nga it. *perla*. Sikundër ka treguar Jokli (St. Alb. I 1964 58 vv., St. Fil. XVIII = I 3 1964 9 vv.), *ruazë* është një postverbal i *ruaj*, si «mjet që ruan nga syri i keq», i krahasueshëm për kuptimin me gr. *φυλακτήριον* «ruazë»: *φυλάττω* «ruaj». Ky spiegin gjindet që te Kamarda (II 167), i cili *rózatë* «lloj brezi me ruaza si për hajmali» të shqipes së Sigelisë e lidh me *ruanj*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Monoftongimi te *rózatë* e Sigelisë del dhe te i *xoji* «i huaji» po në atë dialekt. Toskërisht edhe *ruazë* pranë *rúazë*, me shpërngulje të theksit në silabë të parafundit. Në gegërishten sot vetëm *ruzë*, *rruzë*, me *u* të thjeshtë. Aty ruhet edhe *ruezatë e shpinësë* «renes» e Bardhit, si *rruzat* «rrotullat, vertebrat», *rruzë e qafës* «qafa», *më duel rruza* «më doli kurrizi», *lashë rruzën* «harxhova gjithë mundin tim», *në rruzë teme* «në qafë time» te FGS. Në Veriun katolik fjala u ka përzier me *rruzare* nga it. *rosario*; prandaj te Budi pranë *vargtë e rgjandë e të praruem*, e *rruozëtë me sã flutura e margalitër* (SC 319) gjindet më shpesh me *rruozët n dorë* «me rruzare në dorë» (RR II 16, SC 130, 182). Në këto rrethana, si e vuri re edhe Jokli, *rusë* «kurorë» e Rossit nuk është veçse *ruzë*, po me grafi italiane (-s- për -z-) e kështu një me *rruzë* «ruazë». Ashtu Junggu pranë *ruz-a* «vertebra» e *ruza e shpins* «osso sacro» ka *ruz-a* «grano della corona, e la corona stessa». Prandaj te *rus-a* e Rossit nuk kemi një dukuri fonetike, një shurdhim të -z-së në pozicion fundor, si mendon ai dijetar, po një paraqitje grafike. Gjithashtu te *ruazë* nuk kemi një -zë kolektive, po deminutive, ose një -zë thjesht formative, pa funksion zvogëlimi, sh. për këtë Xhuvani-Çabej Prapashtesat 109. Edhe *rruza e shpinës* është vështirë të jetë një kalk i it. *filo delle reni*, si mendon Jokli. Sa për diftongun, u pa më sipër se te Budi ruhet trajta me -uo-, te Bardhi jo më ajo, po -ue-, sot monoftonguar në -u-. Në lidhje me Bogdinin sh. *rruzullim*.

rukë: *arrë rukë* «arrë e xhveshur nga lëkura e gjelbër, nga sharku», *rukohem* «rruhem e kruhem». Fjalë e geg. jugore (Elbasan), që s'e ka G. Meyeri. E jep me këto trajta e kuptime FGS. Manni e ka për «waste, devasiated», e *bâj rukë* «devastate», *vënd rukë* «desert, vaste». Është një postverbal me -kë i *rruej rruaj* «vend i rruar», dhe e afër kështu me *rogë*. Me *rukë* lidhet më ngushtë *rugje* «qethur bërë mish» në Gjirokastër, edhe ky një substantiv i adjektivuar, si *rukë. rugje* shpie te një **rugë*, variante e *rukë-s* me -gë, dhe paraqitet si plurali i singularizuar i asaj. Për kuptimin khs. *qethë roga-roga*. Me *rukë* mbase është një emri i familjes *Ruka*, i shpeshhtë p.sh. në anët e Vlorës.

runë f. «pjesa e mbapme e oxhakut, buhari». Fjalë e dialektit të Tiranës, e paregjistruar gjer sot. Pas gjase një hipostazë *ndr unë* «ndër unët, urët e zjarmit».

rus, fem. *ruse ruskë* «flokkuq, qimekuq», për njerëz e për kafshë shtepiake, *pelë ruskë*; *rusë* f. «mushkë me qime si të kuqe». Që prej G. Meyerit 371 (e NS III 57) e marrin më fort për një huazim nga sllav,

(serbokr., bullg.) *rus*, sh. Pušcariu EW 1487, Seliščev 196. Pas Capidanit DR IV 850 nga arom. *arús*, mendim i pranuar dhe te Meyer-Lübke REW 7466; sh. dhe Papahagi 157. Si e kemi shënuar shkurt në Rev. de Ling. VII 1 186, *rus*, si një fjalë kryesisht e toskërishtes, burimin e saj të pandërmjemin mund ta ketë në gr. e re $\rho\omicron\upsilon\sigma\sigma\omicron\varsigma$ poashtu si në sllavishten. Më pak ka të gjarë që të rrjedhë prej aromunishtes, *rus* nuk është fjalë e jetës baritore.

ryj «hyj». G. Meyeri 371 e lë të paspieguar. Barići I 17 e vë baras me *hyj*, si një formë me prefiks *rë-*. Poashtu edhe Manni 164 e 431.

Fjalë e mbarë gjuhës. Si e kemi shënuar shkurt dhe në BSS 4 (1956) 93, *hyj* e *ryj* te Buzuku largohen nga njera-tjetra në kuptim. Khs. për *ryj* *Nxjerëmë n anëmiqshit së mish, Zot, përse u m t̄y ryna* «Eripe me de inimicis meis, Domine, ad te confugi»; *u n̄çuonë të dy pleqtë e rynë n̄vrap mbë të* «surrexerunt duo senes, et accurrerunt ad eam»; *e rynë Sabbejtë, e grabitnë gjithëqish klë* «irruerunt Sabbaei, tuleruntque omnia» (XVIII, Psalm 142,9; LIV, Danieli 13, 19; LXXXX = CX, Jobi 1, 15). Kështu pas gjase kemi të bëjmë me një fjalë të ndryshme nga *hyj*, po që me kohë erdhi e iu pështet kësaj për nga kuptimi, duke u marrë në ndjenjën gjuhësore si *rë-hyj*, *r-yj*. Për përdorimin sinonimik të së dy fjalëve khs. p.sh. *me të ritë, që hiri mbërnda* te Pedersen 183. Pranë *ryj* ka edhe *rryj*, prandaj mund të kemi të bëjmë me një *r* të thjeshtë të moçme, e cila u forcua rregullisht në *rr-*. Kështu *ryj* mund të jetë e afër me lat. *ruo* «përmbys, rrëzoj; rrëzohem; rend, i lëshohem, i derdhem» e irl. *rūathar* «sulm» kymr. *rhuthr* «impetus, insultus». Me këtë grup ndërkaq kanë afruar dy të tjera fjalë të shqipes, *rashë* (*bie*) dhe *rusem*, sh. këto. Për *ryj* mund të pranohet si trajtë bazë një *rrij rij* e të shikohet kjo si një verb zgjerues me sufiks *-inj -ij*; khs. për *i : y* *krimb : krymb*. Trajta *rij* e tosk. jugore ndërkaq (te Pedersen) mund të jetë primare, ose një zhvillim regresiv.

rys «stërvit, e bëj të regjur», *rysem* «stërvitem, regjem, fitoj përvojë; shtrohem, bindem». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. Te Logoreci *me u rysë* «m'u rrahun me gjith farë së ndodhunes; m'u regjun, tue vuejtun të mira e të liga, të vështira e të kqija»; te Gazulli *me rysë këndin, me bâ këndin të rysun* «të rrahun, të regjun me një dije, zanat etj., gjerm. erfahren, it. rendere pratico, praticare, fare apprendere, esperimentare, subire», *m'u rysë* «me fitue dije në sprovë»: *si s'u ryse një herë!; rysu mâ!; jam rysë me këto punë; jemi rysë me robní, me at njeri, me ato të zeza; njeri i rysun* «i rrahun, i regjun»; *rysní* f. «përvojë». Afrimi që bën Xhuvani (Kop. letrar I Nr. 6, f. 11) me *rusem* «zbres» nuk qëndron, as nga forma as nga kuptimi. Është një me *ryej*, te Bashkimi *m'u rye* «esercitarsi», *i rryem* «i stërvitur mirë në një punë, i rrahur me një çështje, i regjur» (sh. *rienj*). Morfologjikisht *rys*: *ryej* të kujton *zhys zhyt; zhyej* (sh. *zhys*). Për kuptimin khs. *i vuar* «që ka parë shumë në jetë të tij, i regjur»: *vua*.

ryzë f. «Ruta graveoleus». Këtë emër bime, e cila mungon te G. Meyeri, e jep Junggu me Bashkimin. Për punë të *y-së* vjen më fort nga lat. *rūta* se nga it. (o sllav.) *ruta*, sh. edhe *rutë*. Fjala latine ka shkuar dhe në gjermanishten (*rūta, Raute*), prej nga kaloi në gjuhët sllave, Kluge-Goetze 478, Kiparsky Die gemeinlav. Lehnwörter aus dem Germ. 122 vv., Vasmer REW II 552. — Me këtë fjalë shqipja piqet, si shpeshherë, me gjuhët romane perëndimore; rum. *ruta*, te Pušcariu EW 1489 marrë për fjalë latine, nuk përmendet si e tillë te Meyer-Lübke REW 7470. Sipas Siadbeit RIEB III 460 *ruta* në rumanishten s'është fjalë popullore. DLRM 730 e

bie të ardhur si fjalë librash prej latinishtes letrare. Sh. dhe *rutë*. Nga lat. *rūta* në *ryzë* do të mendohet një **rŷtzë* si shkallë e ndërmjeme. Për pajisjen e shpeshtë të emrave të bimëve me sufiks *-zë* sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 108, khs. dhe *trumzë*. — Në parim *ryzë* mund të ridhte nga *ρυτή* e greq. së vjetër, nga e cila shqipja dihet se ka marrë mjaft emra bimësh. Po vendi i theksit bën më të gjashëm burimin latin, me gjithë se s'është pamundur dhe një shpërngulje e theksit. Sh. për këtë kriter dallimi vrejtjet tona Revue de Ling. VII 1 183.

Rr

rrafsh m. «fushë, vend shesh, i dystë», si ndajfolje e *mbushë rrafsh*, e bëri *rrafsh me dhe*; *rrafshinë* f. «vend rrafsh», *rrafshó* «bëj rrafsh, mbush rrafsh, bëj rrafsh me dhe, shkatërroj (një qytet)»; *i rrafshët*, *i rafshët* «i sheshtë, i shtruar, dyst», për njerëz «i thjeshtë, i shtruar». Neologjizma *rrafshím* m. e termet gjeografike *rrafshnaltë* f., *rrafshultë* f. Sikundër dihet, huazim nga sllavishtja. Pas G. Meyerit 360 nga serbokr. *ravan* «rrafsh» sllav e vj. kishtare *равна* «planus», e cila dha sëpari verbin *rrafshoj* nëpërmes të një **rav(n)ëshoj*, e prej verbit u formua emri *rrafsh*. Përkundrazi pas Joklit (LKU 175 vv., IF 49, 286 v.) *rrafsh* ka dalë nga një variante *ravos-* e sllavishtes jugore, e cila dha sëpari trajtën *rrafsh* të geg. veriore, *rrafshoj* është një denominativ i *rrafsh-it*, e nga sllav. *ravn-* rrjedh geg. *rrue* (sh. këtë fjalë). Khs. dhe Selišček 187.

Del që te Buzuku (LXXVI = LXXXVI, Luka 19,43 v.): *e të të ngjëronjënë për gjithë enëshit, e të të rafshonjënë* «et coangustabunt te undique : et ad terram prosternent te». Në toponimi të Veriut ka *rrafsh* edhe *rrapsh*, si edhe trajtën sekundare *rrash*, sh. Gazetteer 140, 141, 142, 146. Për thjeshtimin e grupit *fsh* në *sh* në geg. veriore sh. dhe vrejtjet tona BUST 1, 1958, 69 v. Që ky thjeshtim të jetë mjaft i mocëm në geg. veriore, për këtë duket të dëshmojë emri mesjetar sllav i Sanxhakut të Novipazarit. *Rasha Rashka*, i cili pas gjase reflekton një *rash* (për *rafsh*) të shqipes, *Rrashi i Dukagjinit*. Khs. prej Bardhit (f. 196 v.) *Ciuitas noua, siue Ducagina aedificata his nostris temporibus iu arduis, asperisq. Albaniae montibus a Turca quodam Epirota nomine Buloli, Ducaginarum Praefecto, vel vt Turcico more dicamus, Sanzacho, Città nuoua, o Ducagini, Gjytetja e rë, oò Dukagjin*.

rrah m. «vend që ka qenë pyll dhe është hapur për tokë buke a për kullotë»: *çel rrah*; *i shtriu rrah për dhë, ra rrah për dhë* «ra shakull për dhë». Fjalë e mbarë gjuhës, që mungon te G. Meyerit. Del sëpari te Budi (SC 321, DC 185 b): *e të zī posikūr thëngjilli i shqimbunë, o kërcuni i djegunë ndë rrahat; I qiti rraha për dhë* (vdekja njerëzit). Nga fjalorët e ka Kristoforidhi si *rrah-u* «qilizmë», me spjegimin e shtjelluar «kur presënë ndonjë pyllë a ndonjë zabel, a ndonjë vent djerr, ani shkulënë rrënjatë e kërcunjtë, pramë e punonjën'e bëjënë afë a veshtë», *çel rrah* «άνοιγω κύλισμα» Bashkimi *rrah-i* «terreno ingombro d'alberi tagliati da dissodarsi», Godini «Gestrüpp». Logoreci ka verbin *me rrahanue* «me rruzue rrah për tokë, me dërmue, me rrenue tue qitun rrah për tokë», të cilin e jep edhe Manni. Më e sigurtë e më e përdorur është *me rrahue* «me lëshue rrah për tokë, me shtrure për tokë sikurse lisat kur çilet toka rrah: *u rrahuen gjindja; u vranë e u rrahuen; me ra rrah; i rrahoi lufta; i rrahoi era degët*», që sjell Gazulli prej Malsisë së Madhe, bashkë me emrin *rrahije-t* fpl. «tokë të çilme rrah» e me pluralin tjetër *rrihna-t*. Për toskërishten e dëshmon fjalën N. Frashëri (Istori e Skënderbeut 152). Shprehjen *hap rrah* e ka Semani i Fierit (J. Thomaj. — Nga format e fjalës do përmendur se *rrahije-t*

e Gazullit është një plural më *-ije* dalë nga *-inj*, khs. *Kopështinjëvet* te Bogdani, sot *kopshtijat*, Li. Posn. VIII 75. Shkodra për *rrah-i* përdor fem. *rrahe* (*N'at rrahe t'dekne mbrenda vorrit t'errshëm* te elegjia «Nji lule vjeshtet» e Gj. Fishtës), një plural i singularizuar, sh. poaty f. 76. Për pluralin metafonik *rrihna* të Veriut (*a: e: i* sh. poaty 124 v. Ai del dhe te emri *Rinas*, sh. këtë emër. — Etimologjikisht *rrah-u* është identik me verbin *rrah*, me të cilin piqet krejt në formë, poashtu si *ngul-i* me verbin *ngul*, si *myk-u* me verbin *myk*, *ndryshk-u* me *ndryshk*. Kuptimisht *rrahu* është vendi ku janë *rrahur* drurët e rrëzuar përdhe. Khs. prej gjuhësh së tjera gjerm. *Schlag*, *Schlagwald*, lat *caedes* e **caedita* «*rrahim* i drurëve» (prej *caedo* «*rrah*») në gjuhët romane (te Meyer-Lübke REW 1462, 1463). Për përhapjen e fjalës në toponiminë e Veriut (*Rrahi* i Çersës, *Maja e Rrahit* në anë të Shkodrës) sh. Gazetteer 146; *Maja e Rrahit* edhe në Krej-Lurë. *Shtegu Rrahut* në Kallarë (Kurvelesh) nuk mund të thuhet nëse hyn këtu apo i përket fjalës *ραχ* *ρεχε* «breg, kodër».

rrah «e godit, i bie; përrshkoj një vend», *rraha dhenë*, intrans, *rrah zemra*, figurshëm e *di ku rrah ai*; *rrihem* «zihem, përleshem»; *rrihen peshqit* «lahen, bashkohen seksualisht». G. Meyeri 371 v. e AS III 17, 44, 65, 73 e bashkon brenda gjuhës me *rashë* (*bie*), dhe duke e çuar te një trajtë e vjetër **rrath* e këtë te një më e vjetër **rradh*, e afron më tej me sllav. e vj. kishtare *u-raziti* «përcutere». Këtë bashkim me *rashë* e lëfton me të drejtë Pedersen 111, duke treguar se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Përkështu edhe Jokli (Slavia XIII 611), i cili ndërkaq (Studien 76, LKU 49) afron *rrah* me *rras* e më tej, si G. Meyeri, me sllav. *u-raziti*. Rezerva te Barić I 88. Vasmeri REW II 485 bashkon *rrah* dhe me *rras* dhe me *rashë* e jashta shqipes me fjalën sllave. Restelli (Rend. Ist. Lomb. 91, 542) e krahason me ind. e vj. *rākṣas* «mundim, hie e ligë», gr. *ῥερέχθω* «nduk, gris, shkyej».

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku ruhet trajta e mirëfilltë me *-h*, ashtu si në toskërishten: *por rih krahënuorë e tī* «sed percutiebat pectus suum» (LXXVI=LXXXVI, Luka 18, 13). Po tek autorët veriakë pas tij ka depërtuar trajta më e re: Budi (DC 113,126 v.) *as të mos rafnjëmë, i rref e j shān*, Bardhi Percrudere *Me rafunë*, Perculus *Rafunë*, Recedere *Me rafunë për së dÿti*, Vapulare *Me u rafunë*, sh. BUST 1 (1958)65. Një postverbal i *rrah* është *rrahçë* «vegël peshkimi në trajtë koni, vallkua, pinar», sh. këtë fjalë. Të tjera rrjedhoja janë *rrahcë* f. «purtekë e pushkës, harbi» e *rrahës* m. «dru shpatuke për të rrahur këmishët kur i lajnë, pallë»; i arbërishtes së Italisë është kompoziti *rrahaderë* «për një njeri që rrah dyert e botës, girandolona» te Kamarda II 112. Morfologjikisht *rrah* është një verbum inchoativum më *-h*. Për hetimin e etimologjisë nuk është nevoja, e as e për ligjur, të ngjitemi te një bazë e rindërtuar **rrath* e s'andëjmi edhe te një më e moçme **rradh-*. Me gjith'atë afrimi me fjalën sllave sllav. e vj. *u-raziti* «përcutere», sloven. *u-raziti* «me lëndue» çek. *raz* «goditje» pol. *razić* «me plague» rus. *razit*, *razù* «*rrah*, i bie» *rezat*, «me pre» mbetet mjaft afër menç. Shq. *rrah* mund të afrohet në këtë mes sidomos dhe me gr. *ράττω* *ράσσω* «*rrah*, shtyj, shtyp» *κατα(ρ)ράκτης* «ujvarë; zhytërr» *ραχία* «shkulm deti, dallgë, baticë». Për këtë fjalë pranohet nga shumë anë një afëri me sllav. *u-raziti*, sh. Boisacq 837, Lidén Anlautges. 24 vv. Walde-Pokorny I 318 v., Hofmann GEW 295 v., Cimochofski Li. Posn. III 161. Pokorny I 1181 v. përkundrazi parapëlqen një ndarje të këtyre dy fjalëve e një bashkim të *u-raziti* me gr. *ρήγνυμι* «thyej, shkyej, shpërthej»; poashtu Fraenkel 726, sh. edhe Vasmer në vendin e cituar. Ky afrim i *rrah* me *u-raziti* e *ράττω* *ράσσω*;

për arsye të vokalit të brendshëm (-a-) është më bindës se ai me gr. ἐρέχθω, e cila pas mendimit të përgjithshëm reflekton një bazë me -e-, *rekP*—, e cila edhe nga kuptimi («dëmtoj») qëndron disi më larg. Shq. *rrah* do të mendohet si e dalë prej një baze **urag'h-skō*. Në këtë rasë për r-në jo-nistore indoeuropiane do të pritej në shqipen një r e thjeshtë. E sotmja *rr*- ndërkaq është e spjegueshme te një element i leksikut efektiv siç është *rrah*. — Sh. edhe *rrahm*.

rrallë (i). Këtë G. Meyeri 372 e bie vërtet të ardhur nga lat. *rallus* «qethur rrafsh, pa qime» (për tunikën), po nuk lë ndërkaq pa shënuar span. port. *ralo* «i rrallë, i hollë» etj. që i spjegojnë nga lat. *rarus*. Te *rarus* e lidh fjalën Pedersen (KZ 33, 539), për punë të kuptimit, duke pranuar një disimilim r-r në r-ll si te *prall* nga gr. e re πουργάρι e te *strrall* nga gr. e re στερνάρι, khs. dhe *kundruall*. Poashtu Weigandi 74 e Puşcariu DR V 409 v., i cili nga lat. *rallus rillum* nxjerr arom. *rauă* «shtek i bardhë që duket në kokë kur bien flokët».

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi ka Rare *Rāll*, Raritas *Të rālltë*. Nga *rrallë* ka dalë verbi *rralló* me *rrallohem* e mbiemri *rrallúk* për një kalli misri me kokrra të rralla, me -uk pejorativ si *firúk*, *harrúk* e sidomos (miser) *vjeshtúk* që afrohet me *rrallúk* dhe nga kuptimi, sh. për -uk Xhuvani-Çabej Prapashtesat 99. Kompozitë popullore janë *rrallëherë* e *rrallëkúsh*.— Nga spjegimet e fjalës, i drejtë është ai prej lat. *rarus*, me disimilim të likuidës. Këtu fjala e shqipes afrohet me reflekset e lat. *rarus* në disa gjuhë e dialekte romane perëndimore, për të cilat sh. Meyer-Lübke REW 7067. Një tjetër disimilim i tillë çfaqet te *kundruall*.— Për arom. *rauă* sh. *ravë*.

rrap m. «Platanus», *rrap i egër* «Acer pseudoplatanus, panjë e malit» (Mitrushi 269), *rrapishtë* f. «vend me shumë rrepe». Pas Tomashekut (Z.f. öst. Gymn. 1875 f. 529), Miklosichit (EW 277,2) e G. Meyerit 372 e afër me sllav. e vj. kishtarë *rěpina* «rrap». Për një huazim prej sllavishtes (bulg. së vjetër) e merr Weigandi 74. Poashtu Selišcevi 164, i cili e bie të ardhur nga sllav. *grab* «shkozë». Kundra këtij spjegimi të fundit sillet me të drejtë Jokli (Slavia XIII 309 v.), si me arsye fonetike (*gr*-nistore ruhet në shqipen si e tillë) si me arsye objektive të përgjithshme. Ai çiftin *rěpina* — *rrap* e vendon te baza indoeur. **rěp-* **rəp-* «hu, tra», ku hyjnë ndër të tjera dhe sllav. e vj. kishtarë *rěpijb* «hu, direk» *repbje* «τρίβολος», gjerm. e vj. e lartë *rāfo* «qepër, tra». Baza e fjalës sllave sipas tij **rěp-*, ajo e shqipes **rap-*. Kështu dhe Vasmeri REW II 513.

E mbarë gjuhës. Del shpesh në toponimi, si *Rrap*, *Rrapaj*, *Rrapës*, *Rrapëzë*, *Repisht* (prej shm. *rrepe*) etj., sh. Seiner 97, Gazetteer 141, 146. Vokalizmi i fjalës së shqipes dëshmon për pavarësinë e saj nga fjala sllave. Mund të pranohet, me Joklin, një raport apofonie midis dy fjalëve. Kemi të bëjmë me një konkordancë parciale sllavo-shqiptare.

rrasë f. «pllakë guri, plloçë». G. Meyeri 66 këtë fjalë, bashkë me *dërrasë* e me *taracë*, pas hullisë së Miklosichit e spjegon nga it. *terrazza* *terrazzo*, ven. *terrazzo* «quel pavimento delle case o d'altri luoghi che si lavora coi frammenti di terra cotta», sh. dhe Ngri. Studien IV 88. Etimologji e pranuar te Puşcariu (XI. Jahresber. d.Rum. Inst. Leipzig 78) e te Helbigu (f. 70, 91). Manni (Language 28,33) e Cimochofski (Li. Posn. III 158 vv.) e ndajnë *dërrasë*-n prej *rrasë*-s. Ky dijetar i fundit *rrasë*-n e afron me kymr. (kelt.) *rhath* «fushë, nderë» *riathu* «zdrugoj», të cilat i lidhin me lat. *rodo* «brej» *rado* «rruaj»; *rrasë* sipas tij prej një baze **rat-t-*, kjo prej një **rad-t-*, me ndrim të *tt*-së në *s* në gjuhën shqipe; te *taracë* ai njeh me të drejtë një huazim nga italishtja.

Del që te Buzuku (XLIV/2, Eksodi 24,12; LV/2 = LXV/2, Mateu 27,60): *e u të t ap d̄y rasa n̄ guri e ligjñe e ordhëninë qi u kam shkruom* «daboque tibi tabulas lapideas, et legem ac mandata quae scripsi»; *E aty i vu një rasë të madhe përsipëri mbë derët të vorit* «et advolvit saxum magnum ad ostium monumenti». Budi (DC 54,) *i dha shkruom ndë një rrasë marmuri këto të dhjetë urdhënime*; sh. dhe SC 51. Bardhi ka Muscipula *Krëfëca o rasa me zanë zogj, e mī*; Bogdani (II 19,5; 94,30) *possi depërtoi Rasënë e vorrit* «come penetrò la Pietra del Sepolcro»; *të mirrinë popullinë me veti ndaj një rase* «che conducessero il popolo appresso ad una pietra». Jarniku (Zur alb. Sprachenkunde 16) ka *rrasa sermit* «Platten Silbers», Kurti (I² 117) *e të shtrueme me rrasa mermerit*, Gazulli (f. 51 te avër) *rrasa akulli qi barin ujnāt*, Hasluck 40 për geg. jugore *çilën rrasën* «They opened the stone trap-door»; *rrasa quhen dhe pllakat me të cilat luajnë kalamajtë: rras'e buq*, univërbim në *rrasbuq* (sh. *buq*). Për Kosovë e dëshmon fjalën si *rasa* «ploča» Elezovići, Arhiv II 259. Një kuptim teknik jep Nopcsa (f. 135) për Veri: *rosa* «Olivenquetsche» (me ndrimin *a : o* të atij dialekti). Kuptimin e kapakut ka marrë fjala te shprehja *ka gjetë rrasa vegshin* «gjeti tenxherja kapakun», nga puna se në Shqipëri sidomos në jetën fshatare një rrasë guri përdoret shpesh për të mbuluar qype, kusi e të tjera enë; sh. për këtë shprehje G. Gurakuqin (HD IV 59 vv.), i cili e krahason me lat. *dignum patella operculum* të Sh. Jeronimit, sipas tij një idiomatizëm i ilirishtes te ky shkrintar i Dalmacisë; po khs. dhe vërtetjet e Joklit në IJ X VII 88. Një krijim duhet të jetë deminutivi *rrasëza-t* pl. «leskërzat në bisht të mive» te J.H. Hyseni, Kop. letrar I Nr. 12 f. 15. Me *-ik* është formuar mbiemri *rrasik* «shpatuk, petashuq», te Junggu «piatto, schiacciato» pranë primitivit *rras-a* «lastra di pietra, lapide».

Fjalë e mbarë gjuhës, sepse edhe e toskërishtes. Aty del për «gur varri, pllakë varri» në këngën e Lenorës në Hoshtevë të Zagorisë: *Kostandini u grit nga varri, Rrasa iu bë kalë, Balta iu bë shalë* (sh. Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe 194); në Verçë *rrasë* quhet një faqe shkëmbi në mal. Si e kemi shënuar dhe më parë (Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 71, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 2, 1961, f. 56), *rrasë* e *dërrasë* janë në thelb një fjalë, dhe kjo e fundit është një kompozit i asaj me prefiks *dë-*. Nga autorët e vjetër të Veriut Buzuku ka vetëm *rasë*. Budi, Bardhi e Bogdani i kanë të dyja, po *dërrasa* e Bogdanit (*ato të dy dërrasa të Lijsë plakë* «le due Tavole della legge») puthitet në kuptim krejt me *rasë-n* e Buzukut. Ndërkaq mund të thuhet se diferencimi formal i *dërrasë-s* nga *rrasa* ka çuar dhe në një diferencim dialektor e semantik: *rrasë* është sot një fjalë e gegërishtes, *dërrasë* e të dy dialekteve; këtë e vuri re edhe Hahni (f. 207 v), kur gjerm. *Stein* e shqipëron toskërisht me *pllagë*, *dërrasë*, gegërisht me *rrasë* (e *plloçkë*). Semantikisht *rrasë* në gegërishten është një pllakë guri a një gur varri, *dërrasë* një dhogë druje; në toskërishten *dërrasë* shënon sipas krahinave të dyja sendet; nuk mungon aty dhe kuptimi i kapakut që ka *rrasa* në Veri: te N. Frashëri (Gjithësisja 65), *kur zjen uji në kusit të mbuluarë me dërrasë*.— Vëzhgimi historik i fjalës do të niset nga *rrasë* si forma primare e saj. Ky emër është një postverbal i *rras* formuar me *-ë*, sufiks i shpesh të në këtë kategori emrash. Kuptimi i një rrase guri a metali ose i një dërrase së drunjte mund të mendohet që ka dalë nga ai i të rrasurit, të dendurit.

rrasht m., *rreshtna* «asht, kockë». Kjo fjalë si singular mungon te G. Meyeri. Ai jep vetëm (f. 373) *rreshtë rrezhdë* f., me kuptimet «asht» e «rezhdë që i varet deles nën gushë» dhe e spiegon nga lat. *arista* «thak i

kalliut, kalli, kreshtë, halë peshku», it. *resta*. Si e kemi shtjelluar dhe gjetkë (Bul. për Shk. Shoq. 3, 1954, f. 59 v.; Lii. Posn. VII 184 vv.), *rreshtë* nuk është veçse plurali metafonik e i singularizuar i *rrasht*-it, ashtu siç është *është* e *asht* i *asht*-it; *rrasht* vetë është formuar nga *asht* me prefiks *r(ë)*- *rr(ë)*. Në plural *rrasht* bën *rreshtna*, te Bogdani (I 50,11) *Reshtëna te t vramet*. Singulari i ri *rreshtën* f. e *rreshtë* f., njëra me mbaresën *-në* të pluralit, tjetra pa të. Lidhjen e *rreshtë*-s e *rreshtën*-s me *asht* e vuri re sëpari Hahni f. 109. Sh. dhe *rrashtë* e *rezhdë*.

rrashtë f. «kafkë e kresë, rradake»; e *la rrashtën atje* «la kryet»; *rrashta e breshkës* «kafkulli, samari i breshkës»; *rrashtinë* f. «kësulë, plis». G. Meyeri 372 *rrashtë*, (Mitko) *rrazhdë* «thërmiqe garraçash; kafkë» e afron me lat. *rastus* «σκάτιον, çini, çanak», kurse *rrashtë* f. «farashë» bashkë me *rrashtjël* e spiegon nga it. *rasta rastro* e *rastrello* ven. *restelo*. Si e kemi shtjelluar dhe më parë (Bul. për Shk. Shoq. 3, 1954, f. 59 v., Li Posn. VII 184 vv.), Hahni 107 jep *rrashtë* «l. farashë, 2. çdo garraç i thyer, ku p.sh. hanë e pinë shtazët», Junggu *rrasht-a* f. «cranio», Bashkimi *rrasht-i* m., pl. *rreshtën* «cranio» e *rrashtë-a* f. «cranio», poashtu Cordignano, Weigandi *rrasht-i*, pl. *rreshtën* «asht, kockë, kafkë»; dhe Kristoforidhi jep së bashku *rrashtë-a*, për Kavajë *rrasht-i*, e geg. *rreshtë-a rrështënë-a* «κόκκα λον, όστούν». Të gjitha këto forma çojnë te *asht*, pl. *eshtra eshtra*, kështu që *rreshtë* e *rreshtën* f. janë pluralet e singularizuara të *rrasht*-it e kjo vetë një kompozit i *asht*-it me *rr(ë)*- *rë*-. Sa për *rrashtë*, kjo është fjalë e mbarë gjuhës, meqë përveç Veriut e ka dhe Labëria. Morfologjikisht paraqitet si femërorja e *rrasht*-it. Kuptimi «kafkë» mund të spiegotet me anë të një elipse, duke u lënë jashtë te *rrashta e kresë* «ashti i kresë, kafka» pjesa determinonjëse e *kresë*, rrugë që me një ngushtim kuptimi çoi te *rrashtë* «kafkë». Prej «kafkë» u arrit dhe te «çdo garraç i thyer, ku p.sh. hanë e pinë shtazët» e më tej te «farashë»; khs. zhvillimin e përkundërt të lat. vulgare *testa* «garraç; kafkë» në gjuhët romane. Ndërkaq te *rrashtë* «farashë» mund të ketë ndikuar me etimologji popullore dhe *farashë*, që Rossi e ka *ferrásht* me geminacion ekspresiv të *r*-së (sh. *ferrásht*).- Khs. edhe *rrasht*.

rrë rrā f. «*Ascaris lumbricoides*, krimb që zënë zorrët sidomos të fëmijës, bubë». G. Meyeri 372 e jep me trajtat *rrājë* e *rrë* shm. *rrā-të*, geg. dhe *rrājzë*, mendon si formë bazë një **rnajë* dhe përsjat për këtë një burim nga lat. *crinālis* «që u përket qimeve, flokëve», duke sjellë për krahasim frgj. *crinon* «lloj krimbi i hollë si qime». Këtë etimologji e kundërshton Pedersen (KZ 33,538) për arsye fonetike, me që *l*-ja ndërzanore është velarizuar në shqipen. Bariçi I 88 niset nga një **urogā* si formë bazë e fjalës, dhe e afron kështu me grupin e irl. së vj. *frige* «krimb i mishit» kymr. *gwraint* «krimb», gr. *ρόμος* «krimb i drurit», lat. *vermis* «krimb» etj. Weigandi BA III 217 *rrë* bashkë me *rrëndës* i spiegon nga lat. *ren renis* «ije». La Piana SLA I 66 e përçqas me lat. *vergo* «prirem, anoj, sillem nga një anë».

Fjalë e mbarë gjuhës. Sikundër e kemi shënuar shkurt dhe në Rev. (roum.) de Ling. VII 1 191, mendimi i një burimi nga lat. *crinālis* nuk mbahet, si për arsye fonetike, si për punë të kuptimit, si edhe nga puna se lat. *crinālis* nuk ruhet asgjëkund nëpër gjuhët romane. Po për arsye fonetike e kuptimore bashkë nuk qëndron as spiegonimi nga lat. *ren renis*. Fjala paraqitet me një larmi variantesh dialektore: Bardhi Lumbrici, Vermi *Rae*. Kristoforidhi ndër të tjera dhe *rrehë* me shm. *rrëhénj*, Junggu *ráiz*, Bashkimi me Cordignanon *rrājzë* «karrem, glistër»; në Përmet *rrë-një-t*, në Nivicë *ka zënë rria*, të dyja shumëse (M. Totoni). Për historinë e

fjalës është me rëndësi të hetohet forma bazë e saj. Si të tilla përjashtohen a priori *rrajë*, *rrajzë rrâjzë*, *rrehi rrênhenjtë*, *rënjë-t rria-t* me gjithë shoqet e tyre : geg. *rrajë* ka dalë nga shumësi *rraja*, është pra një shumës i singularizuar; *rajzë rrâjzë* është deminutivi i saj; *rrehë rrêhënj* është një trajtë e *rrë-së* me *-h-* kundër hiatit, *rrënjë-t* një shkurtim i *rrêhënj* me rënie të *h-së*, *rria* si duket në analogji me *thërria*. Kështu vetëm *rrë* e *rrā* vijnë në vështrim si trajta bazë eventuale të fjalës. Mbase ka të drejtë Kamarda (II 207) me G. Meyerin (AS I 68), me Kristoforidhin (f. 353) e me La Pianën që *rrā* është trajta e shumësit; atëhere *rrā*, e cila mbizotëron në tosk. jugore, do të qëndronte ndaj *rrë* si të *rā* ndaj *e rē*, të *vā* ndaj *e vē*, e do t'ishte një shumës i singularizuar. Ndërkaq *rrā* e *rrë* mund të jenë të dyja sekundare e të piquen të shm. *rae* «lumbrici» i Bardhit; khs. *bae* që dha bazë *hobé bézezë*, *ngae* : *ngā ngē* etj. Kontraksioni te *rae* : *rrā rrē* tregon se midis dy vokaleve ka rënë një okluziv i zëshëm. Nga kjo pikëpamje përlligjet në parim dhe afrimi me kelt. *frige* e *gwraint*, lat. *vermis* etj. (me gjithë se shqipja ka fjalën *krimb*), dhe përqasja me lat. *vergo*. Po të dyja këto etimologji kushtëzohen me rrethanën që grupi *ur-* (*vr-*) i pozicionit nistor reflektohet në shqipen me *r-* të thjeshtë. Më të tillë *r-* e shkruan fjalën Bardhi; poashtu më vonë edhe Junggu, ndërsa në të tjerat burime mbizotëron kudo trajta me *rr-*. Një fortim i *r-së* nistore në fazën e re të gjuhës nuk është e pamundur. Po në qoftë se *rr-*ja e sotme është e moçme këtu, ajo pas ligjeve fonetike të shqipes duhet të rrjedhë nga një *r-* e kryehershme e thjeshtë. Në këtë rasë paraqitet mundësia e një afërie me lat. *corrigia* «rryp i këpucës; rryp, kamxhik», irl. e vj. *conriug* «ngjit, lidh së bashku» *cuimrech* (nga **kom-rig-om*) «lidhëz, pranga, hekura», ku mbase hyn dhe gjerm. e lartë e mesmja *ric rickes* «lidhëz, nye», sh. për këtë grup fjalësh Walde-Pokorny II 347, Walde-Hofmann I 278 v., Ernout-Meillet 223, Pokorny I 861 v. Për kuptimin e fjalës shqipe khs. gjerm. *Bandwurm* «tenjë»; *Band* «lidhë, gajtan», *Spulwurm* «rre, rra»: *Spule* «roketë», nga gjuhët romane moden. *tzintur veron. sentanino* «rre» nga lat. *cinctūra* «brez», Bertoni te Meyer-Lübke REW 1922, nga shqipja vetë *shirit* dhe me kuptimin e livrizës (*Taenia solium*).

rrej «gënjej, thom rrena», *rrehem* «gënjehem», *i rrejshëm* «jo i vërtetë»; *i rrem*, fem. e *rreme* «i gënjeshtërt, jo i vërtetë», *gjellë e rreme* «gjellë pa mish, gjellë kreshmore», e *rreme* f., pl. të *rreme*, të *rrema* «gënjeshtërt, rrenë»; *rremës rrëmës*, *rremásh*, *rremáll* «gënjeshtar», kal. (Santori) *katarëmbë* f. «roman» (me *kata-*), *rrenë* f. «gënjeshtërt, e rreme», *rrenës*, *rrenacák* «rremash». Për këtë fjalë G. Meyer (f. 373 v., Alb. Studien V 100) nuk jep ndonjë spjegim. Pedersen (KZ 33, 542 shën. 2) e afron me gr. *ἀρρέου* «mohoj, refuzoj», duke krahasuar për kuptimin *nërroj* «mohoj» (te Rossi) nga **rrënoj*. Etimologji e cituar me rezervë te Walde-Pokorny I 78 e te Pokorny I 62. Bariçi (I 88 v.) lëkundet midis një burimi autokton (baza **uro-mo-*) e një burimi prej gr. së re *ἀρρέουμαι* Tagliavini 236 i mbahet spjegimit të Pedersenit.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LIV/2, Danieli 14,49; LIX/2, Gjoni 8,55) *përse rëshim dëshmuonë kondra saj* «quia falsum testimonium locuti sunt adversus eam»; e *u në thoshë se nukë e njoh, u jeshë porsì ju renës* «et si dixero quia non scio eum, ero similis vobis mendax». Budi (DC 61, 119, 187b) *ashtu ende qi aspak me mos u përbëm e me mos bām bē rrenë; e cia kafshë është rrenë; Këjo mā s ashtë rrenë*. Bardhi *Falax Mendax Renës*, *Mendacium Rena*, *Mentitur Thotë rena aj*, *Vanidicus Rēs*, *Vaniloquus Renës*, *ō i mbrazëtë*, *Vaniloquentia Rena*, *ō të mbrazëtëtë*. Boçari

37 i rēmë. Etimologjikisht «e rrej» është «ja bëj të errët, ja errësoj, mjegulloj»; khs. lat. *tenebrio*, -nis «batakçi»: *tenebrae* «errësirë»; gjerm. *hinters Licht führen* «me rrejtë, me mashtrinë» (fjalë për fjalë «me çue mbrapa dritës»), rus. *moročit*, «me mashtrinë»; sllav. e vj. kishtarë *omračiti pomračiti* *σκοτίζειν morók* «errësirë, mjegull» e «vilani, fantazi, mashtrim» Berneker II 78, Vasmer REW II 160. Edhe Bardhi pranë *Tenebrae Terrëtitë*, *Tenebrescere Me u errunë* ka *Tenebriones Renësitë*. Nga një kuptim i mëparmë «ja bëj të errët» kuptohet edhe pse verbi *rrej* në të parë ka qenë përdorur me objekt dativ: Budi (DC 183a) *Asnji fjalë me i rrëm*, *As n doret me i shptuom*, e mbase edhe *E aj vërtet u kallëzoi e nukë u reni* «Et confessus est et non negavit» te Buzuku (XXX/2, Gjoni 1,20). Nga *i rrej* u bë *e rrej*, sikurse nga *i ve re* u bë *e vë re*. Morfologjikisht *rrej* është një zgjerim verbal i *rê-së* me *-nj*. Te *rrej*, *rrenë*, *i rrem* *r-ja* e fortë rrjedh nga një geminacion ekspresiv, i natyrshëm te një fjalë afektive siç është kjo. Abstrakti *rrenë* është participi më *-në* i substantivuar. Është trajtë e mbarë gjuhës. Përveç tosk. jugore *rrerë rrërë* «*rrenë*» që sjell Pedersen 183 ekziston dhe verbi *rreroj* «mohoj» i çamërishtes. Në Siqeli *rrërë e vërtetë*, si e vë në dukje Pedersen, ka qenë kuptuar keq te Kamarda II 142. Del sëpari te Matranga (botim i La Pianës f. 38): *Mos bëjsh bē rerë* «Non dir falso testimonio». Substantivimi i participit *rrenë* (*r*)*rerë* do të ketë kaluar nëpër shkallën e mbiemrit o adverbit në shprehje si *bē rrenë*, tosk. *mos bēn bē rrem*. Në dialektin e Greqisë emri abstrakt u **diferencua** në *rëimëzë*, duke marrë sufiks *-zë*, këtu pa funksion deminutiv; poashtu *renz-a* e Borgo Erizzos. Për një të tillë funksion të këtij sufiksi sh. Xhuvani-Çabëj Prapashtesat 108. Për nga forma, *rëimëzë* e Greqisë afrohet me *i rrej*, si substantiv *e rrej*, pl. të *rrej* *ma* që jep Pedersen për anët e Çamërisë. Është një nga konkordancat e veçanta të tosk. jugore me dialektet e Greqisë (e t'Italisë).

rremb rrem rrëmb m. «degë; seecila nga degët e brirëve të drerit; krah lumi, *rrem(b) uji*; pjesë, krah ushtërie; rrudhë; *rrembat e gjakut*, enët e imta të gjakut; *mermer rremba-rremba* «me damarë»; fig. *e ka një rrem marrie*. Nga lat. *rāmus*, Miklosich AF II 688, G. Meyer AS I 45 e EW 364 v., Weigand 74, Philippide II 671, Tagliavini 235 v.

E mbarë gjuhës. Nga dy sinonimet, *dega*, fjalë vendi, u ka ruajtur në gjuhën popullore me kuptimin e vjetër konkret, krahas me më të rejat *gemb gjemb* e *lumák lumaqe*; *rrem rrëmb* ka marrë më fort përdorime të veçanta, sidomos abstrakte, dhe ka kështu një vlerë stilistike brenda fjalorit të shqipes. Ashtu na çfaqet që te Budi (DC 67, RR 52): *mirë na e mson ... fort me e ruojtunë ... kurvëniet, e gjithë rembashi cë sāj; e rrathëtë, e rrembatë, o rranjë të e tyne* (scil. të mëkateve). Po Bardhi *Ramus Remb*, *Ramus arboris Remb i lisit*. Kristoforidhi e Weigandi kanë dhe deminutivin *rrembth rremth* «bisk», *nji rremth ullini*. Në Çorraj (Kurvelesh) figurshëm *s'ka rrëmb nga ata* «s'ka damar nga ata, s'u ka gjarë atyre» (në fis, në gjak, në trimëri) (A. Dhrimo). Për Siqeli Kamarda I 130 jep kuptimin «vile rrushi», për Kalabri edhe «degë»; në Piana dei Greci *rrëmp rrembi* «vile rrushi». Në fonetikën e fjalës bien në *sy* dy pika, metafoia e vokalit dhe *-b-ja* fundore. Për të parën rregulla e Meyer-Lübkes (Gr Gr I² 1042) që një *a* përpara *m-së* + vokal ka dhënë toskërisht *ë*, geg. *e* (*rāmus* : *rrëmb rrem*, *aerāmen* : *rem remb* «bakër»), nuk na duket e mbështetur sa duhet me këto dy shëmbëlla. Prandaj ka të gjarë që ky ndrim fonetik i detyrohet një arsyeje morfologjike, dy fjalët duket të jenë shumë të singularizuara; sh. edhe *degë*. I padrejtë m'anë tjetër është spjegimi morfologjik që jep Meyer Lübke (Gr Gr I²

1050) për zhvillimin e *-b-së* fundore te *remb shkëmb* etj., duke menduar se në kohën e huazimit të këtyre lloj fjalësh të latinishtes në shqipen *s-ja* e nominativit latin gjeti përgjegjësen e saj në *s-në* analoge të ruajtur m'atë kohë në sistemin nominal të shqipes, kështu që p.sh. *-mus* e emrit *rāmus* dha në shqipen *-ms: -mbs: -mb*, pra *rremb*. Me gjithë se këtë tezë e përkrah edhe Jokli (LKU 18, 276, 318, Arhiv I 43 v.), do të themi se këtu kemi të bëjmë me një dukuri thjesht fonetike, sikundër e vunë re dhe Vasmeri (f. 29 v), me Barićin (Hymje 61 v.) Është zhvillimi i një *b-je* pas *m-së* e i një *d-je* pas *n-së*, si okluzivë homorganikë në fund e në trup fjale. Zhvillim jo i moçëm në shqipen, sikundër e tregon rum. *scrum* gr. e re *σχροῦμος* prej shqipes *shkrum*, faza e vjetër e të sotmes *shkrumb*. Ashtu do të gjykohen atëhere dhe *krimb*, *ambël ëmbël*, *send*, *katund*, prej huazimeve greke *kumbull*, *shtambë shtëmbë*, *shqind*, prej sllavishtes fjala *pelind* etj. Sh. tani Z.f. Balkanologie II 24 v., Rev. shkenc. e Inst. Pedag. dyvjeç. Shkodër 1 (1964) 21.- Sh. edhe *remë*.

rretër rretën f. «gjalmë e gjatë e dredhur, sidomos prej lëkure; dredhë e lëkurtë e opingës». Fjalë e mbarë gjuhës, që del në burimet pas G. Meyerit (Drizari, Manni etj.). Nga lat. **retina* «fre», që rron dhe në disa gjuhë romane perëndimore e që m'anë tjetër ka kaluar dhe në greqishten, si *ρέτενα ρέτινα*, Jokl Revue Intern. d'Et. Balkaniques II 56 vv.- Fjala përdoret më fort si plural, tosk. *rrétërat* geg. *rretnat*. Prandaj *rretnat* në disa anë të Gegërisë u muar në ndjenjën gjuhësore si një plural më *-na rret-nat*, dhe mbi këtë u formua një trajtë regresive *rretat*. Kjo është analoge me *drap* për *drapër*, *qepë* për *qepër*, *kudh* për *kudhër*, *dhelpe* për *dhelpeër* etj., që kemi dhënë në Li. Posn. VII 182.

rreth, pl. *rrathë* m., me përdorimin abstrakt pl. *rrethe*; dhe si ndajfolje e parafjalë; *rrethój*, *rrethós*. Për këtë fjalë mendimi i G. Meyerit (BB XIV 55, EW 372 v., Alb. Studien III 8,15,28) që e afron me gjerm. e lartë të vj. *chreis*, gjerm. e sotme *Kreis*, duke pranuar ai zhdukjen e guturalit nistor përpara një *r-je*, me të drejtë nuk është miratuar, sepse grupi *gr-* në ballë të fjalës ruhet në shqipen; khs. Pedersen Krit. Jahresbericht IX I 215, Jokl Studien 74, Walde-Pokorny I 607. Në rrugë të drejtë ka qenë Kamarda (I 323), i cili e afron fjalën me ind. e vj. *rátha-* «qerre»; pokështu në një kohë më të parë dhe G. Meyeri vetë (Alb. Studien I 35), i cili e krahasonte me ind. e vj. *rátha-*, irl. e vj. *roth* «rrotë», lit. *rátas* «rrotë, rreth», lat. *rota* «rrotë». Poashtu dhe Weigandi (f. 75) e lidh me gjerm. *Rad* «rrotë», që hyn dhe kjo në këtë grup fjalësh. Ashtu sëfundi edhe Barići (I 31, Lingvist. studije 16,18, Hymje 35,36), si cili si formë bazë të fjalës rindërtton me të drejtë një **rrath*. Sh. dhe La Piana, Studi ling. albanesi. Varia 120 v.

Fjalë e mbarë gjuhës. Forma e përgjithshme është *rreth* pl. *rrathë*, kështu dhe në Greqi (Reinhold f. 7) e në të tjera degë të kolonive. Një plural *rrithe-t* (përdorur vetëm si i tillë) me kuptimin «vende për me kullotë dhit dhe dhizt (keçat), por kur janë afër shtëpijavet», me metafori *a:e:i*, e jep Ed. e Re (II, Ser. III, Nr. 1 f. 23) për të folët e Lumës. Nga autorët e vjetër khs. Budin DC 19,131,136, RR 52,328, 339, SC 2,97,252,385, 387, *rrethi i shekullit* «rruzullimi» (DC 147, SC 3.189), pl. *rrathë*, *gjith ato unazë e rrathë të rgjandë* (SC 235, 319), si parafjalë (me dativ e ablativ) *rreth njaj shtylli marmuri cë ftohotë; qi aty jesënë rreth tī; rreth njanet anë e mbë tjetërët; rreth vetī* (DC 149, RR 287, II 7, SC 175). Bardhi Circundatus *Rethuem*, Circundare *Me e rethuem*, Interradere *Me ruem reth*, Obsessi sunt *Rethuem janë*, Orbiculatim, in giro *Me rethim*,

f.199 *Rethereth* «Circa». Bogdani (I 137,1) *reth vjetët së krijuemit së Shekullit trī mijë e treqind e katërdhjetë* «intorno alli anni della creatione del Mondo tre mille trecento e quaranta». Nga *rreth-i* janë formuar *rrethák* m. «vend i thurur me gardh», *rrethanike* f. «një lloj byreku me petë disi të trasha, të rrotulluara në formë të suxhukut» (me *-nik* sllave, formant i shpeshhtë në emra gjellësh e ëmbëlsirash), *rrethatore* f. «rryp fishekësh; një lloj tepsie; qeleshe e bardhë e rrafshtë nga sipër që përdorin malsorët e Dibrës»; *rethatur* m. «vend i thurur, i mbyllur»; *rrethe* f. «ograjë e rrethuar me mur të thatë; këpucë e grisur»; *rrethina-t* fpl. «rrethet e një qyteti, afërsinat»; *rrethojë* f. «rrethim me dërrasa që i bëhet oborrit të shtëpisë». Nga pl. *rrathë* ka dalë emri i kërpuhdës *rrathje* f. «*Lactaria deliciosa*» në Shelcan të Shpatit, e pas G. Meyerit *rrathë* f. «bylyzyk». Neologjizëm është *rrethanë*, më fort e përdorshme si pl. *rrethana-t*, një kompozit nga *rreth* e *anë*. Me *as* është formuar ndajfolja *rrethas*: *edhe ka një gotë rrethas; ta paguejmë rrethas, e rrethçe* «rrethas, shoqërisht», me *-çe* të turqishtes. Nga verbet, përveç *rrethoj* që ka dhënë edhe emrin *rrethim*, ekziston dhe *rrethatoj*. Sh. për këto forma sidomos Gazullin e Fjal. e gju. shqipe.- Si e kemi shtjelluar dhe në Li Posn. VII 172, 173 v., meqë metafoia e shqipes shkon rregullisht në drejtimin *a : e*, *rreth rrathë* bashkë me *thes thasë* paraqesin një anomali në sistemin e fleksionit, gjë që i ra në sy dhe Hahnit (Gramatika 33) e Kamardës (I 201). Forma me *-a-* ka qenë e singularit, ajo me *-e-* e pluralit; paradigma ka qenë pra *rrath*, pl. *rreth(ë)*. Me singularizimin e pluralit u bë një uniformim *rreth*, pl. *rreth*; ky pastaj u eliminua, duke mbetur forma metafonike e pluralit në singular e duke kaluar singulari me *-a-* në plural. Singulari *rrath* gjindet te Puljevski (f. 72), e te fjala *kokorráth* «bukë sheqeri rrotullare» (në Polis t'Elbasanit) përkundrajt së përgjithshmes *kokorréth*; dhe në Borgo Erizzo të Dalmacisë pas Tagliavinit 235 *rath-i* pl. *rathët*. Pas këtij dijetari *rath-i* pas gjase është një rindërtim i mëpastajmë nga plurali. Pas mendimit tonë kjo bashkë me *rath-in* e Puljevskit e me *kokorráth* mund të jetë trajta e vjetër, e e ruajtur e singularit. Prej kësaj edhe *me rrathue, me rothue* e disa këngëve popullore të Kosovës. Ndërkaq trajta metafonike *rreth* del që më 1416-1417 në Kadastën e Shkodrës, *Campo uno posto in lo reth de Raycho*.- Për *-th-në* e *rreth-it* do pranuar mendimi i Bariçit që e bie të ardhur nga aspirata e shurdhët indoeuropiane *th*, duke venduar për **rrath rreth* me të drejtë një bazë **rotho-*, e që te krahinorja *rredhi* sheh një trajtë analogjike. Nuk mund të pranohet mendimi i La Pianës që te *rreth, gjeth* etj. bazat të kenë qenë **rredh-i, *gjedh-i* etj. dhe që shurdhimi të ketë ndodhur në trup fjale si asimilim progresiv në trajtat e shquara *rreth-të gjeth-të*. Kundër këtij mendimi mjafton *gjedh gjedhi* «bagëti e trashë» që nuk dha gjëkund *gjeth*.

rreze rrezë f., edhe për spilcat ose drunjtë e rrotës së qerres. Për këtë fjalë pranohet përgjithësisht mendimi i G. Meyerit (f. 364, AS IV 14) që rrjedh prej lat. **radia*, shumësi i populllores *radium* për *radius* «rreze», bazë që rron dhe në rum. *rază* arom. *radză* «rreze», it. *razza* «rreze e rrotës së qerres», prov. span. port. *raya* «rreze», frgj. *raie* «vijë, rryp» etj. Sh. Meyer-Lübke Gr Gr I² 1052, Puçariu EW 1453, Spitzer MRIW I 326.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Budi DC 16: *kienë* (ose *qenë*) *mbushunë me rrezet e dritët të shpirtit shint*. Bardhi *Radius Reze, Radius solis Rezeja e diellit, Radiatio Të këthjellëtitë e rezevet*. Lat. **radia* do të kish dhënë në shqipen **rrazë, jo rreze*. Kjo formë, me metafoninë e vokalit të brendshëm e me *-e-* në fundore të sajne, përmban në vetvete gjithë shenjat e shumësit. Lat. *radius* ose *radium* dha **rraz*, ashtu si *gaudium*

gaz, dhe *rraz dha në shumës rregullisht rreze; kështu njëjësi i sotmë fem. rreze është një shumës i singularizuar. Me këtë trajtë fjale shqipja nuk shkon me rum. *rază* it. *razza* etj., po shkon me gjuhët romane perëndimore dalm. *ruaz* «rrufe», it. *raggio*, engad. *raz*, frgj. prov. *rai*, span. port. *rayo* etj.; sh. për këtë grup fjalësh Meyer-Lübke REW 6999. Te rrezë ka ndikuar sufiksi -zë. Neologjizma janë rrezatój, rrezatím, te F. Noli rrezore «e ndritshme».

rrëfëj «tregoj, kallëzoj» (një ngjarje, një përrallë); tregoj, dëftoj; i rrëfej udhën; s'rrëfen më shumë se dyzet vjeç; e rrëfeu veten burrë; prifti e rrëfeu; rrëfhem «tregohem, dëftohem»: u rrëfye burrë atje; s'rrëfhet me gojë «s'tregohet, s'thuhet me fjalë»; u rrëfye te prifti; rrëfim m. «të rrëfyerit; tregim, kallëzim; të rrëfyerit te prifti»; rrëfyes m. «prifti që rrëfen një besimtar»; rrëfenjë f. «tregim, kallëzim (neologjizëm). Spiegimin e Miklosichit nga lat. *confiteri* «me u rrëfye, me pohue» G. Meyeri 373 e zëvendëson me një tjetër latin, me *referre* «me riprodhue, me rishfaqë, me përsëritë, m'u përgjegjë», mendim që e kish pasur më parë dhe Kamarda (I 119). E pranon Weigandi 75, sh. dhe Philippide II 673, Tagliavini 237.

Fjalë e mbarë gjuhës, në literaturën e vjetër më fort term i gjuhës kishtarë. Te Buzuku (XX, Psalm 137, 1; XXX v., Romakët 15,9; XLVI, Ekleziastiku 36,2) *U të rëfyenij, Zot, ndë gjithë zemërë teme* «Confiteor tibi, Domine, in toto corde meo»; *E prashtu u të të rëfyenij ndër gjindt, Zot, e të këndonj emënit tit* «Propter hoc confiteor tibi in gentibus, et nomini tuo cantabo»; *e përse ata të rëfyenjenë kafshëtë e tū të mëdhāt* «et enarrent magnalia tua». Budi (DC 32.155, RR 46v., SC 2,20) *me shindet pëndesë e me të rrëfyemitë dërejte; e thom të rrëfyemitë e madh qi quhetë Confiteor Deo; mbasi të duketë se u rrëfye mirë, e u nkthye, e u pënduo me gjithë zemërë; E përsëri thotë se të rrëfyemitë s vien mbatëherë kūr nierī s e kūr shtim e forcuom ndë ment e zemërë të vet; aqë mā tepërë Rrëfyesi qi ashtë Mjēku i shpirtit. Bardhi Confessio Të rëfyemitë, Confessor Rëfyes, Confiteri Me u rëfyem (shkruar gabim rëfuem). Në arbërishten e Molizes rfihem «rrëfhem te prifti», Lambertz KZ 53,296. Jashta këtij përdorimi kishtar kuptimi i fjalës është konkret, «tregoj, dëftoj», e prej andej «tregoj, kallëzoj». Për këto kuptime përveç shembëllave më sipër khs. dhe rrëfej «δείχνω, I show» te Leake 309, *më rrefehet* «më bëhet, më duket» në një përrallë toskërisht (te G. Meyer, Alb. Gram. 65), te Bageri (f.10) *Mordja bafas i rrëfhet para plakut*; «tregoj, kallëzoj» te Todër Haxhifilipi (sh. Nahtigal, Arhiv I 187): *nde do rrëfejë të për t ardhmet juve* «καί τά ἐρχόμενα ἀναγγελεῖ ὑμῖν», e te Grigori (f. 64, Mateu 18,31) : *rëfien* «ἐφ' ἀνήρωσιν». Kuptimi konkret ruhet dhe në Greqi (Kulluri = Salaminë), ku fjala me një kryqëzim me dëftoj ka dhënë dërfiej : *po hiri jema ndë mes; u dërfiejti sisënë* «μά μπῆκε στή μέση ἡ μάννα τους, τοὺς ἔδειξε τό βυζί», Furikis 'Αθήνα 45,76. Nga këto të dhëna të burimeve të vjetra, letrare e dialektore, shihet se forma e fjalës dikur ka qenë *rrëfyenij* respektivisht *rrëfienij* dhe se e sotmja *rrëfëj* është analogjike, ka të ngjarë pas aoristit më -eva. Kuptimi bazë ka qenë, si u tha, ai konkreti i të dëftuarit, nga i cili rrodhi përdorimi abstrakt i tregimit të një ndodhie, e në sferën kishtarë ai i konfesionit. Kështu kjo fjalë ka kryer një zhvillim semantik afërsisht ashtu si *kallëzoj*, për të cilën te Budi (SC 325) gjindet ende kuptimi konkret: *të tridhjetënë ditë mbas mortie erdh e u kallëzuo së parësë Munështirit, me një faqe t errë e të pshtimëtë, e gjithë ndezunë sikūr flaka e zjarmit ...* Në këto rrethana burimi i fjalës është*

gr. φαίνω «bëj të duket, dëftoj, tregoj» φαίνομαι «çfaqem, dukem, dëftohem», fonetikisht féno fénome. Pikënisja mund të ketë qenë aktivi féno, po ka të gjarë të ketë qenë mediali fénome, që dha rrëfyhem rrëfehem, prej nga u formua aktivi rrëféj. Nga monoftongimi i diftongut ai në e e nga reflektimi i φ.-së si spirant f shihet se kemi të bëjmë me një huazim jo prej greq. së vjetër. M'anë tjetër përhapja e fjalës në mbarë shqipen është një dëshmi që huazimi është mjaft i moçëm, sigurisht i epokës bizantine, e ka të gjarë më fort prej greq. së mesme sesa prej së resë. Në këtë vështrim dëshmon dhe prania e preverbit r(r)ë-, që çfaqet dhe te me rbishtë, rëbjër rëbár rëmih etj. (sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk.Shq. 4, 1956, f. 93), formant që sigurisht ka dashur do kohë gjersa zuri vend te kjo fjalë; khs. për këtë dhe rrëshyell rrëshéll.- Fjala greke ka hyrë më vonë dhe një herë në gjuhën shqipe, si (më) fanitet, kal. fanepsem etj., sh. fanitet.

rrëfëshk m. «Carduus nutans, gjembaç»; zog rrëfeshku «Fringilla carduelis, kryeartëz». Këtë fjalë të gegërishtes, që s'e ka G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për Tiranë, me përshkrimin «nji farë bari gjema gjema me lule të bardha, εις τό όποϊον προτιμώσι νά κ'όθηνται τά κορδερί νια όθεν όνομάζονται και zok rrëfeshku». Kështu e përshkruan këtë dhe Bashkimi, veçse ky e jep fjalën si rrfeshk. Mbi dëshminë e këtij përshkrimi Jokli (LKU 221 v.) e analizon në rrfe-shk, duke gjetur aty një zgjerim të fjalës rrëfé «rrufe» me sufiks -shk.

Fjalë dialektore jo fort e vjetër. Morfologjikisht përveç sufiksit -shk përmban dhe prefiksin (r)rë-, që del dhe te një tjetër emër gjembi, rrëkuall. Si një fjalë e kësaj sferë rrëfeshk e ka burimin te ferr-a, pra rrë-fe-shk përfaqëson një *rrë-ferr-shk. Kështu dhe të tjerat emra të kësaj bime, si gjembaç e gjemb gomari, burojnë prej gjemb-it. Lidhjen e rrëfeshk-ut me ferrë-n e vërteton nga një anë tjetër dhe kjo, që kryeartëza përveç zog rrëfeshku quhet dhe ferrcák, në Borsh (Bregu i Detit) birbil gjëmash (M. Totoni), pra «gjëmbash». Edhe në të tjera gjuhë ky zog e ka emrin prej gjembit a ferrës; khs. lat. carduelis nga carduus «gjembaç» dhe reflekset e tij në gjuhët romane (te Meyer-Lübke REW 1686), gjerm. Distelfink etj. Te *rrëferrshk ra likuیدا në një grup tri konsonantesh.

rrëgallë f. «vend i mbushur me gurë të rrukullisur prej malit, lerë, lyshtër; luginë e ngushtë e e pingultë mbushur me lerë, me gurë». Këtë fjalë të Veriut, që s'e ka G. Meyeri, e jep Gazulli për Pukë si rrëgalle me dy kuptimet më sipër, bashkë me zgjerimin më -inë rrëgallinë f. «vend rrëgalle; tokë rrëgallinë», me shënimin «sh. gërgallinë»; gërgallinë sipas tij në Malsi të Madhe «tokë me gërgalle», gërgalle «tokë me gurë, capinë», në Dushman e Dukagjin po sipas tij gërzhallinë = gërgallinë. FGS jep dhe verbin rrëgallem «rrukullisem». Një me rrëgallë është rrgjolle «terreno cattivo, terra di cattiva qualità» që sjell Cordignano pas D.P. Sulit e që prandaj duhet të jetë trajta e fjalës në Mirditë, ku g palatalizohet, siç dihet. në gj.- Më parë Jokli (IF 44,13 vv., ZONF X 197) dy emrat topike të Veriut Rgal e Madhe pranë Tetajt e Kodra Rgālave, shpinë mali pranë Palcit në Mertur, i afron përbrenda shqipes me ragāl-a f. në lidhjen ragala e shenit «kasollja e vogël e qenit, steli i qenit» në Rekë të Epër të Dibrës, dhe këtë fjalë e bie të ardhur prej maked. së vj. ἄργαλλα «kasolle për banjë», te Suidas «οἰκῆμα μακεδονικόν, ὅπερ θεομαίνοντες λούονται». Kjo fjalë pas mendimit të tij afrohet m'anë tjetër me ἄργιλλα κατάγειος οἰκία në gjuhë të Kimerëve, nga e cila sipas Hasdeut (EM 1577 vv.) e Joklit vetë buron rum. argeá «kasolle nëndhese, kamare; avlëmend, vegj.» Mendim i pranuar nga shumë anë:

Puşcariu DR IV 1365 e LR I 257, Giuglea DR X 412, Walde-Hofmann I 63, Capidan Byzantion XIV 537 vv., Pokorny I 64. Philippide II 696 v. te fjala e rumanishtes dhe te ajo e shqipes gjen një element të përbashkët me burim nga substrati i vjetër ballkanik. Ashtu afërsisht më parë Densusianu (HLR I 38, 199) sheh te fjala rumune një relik të trakishtes, poashtu më vonë dhe Şiadbei (SCL IX 179), si edhe Poghîrcu (poaty X 385), i cili gjen aty një fjalë të trako-frigishtes. Rosetti ILR II⁴ 107 v. e sheh të gabuar spiegimin e fjalës shqipe prej lat. *nebula* «mjegull» nga ana e Pisanit RIEE IV 17. Përkundrejt Philippides Jokli IJ XIV VII 169 ngul këmbë në spiegimin e vet; poashtu në IJ XXIII VII 163 përkundrejt disa rezervave që çfaq Densusianu. Për rum. *argea* sh. edhe Gáldi Revue d'hist. comparée XXV N.S. (1947) 118. Për maked. ἄργελλα Pagliaro Ric. Ling. I (1950) 145 v.

Nuk ka dyshim se dy emrat topike që jep Nopcsa (Geogr. u. Geol. Nordalb. 259) përmbajnë apelativin *rrëgallë* me kuptimet që u dhanë me sipër. Me këto pajton fakti që në Pukë *rrigallë* (me ndrim *ë:i* në silabë përpara theksit) është «bokë e thatë pa landë», te Sik Cirka III 233. Në të tilla rrethana apelativi *rrëgallë*, bashkë me toponimet në fjalë, për arsye të kuptimit është vështirë të bashkohet me *ragal*-në e Rekës e të spiegethet nga maked. ἄργελλα. Për historinë e fjalës shtrohet pyetja a është kjo *rrë-gallë* apo *rrëg-allë*. Disa dëshmi të leksikut e të toponimisë tregojnë qartë se e drejtë është analiza e dytë. Në geg. veriore pranë *rrëgallë*-s ka një *rragám* «shkëmb, krep», te Cordignano «roccia, rupe, krep», te Rr. Zozji (Bul. i Inst. Shk. 3, 1950, 109) «shkrep i madh», fjalë që në Veri paraqitet dhe si emër topik, sh. *Rragám, rrëgallë* e *rragám* paraqiten si zgjerime të një primitivi *rrag-*, në silabë të pathekse *rrëg-*, i cili u zgjerua një herë me *-allë*, një herë me *-am -amë*, sh. për këto formante Xhuvani-Çabej Prapashtesat 12 v. Këtë *rrag-* e ndeshim më tej, me një trajtë metafonie, dhe te *rrege* «nji copinë toke e papunueme», *nji rrege toke* «nji grimë tokë e ngushtë e gjataruqe» te Gazulli, te Donisa (Circa II 217) *rregë* «tokë qi heret â kenë punue, por qi tash e ka prishë rrmorja sa memzi kalohet»; kjo fem. *rrege rregë* është prodhim i singularizimit të *rrag*-ut, khs. prej Fishtës (HD VIII 150, Lah. e M. 23) pranë *m'nji rrege mali* vargun *Edhe u grafë* (dhive) *nper rrege e ara*. Kjo *rrag* dorajdorën mbetet e paanalizueshme më tej.- Sa për *ragal*-në e Rekës, burimi makedon i kësaj mund të jetë. I drejtë mund të jetë dhe mendimi i burimit të rum. *argea* prej kimerishtes, e me këtë dhe mendimi i një gurre të përbashkët, në thelb, të fjalës shqipe e rumune. Është për të vënë re ndërkaq spiegimi i rum. *argea* «vegj» prej gr. së re ἄργαλειός «vegj» nga Grégoire, Byzantion XIV 536. Me këtë gjë pajton dhe mendimi i Meyer-Lübkes (REW 636) që në rum. *argea* mbase përmbahen dy fjalë burimesh së ndryshme.

rrëgjó «zvogëloj, tkurr, picërroj»; *rrëgjohem* «mblidhem, zvogëlohem». G. Meyeri 373 niset nga një bazë e rindërtuar **rëglónj* e për këtë mendon si burim një lat. **rodiculare* (nga *rodere*), e cila rron sipas tij dhe në port. *rilhar* «me brejtë».

Fjalë e mbarë gjuhës, te Kristoforidhi «σικρύνω, ἐλαττόνω, ἀραιρῶ picërroj», *rrëgjohem rrëgjohem* «σικρύνομαι, ἐλαττόνομαι, ἀαιροῦμαι», sa të rritetë *rrëgjonetë* «ἀντί νά μεγαλώση, σικρύνεται» Nga pikëpamja e shqipes një *rëglónj* nuk përlligjet, sepse një e tillë bazë do të kish dhënë në shkodranishten **rëgioj*, e cila s'ekziston. Nga pikëpamja e latinishte për port. *rilhar* nuk është i nevojshëm ndërtimi i një baze **rodiculare*, sh. Meyer-Lübke REW

7358. Kështu pra një bazë e tillë s'ka ekzistuar; përveç asaj ajo as kuptimisht nuk arrin të sqarojë verbin e shqipes. *rrëgjoj* është fjalë vendi, një zgjerim me *-oj* i verbit *regj*, me reduktim të *e-së* së pathekse në *ë* si te *bërruc*, *gërqi*, *të këqí*, *qëlloj*, *thëllim* etj. Të regjurit i mbledh lëkurët, i rrëgjon Khs. *Shkurti shkurtton urët*, *Marsi regj lëkurët*. Nga *rrëgjoj* ose drejtpërdrejt nga *regj* me sufiks *-ak* është formuar *rrëgják rëgják* «i rrëgjuar», *i (r)rëgjakur*, *i rrgjakun* «anemik», duke ndikuar dhe *gjak-u*. Te *rrëgjoj e rrëgják rr-ja* e fortë përkundrejt së thjeshtës te *regj* rrjedh nga një geminacion ekspresiv.

rrënd rrâ m. «mullëza me të cilën zënë djathë». Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri 365 jep *rëndës* nga shqipja e Greqisë dhe e lidh këtë, si një nomen agentis *rënd-ës*, me *rëndë*, duke u nisur nga mendimi se mullëza duke e mbështjellë qumështin e bën të rëndë; prej shqipes ai bie të ardhur rum. *rînzâ* arom. *arîndzâ* «rrënd, mullëz», e cila, si e pat vënë re Miklosichi, ka kaluar dhe në ukrainishten (*ryndza ryńdza*) e në polonishten (*ryndza*). Jokli përkundrazi (LKU 276 vv., 334 v.) e bashkon *rëndës-in* me geg. *rrâni* «rend, pikoj» (Bashkimi «accorrere, goccio-lare») e me *rend* «vrapiroj, eci me vrap», e jashta shqipes me fjalën gjermanike got. *rinnan* «me rrjedhë, me vrapue» gjerm. *renne* «vrapiroj» *rinne* «rrjedh» *gerinne* «mbështillem, piksem» (për qumështin) etj. I këtij mendimi qe më parë dhe Meyer-Lübke Lit.-blatt für gjerm. u. rom. Phil. XII 241. Pranuar te Capidani DR II 516, Barići (Arhiv I 143 v., Hymje 44 shën. 3, ndryshe më parë te I 87), Walde-Hofmann II 438. Një spjegim nga latinishtja (*ren renis* «veshkë, ije») jep për këtë fjalë e për *rrë rrâ* e rum. *rîna* «ije» Weigandi BA III 217, dhe mendimin e tij e ndjek tanimë edhe Meyer-Lübke REW 7206. Sëfundi La Piana SLA I 116 v. *rrënd m.* «mullëz» bashkë me *rrëndë f.* «sperma» e afron me gr. *ῥοῦά δαται ῥοῦάδατο* «u stërpik», perfekti pasiv i *ῥαίνω* «stërpik». Për rum. *rînzâ* arom. *arîndzâ* sh. sidomos Giuglea DR II 643, Philippide II 731 v., Puscariu LR I 179, Papahagi 144; për ukr. *rynzja* Scheludko BA II 142.

Fjalë e mbarë gjuhës, e cila konkuron me *mullë mullëz*. Nga variantet e shumta të sajat nëpër dialekte, gegërishtes *rrâ rrani* do t'i përgjigjej në toskërishten **rrë rrëri*, po një trajtë e tillë nuk ka dalë gjer më sot në këtë dialekt. Aty ka *rrënd-i* në Siqeli, në Labëri e pas J. Thomait (BUST 4, 1961, 151) në Seman të Fierit, ku gjellin edhe verbi *rrëndós* «i shtie rrëndin qumështit për djathtë a kos»; *rrënd-i* në shumë vise të Jugut vlen edhe për spermën; në Acquaformosa të Kalabrisë *rondi* (Rohlfs AIS VI 1212) me labializimin e rregullt të *ë-së* në *o* në atë dialekt. Fem. *rrëndë* në Çamëri (Pedersen 184) e në Devoll, asaj prej gegërishtes i përgjigjet *rrand-a* në Shën Gjergj të Tiranës. Nga zgjerimet e fjalës, përveç *rëndës-it* të Greqisë, do përmendur *rrâskë* e gegërishtes, një rrjedhojë me *-skë*, sh. Jokl LKU 220, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 83; zgjeruar më tej me *-zë* te *rraskëz* që jep po Kristoforidhi; në Pelavi të Zerqanit *rrâck-a* (E. Hysa). Një variante të kësaj me *-shkë*, *rrashkë* «maw, plëndës i bagëtisë» e ka Drizari; Variboba në Kalabri (Kënka e të sgjuarit varg 27) *rashk* «një farë djathi i njomë e i pakripur, it. giuncata». Nga verbet denominative, përveç *rrëndós* ekziston dhe *përrënd* «i shtie mullëzën qumështit për ta zënë djathtë a kos» te FGS.

Për historinë e fjalës është me rëndësi të ndiqet historia e formave dhe e kuptimit të saj. Me gjithë larminë e trajtave dialektore shihet pikë-sëpari se mbizotëron kudo tipi me *rr-* nistore të fortë; prandaj edhe për këtë arsye bie afrimi me *rëndë*, i cili — si e vuri re edhe Jokli — nuk

është bindës as nga ana e kuptimit. Sa për *-d-në* e tosk. *rrënd rrëndë rëndës* e të geg. *rrānd* përkundrejt *rran-it* të gegërishtes, nga dy mendimet çfaqur në këtë mes : *-d* element morfologjik, *rëndës* një emër verbal me *-t* të participit (Jokl), *-d* shtesë fonetike si tingull homorganik pas *-n-së* (Weigand), është vështirë të zgjidhet i drejti; me gjith'atë mendimi i dytë gjan të jetë më afër menç, po sh. dhe vrejttjet e Joklit IJ XIII VII 177. Për sufiksën përkundrazi, mbi dëshminë sidomos të rum. *rīnzā* si një refleksi i mocëm i fjalës së shqipes, do të pranojmë me Joklin e kundra Weigandit se ky sufiks ka qenë *-zë*, jo *-ës*; veçse ka qenë një *-zë* deminutive (në pajtim me Capidanin, i cili sjell për krahasim frgj. : *caillette*), jo kolektive, khs. *mullëz mullzë* pranë *mullë*.- Nga spiegimet etimologjike të fjalës, ai prej lat. *ren renis* nuk qëndron as nga ana e formës as nga e kuptimit, sh. edhe Jokl IJ XIII XII 177. Bie edhe afrimi midis *rīnzā* dhe *brīnzā* «djathë» që bën Bariçi përbrenda rumanishtes e që e merr parasysht dhe Rosetti ILR II⁴ 119 v. Nga dy spiegimet e tjera, të cilat nisen të dyja nga teknika e të zënit të djathit, afrimi me got. *rinnan* gjerm, *renne rinne gerinne* etj. paraqitet më afër menç se ai me gr. *ῥοράδαται ῥοράδατο*; veçse bie krahasimi i fjalës gjermanike me një tjetër fjalë të shqipes, me *jerm* (sh. këtë). Ndërkaq emri tjetër i rrëndit, *mullëz*, i cili shkon me *mullë* «bark, stomak» (*më dhëmb mulla*), na dëfton se elementi i emërtimit të *mullëzës* së djathit mund të jetë një tjetër, ai i plëndësit të ripërtypësve nga nxiret kjo lëndë; khs. dhe *rrashk-un* e Drizarit me kuptimin «maw, plëndës i bagëtisë».

rrënjë rranjë rrājë f., *rrënjosem* «lëshoj rrënjë, zë rrënjë» *rrënjós* «ngul mirë në mendje e në zemër një ide, një ndjenjë», G. Meyeri 365 v. këtë fjalë, bashkë me *rrëzë rrānzë*, me *rrëzój rrëzím* e me *rrikë* sic. *rilk* «rrep, repa», i spiegon të gjitha nga lat. *rādex* «rrënjë»: *rrënjë* sipas tij nga një *rëngjë* e kjo prej një baze latine **radicia*, si *pengë* prej lat. *pedica*; *rrëzë rrāzë*, refleksi i një *rangzë*, deminutiv me *-zë* i një **rëngë*, kjo prej një lat. **rādica*, prej nga dhe it. *rādica*; *rrikë* nga *radicem* ose më fort nga një **radīcam*, khs. rum. *rādiche*; *rilk* e paqartë, po mbase nga *riklë*, kjo nga lat. *radicula* «rrënjëz»; prej shq. *rrëzój* rrjedh arom. *rāzuesc*. Spitzeri përkundrazi (MRIW I 327) gjen te *rrënjë rranjë* një fjalë vendi, e afër me lat. *radix* gr. *ράδαμνος* «bisk, filiz, njomëz», refleksi i rrënjës indoeur. **urad-* zgjeruar me *-n-* e më tej me sufiks *-io-*, pra i një baze **uradniā*. Këtë bazë të Spitzerit Bariçi I 87 v. e modifikon në **(w)ra(δ)an̄*, e cila sipas tij spiegon më mirë vokalin nazal të geg. *rrānxë*, po përndryshe i mbahet dhe ai afrimit etimologjik me lat. *radix*, got. *waurts* etj., e sidomos me gr. *ράδαμνος*. Edhe Tagliavini 292 v. e gjen të gabuar etimologjinë latine të *rrënjë rranjë-s*.

Fjalë e mbarë gjuhës, me të dyja trajtat, *rrënjë rranjë rrājë* e *rrëzë rrānzë rrānxë*, nga të cilat e dyta është deminutivi i së parës. Këto me kohë kanë dalë në fjalë më vete, duke bashkeqzistuar me kuptime të ndryshme. Prej sosh, *rrënjë rranjë rrājë* ruan domethënien e parë, në vështrimin konkret e të figurshmin, khs. për kuptimin e dytë *rrënjës* m. «vendës, anas, jo i ardhur» e *rrënjëdalë* «pa fëmijë», një kompozit desiderativ i mallëkimit («që i daltë rrënja, që iu shoftë fisi»); neologjizma janë *rrënjësór -e*, *rrënjësisht* e *rrënjór* m. «radikal» (në gjuhësi). Përkundrazi *rrëzë rrānzë rrānxë* ka marrë përgjithësisht kuptimin e një vije ku piqen dy sipërfaqe a dy gjymtyrë të trupit (*rrëzë mali*, *rrëzë muri*, e *preu drurin* në *rrëzë*, *rrëzë e kofshës*, *rrëzë e veshit* etj.), e andej dhe atë të një skute a qoshje, ai *rrri rrëzave*, prej nga ka dalë edhe *rrëzák* «njeri që rri rrëzave» (në Gjirokastër) e «fëmijë i dobët, i rrëgjuar»; sh. dhe *përrëz*.

Me kuptimin e rrëzës së malit e shpeshtë dhe në toponiminë e mbarë vendit: *Rrëza* në krahun e Tepelenës e të Delvinës, *Rrânzat* mbi Shkodër, *Rranzija* emri përmbledhës i katundeve në rrëzë të Dajtit nga ana e Tiranës, *Rancija* emër analog i një krahu të Krujës etj., khs. dhe Gazetteer 141, 144, 146, 147. Prej *Rrânza*-vet ka dalë me metatezë emri *Rrazna*-t në Malsi të Madhe. — Nga dëshmia e përbashkët e literaturës së vjetër dhe e dialekteve sidomos të kolonive shihet se *rrënjë rranjë rrâjë* e *rrëzë rrânzë rrânxë* janë një fjalë e vetme, me kuptimin e rrënjës e me dy trajta të ndryshme. Kështu Buzuku nuk ka *ranjë*, po *ranzë*, kurse te të tjerët autorë të Veriut pas tij mbizotëron trajta e parë: Buzuku (XI, Ekleziastiku 24,16; XLVIII, Jeremia 17,8) *E lëshova ranzëtë ndë popullit të ndershim* «Et radicavi in populo honorificato»; *porsi lisi . . . qi larg shtie ranzëtë e tî përçark ujit* «quasi lignum. . . quod ad humorem mittit radices suas». Budi (RR 269, SC 2,163) *e me e shkermënyem e me e nxjerrë rranjësh; po ashtu ende gjithë sã rremba, rrathë, e rranjë kã ndë vetëhe; t i nxjerrë rranjësh e t i vdonjë e t i çporrnjë*; Bardhi Radix *Ranja*, Radicare *Me shtëm ranjëtë*, Radicosus *Plot me ranjë*, po Bogdani (si Buzuku) *Luleja ranxet së vet ka me hipunë* «Flos de radice eius ascendet», I 168. Edhe Junggu *rânz* e *ranj* i vë baras. Në geg. veriperëndimore sot *rrânzë* si term botanik përdoret për rrënjët e bimëve të vogla e të luleve (kumtim i A. Krajnit); në toskërishten p.sh. në Libofsh *rrëz-a* është «rrënjë», po në shqipen e Greqisë e të Siqelisë (Piana dei Greci) *rrëzë* është «Rubia tinctorum ose Carthamus tinctorius, rrojbë». Edhe *rrënjë rranjë* ka një përdorim botanik më të hapët. Që te Bardhi del *Quercus Ranjë*, *Quercus N'ranje*, te G. Meyeri geg. *rranjë* e *rrânxë* «Quercus ilex, ilqe, prrall», te Mitrushit 355 *rrajë* e *rrojzë* «Quercus robur», poashtu pas Gazullit *rrâjë rrë-ja* në Malsi të Madhe. Me këtë të fundit do bashkuar atëhere *rrë* «bredh, dru», të cilën G. Meyeri 372 e merr prej Rossit dhe e spiegon pa të drejtë prej lat. *robur* «ilqe», që ka dhënë diçka tjetër, *rrobull*. Edhe nëpër ligjërime të toskërishtes rrënjë shënon lloje dushqesh, kështu në Myzeqe pas Mitrushit llojin *Quercus robur*. E ka dhe shqipja e Atikës si *renje*, Laographia II 106. Prej tosk. *rrënjë*, mbase nëpërmes të shqipes së Greqisë, rrjedh gr. e re *ρένια* «ilqe», Vasmer Kretschmer-Festschrift 1926 f. 278, te fjalori i Proias *τό δένδρον δρυς ἢ μισχωτή*, *Quercus robur*, φ. pedunculata. Me përhapjen në mbarë shqipen e me dëshminë e greqishtes vërtetohet që *rranjë rrënjë* ka zhvilluar mjaft heret kuptimin e një lloji dushku. Këndeje do ta kenë emrin e tyre dhe disa toponime si *Rrâja* afër Apripës që përmendet sëpari te Hahni Reise Drin-Wardar 69, e më vonë, me trajtë të drejtë, te Lambertzi Anz. Wien. Ak. d. Wiss. 1916, sh. edhe Seiner 97. Në Toskëri *Rrënja* edhe emër familjesh.

Etimologjia latine e kësaj fjale nuk qëndron, as nga pikëpamja e latinishtes as nga e shqipes. Para së gjithave është gjë pa mbështesë që për trajtat e ndryshme të së njëjtës fjalë të rindërtohen disa baza të cilat nuk dëshmojnë në latinishten e as gjejnë vërtetim me anë të gjuhëve romane, si **radicia*, **radica*. Të tilla baza përveç asaj nuk do të ipnin as në shqipen rezultatet ku mendohet të kenë arritur: nga **radicia* nuk arrihet në *rrënjë rranjë*, as nga **radica* në *rrëzë rranzë*. Kemi të bëjmë me një fjalë vendi. Si bazë e kësaj mund të merret (me Spitzerin) për *rrënjë rranjë* një **urad-n-ia*, për *rrëzë rranzë*, më e vjetër *rranzë rranë-zë*, një **urad-nā*. Aty grupi *dn* u asimilua në *nn* e më tej në *n*, e cila nuk mori më pjesë në rotacizmin e toskërishtes. Të *rranë-zë -ë-ja* në trup fjale ka rënë më parë se te tipi *hënëzë hanzë*, po m'anë tjetër më parë edhe se te tipi *anzë arëzë*, ku *-n-ja* iu shtrua rotacizmit në toskë-

rishten. Në këtë kuptim *rrëzë rranzë* përbën një grup me *thëllëzë fllanzë*, me *gjizë gjizë, kërthizë kërthizë, kizë kizë, brez brez, mëz máz* etj., ku kemi kudo vokal oral + *n* + *z*, i cili në gegërishten dha vokal nazal + *z*. Për ndërndrimin (alternimin) e formantit -*n*- me zgjerimin -*ni*- në shqipen, përveç *rranzë : rranjë* khs. dhe *anzë : ajzë ânjëz* «ergjëz», sh. edhe *arzë anzë árëzë*.

rrëshék m. «lëkurë dhie për vaj, verë e bulmet; gjyryku i kovaçit». Këtë fjalë: në arbërishten e Italisë *rrëshék* pl. *rrëshiqe*, geg. *rrëshiq* pl. *rrëshekë*, te Leake (f. 300) *rshiq* pl. *rshekë* ἄσκι, Miklosichi (Alb. Forschungen I 26) e G. Meyeri (f. 275, dhe më parë në Alb. Studien I 23) si **mrshiq* e spiegojnë prej serbokr. *mješić* «rrëshek, calik». Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VII 174 vv., *rrëshiq*-i është plurali i singularizuar i *rrëshék*-ut. Kjo vetë është një formë me prefiks *rrë-*, nga e cila ruhet poashtu primitivi *shek* (*pikan ven me shek* në Kosovë), sikundër te *rrëshiq* ruhet dhe primitivi *shiq* në Greqi (*djathë të shiqit*). Ndërkaq nga shkalla me -*e*- e fjalës përveç *shek* njihen dhe pluralet *tre shekuj me gjizë* (te Dozoni) e *shérkëtë me mjaltë* (në të folët e Greqisë), nga ajo me -*i*- përveç *shiq*-it edhe *shirk* në *djathë të shirkut*, në Çamëri e Greqi. Nga këto forma, *shiq* është shumësi i *sherk*-ut, poashtu siç është *rrëshiq*-i ndaj *rrëshék*-ut. Ndërkaq edhe trajtat me -*e*-, si *rrëshék*, *shek*, *shekuj*, kanë dalë me anë të një metafonie *a : e*, pra shpien në analizë të fundit te *shak*-. Kjo çfaqet ndër të tjera te *shakull* (*shakull* : pl. *shekuj*), e te *shark* (*shark* : pl. *shérkëtë*). Prandaj për etimologjinë e fjalës sh. *shakull* e *shark*.

R é s u m é

ÉTUDES D'ÉTYMOLOGIE ALBANAISE XVIII

R

radhë f. «rang, file; tour; rangée, ligne; classe sociale». Du néo-gr. *ράδα ἀράδα* même sens (G. Meyer). A beaucoup de dérivés dans la langue populaire et la littéraire. L'étymologie latine du mot grec (**radia*) est encore la plus probable, cfr. le frç. *raie* remontant à cette même source.

rangë f. «travaux domestiques, travaux de ménage», *rangëtonem* «avoir besoin; se soucier» me *rangue* «arranger, régler les travaux de ménage», *tosque rëngë* «anxiété» *rëngój* «travailler dur.» Premier sens «fatigue, souffrance». Il sagit peut-être d'un ancien emprunt de l'italien, cfr. *ràngola* «affanno nel respirare; preoccupazione, sollecitudine», *arrangolare* «darsi fatica e pena, affannarsi, arrovellarsi», ou bien des reflets du lat. *rancor* «dégout, rancoeur», comme lomb. *rangoñ* «plainte».

rasë f. «cas; occasion». Du turc *rast* «occasion» et comme tel identique à *rast*, mais transformé en un mot savant, sous l'influence de me *ra* «tomber» et des modèles étrangers du type it. *caso*, frç. *cas*, all. *Fall*.

rashë f. «espèce de chemise des femmes». Plutôt de l'it. *rascia* «serge» que du lat. *rasum* «espèce de satin»; mais *rasë* «soutane» du neo-gr. *ράσον*

«serge, froc, haire». Le mot italien, qu'on fait dériver de Rascia, le nom de la Serbie médiévale, ne saurait être séparé de l'all. Rasch «ras», expliqué à son tour par moyen du nom d'Arras, auquel ou fait remonter un autre mot italien, arazzo.

rashë, forme de l'aoriste supplétif de bie «tomber; battre, frapper». Des rapprochements proposés jusqu'à présent: rrah «battre» vieux sl. u-raziti «percutere» (G. Meyer), gr. ὀρούω «se lever vivement, s'élançer», lat. ruo «s'écrouler, tomber brusquement sur» (N. Jokl), gr. ἐνεγκεῖν «porter» (H. Barić), le deuxième est le seul possible.

ravë, rravë f. «sentier; trace sur la neige; ornière». Ni apparenté au sl. noga «pied» (Barić), ni au vieux sl. rovъ «fosse, fossée» (M. Vasmer). Comme «raie, rayure, bande», forme à métathèse de varrë «plaie» varavara «rayé, zébré» (d'une étoffe ou toile imprimée), où se range en outre rruví «ligne, rail», vrragë «ornière; impression profonde», vajzë varzë «jeune fille», etc.

ravgój, rravgój «errer cà et là, vaguer». Du mot précédent, mais plus précisément de son dérivé ravgë «sentier dans une montagne».

razakí «espèce de raisin à baie longue», du turc razaki, passé aussi dans les autres langues balkaniques. Forme à métathèse ragazí, produite sous l'influence de zi «noir», d'où par extension aussi ragabardhë «raisin aux baies grandes et blanches»: bardhë «blanc». Le néo-gr. ραζακί provient également du turc, non pas du lat. rosacea.

rë rë f. «nuage». Ni du groupe de l'all. Rauch «fumée» (G. Meyer), ni de celui du sl. nebo «ciel» (Barić), mais apparenté à l'oénorien (illyrien d'Italie) ρινός ἀχλός (Jokl), rapprochement désormais établi. A ce même groupe appartiennent en outre errët «obscur, sombre, couvert, du ciel», vrërët vranët «obscur, sombre, couvert de nuages» et rrej «mentir, tromper par des mensonges».

rë, dans l'expression vë rë «faire attention, regarder, observer». Non pas du lat. grevis pour gravis (G. Meyer), ni le proche parent de lit. regėti «voir, regarder», irl. réil «clair» (Wiedemann), mais apparenté, à l'intérieur de la langue, à ruaj «garder, faire la garde, être en guet, en faction; observer» et resë «envie; jalousie, endroit dans une rivière où on attend les poissons pendant la nuit pour les attraper; embuscade» (N. Jokl). Première forme roe, d'où l'actuel roje «garde, faction.»

regëzínj «déchirer», dans Gj. Buzuku e regëzini pëtëkatë e tî «scidit vestimenta sua», d'où regzinë «lange». Probablement une formé à métathèse de *gëzínj, un élargissement en -inj de gris «déchirer».

regj m. «roi» regjëní regjërí f. «royaume», regjinë f. «reine». Ni d'un diminutif latin reconstruit *reg(u)lus (G. Meyer), ni de l'anc. it. rege (N. Resuli), mais du lat. rëgem, avec hyphérèse de l'e final. Emprunt plus tardif que mbret de imperator, probablement du latin ecclésiastique.

regj «apprêter, tanner les peaux; saler, macérer les concombres, les tomates, les olives, etc.», regjem «se rompre à un travail difficile,

s'endurcir, gagner de l'expérience.» Non pas un emprunt au serbo-cr. redjati «ranger», mais un mot des sources indigènes, du groupe de gr. ἔργον Fĕron «action, oeuvre, travail», all. Werk, av. var za «action, activité», arm. gorc «oeuvre», etc.; cfr. pour le sens le gr. (moyen et moderne) ἐργάζω «corroyer, tanner». Alb. regj d'une base *u reg-, forme issue de *uerg- par une métathèse des liquides, comme drekë «le repas de midi; midi» par rapport à darkë «repas du soir, souper» et à darsmë dasmë «noces».

rekës m. «géant», en albanais de Grèce. Aucune affinité avec le mot slave slovène orjak «géant». Un nom d'agent en -ës, de rrek «fatiguer, ennuyer» rrekem «se fatiguer, s'efforcer, tendre de toutes ses forces à».

rem m. «cuivre», i remtë «de cuivre», remtár m. «chaudronnier». Dans la controverse s'il s'agit d'un emprunt latin (aerāmen, arāmen) ou italien (rame), maintes raisons militent en faveur de l'origine latine.

remë f. «rayère; fil (d'une pierre, d'un marbre)». Non pas du néo-gr. ρεῦμα «courant, cours; ruisseau; rivière, fleuve» (G. Meyer), mais le même mot que rremb «rameau; ride, pli, raie».

resë f. I. «envie, jalousie; endroit dans une rivière où on attend les poissons pendant la nuit pour les attraper; embuscade». Rapproché à bon droit par N. Jokl à ruaj «garder, faire la garde, être en guet, en faction; observer» et à rë dans vë rë «faire attention, regarder, observer», en comparant pour le sens entre autres le lat. invidia par rapport à video. De l'expression resë e keqe «jalousie» dans P. Budi on peut envisager que ce mot ait abouti au sens actuel par voie d'une ellipse.

resë f. II. «treillis de cannes qui sert à couvrir le toit des chaumières sous une couche de paille; chevrons sur lesquels on pose les tuiles du toit; claie de roseaux; espèce de filets». Proviend, avec resë «chaton» et rezhdë «hampe qui pend au cou des chèvres», du bulg. resa «chaton, frange, houppe» resna «frange».

resh, dans des phrases comme po resh borë «il neige», po resh shi «il pleut». Pour des raisons de caractère phonétique et sémantique aussi, on doit retourner au rapprochement avec l'anc. ind. varśá- «pluie» gr. ἔρση «rosée» irl. frass «pluie», envisagé en un premier temps par G. Meyer.

rezhdë f. «hampe qui pend au cou des chèvres; chèvre avec de telles hampes au cou». Ni apparenté à rreshtë «os», ni emprunté, avec ce même mot, au lat. arista «barbe d'épi, épi; arête» (G. Meyer). Le même mot que resat e dhive, et comme tel, identique à resë II.

rëmër m. «valaque (aroumain), pâtre, villageois, paysan». D'un emploi dialectal limité, ce mot ne remonte guère au lat. Romānus, mai plutôt à l'aroum. armin arumîn «aroumain», auquel se rattachent aussi des noms topiques tels que Rëmënj, Ermenji, au sens propre des pluriels, «aroumains».

rëndë (i) randë (i) «pesant, lourd, difficile», rëndój «appesantir», randesë f. «impôt». Ni du lat. grandis (G. Meyer), ni le proche parent du lit. riéju riéti «empiler» (Jokl), mais plutôt du groupe de gr. ἀείρω

αἶρω «soulever», lit. sveriù «je pèse», anc. haut all. swāri swār «pesant» (Barić), si ce n'est tout simplement un dérivé de rënë ranë «tombé», cfr. l'évolution contraire de lat. levis «léger» à levare «soulever». Pour une telle conception de rëndë militerait entre autres të rëndë-t «évanouissement, défaillance», comparable à l'all. Fallsucht «épilepsie» (fallen «tomber»), l'it. mal caduco (cadere), etc. L'étymologie de Barić nous semble pourtant plus probable.

rënxój «causer une hernie», rënxák «qui a une hernie.» Non pas de l'it. ernia (G. Meyer), mais le même mot que rrëzój «démolir, abattre, détruire de fond en comble» rrëzohem «se précipiter an bas, tomber».

rërë ranë f. «sable», comme on sait, du lat. arëna, qui survit aussi en roumain. Outre à ce mot, l'albanais a emprunté du latin — en commun avec les langues romanes occidentales — saburra, qui a donné shūr zhūr, mais pas sabulum. De rërë les noms topiques du type Rërës Rërëzi, qui apparaît dans le nom de Demetrio Reres, capitaine albanais d'Italie vers la moitié du XV-ème siècle.

rienj, reva «souffrir», mot de l'albanais de Sicile. Retourne en guègue du nord, comme ryej rryej «souffrir» i rryem «rompu, expérimente, versé» et rys «exerciter, expérimenter, rendre habile», rysem «gagner de l'expérience». La liquide simple en position initiale indique la présence, jadis, d'un autre son avant elle.

rij «humecter», i rilë «humide». Rattaché par N. Jokl au groupe de l'anc. ind. rināti «il fait courir, il fait couler», vieux sl. ringti «couler» reka «rivière», lat rivus «ruisseau, rigole, fossé, conduite d'eau», ce mot, indiquant un vr- initial, peut remonter à une base *uren- et se rapprocher du gr. ραίνω «asperger, arroser» ραίς «goutte d'eau» vieux sl. iz-roniti «faire tomber; verser (des larmes)». Probablement une formation en -inj, d'un *rë-inj.

rikë f. «caneton, jeune cane; canard; dinde». Figurant chez G. Meyer dans deux endroits divers (à p. 369 comme rik et à p. 362 comme rrigë), ce mot doit son origine probablement au cri (rik rik rik) avec lequel on appelle les canards.

rimtë (i) «bleu (foncé), azur». A rejeter la comparaison avec l'ags. nīpan «être sombre, foncé», soutenue par Barić. Identique à i remtë «de cuivre», employé aussi au sense de «brun, brunet» (du visage). A confronter à ce regard i bruztë, i Brustë «bleu azuré, indigo», proprement «de bronze».

Rinas, mot de village. Le même que Rrihnas, un dérivé en -as de l'appellatif rrihna, le pluriel de rrah m. «essarts.»

riqe f. «bruyère». Non pas du néo-gr. ρείκια, le pluriel, de ρείκη anc. gr. ἑρείκη (G. Meyer), mais de ρείκη qui a donné régulièrement riq, évolué ensuite en riqe au dedans de l'albanais.

rogë f. «clairière; petite plaine ou pré de montagne», d'où crog «essarter, déboiser; plumer (une volaille)», mal i crogët «montagne nue,

sans arbres». Un postverbal en -gë de rruaj «raser»; cfr. l'expression vend i rrúarë «un endroit nu» dans Hahn, et d'autre part qethë roga-roga «tondu par ci, par là», comme aussi l'it. radura «clairière». Le rattachement du mot albanais à l'anc. haut all. riuti all. Reute «défrichement, déboisement, essarts» par N. Jokl subsiste, si ce mot allemand s'avère être le proche parent du lat. radere, auquel s'approche l'alb. rruaj.

rókëzë f. «jeu d'enfants, la marche aux mains», dans l'albanais de Grèce. Pas un emprunt au néo-gr. ρόκα «quenouille», mais plutôt appartenant à rrok «saisir», rrok për dore «saisir par la main».

rokominë f. «homme desséché par la vieillesse». Non pas de l'it. rocca di camino, mais le même que rrogominë, de rrogomis «faire écrouler, démolir». Cfr. pour le sens le lat. caducus, les frç. déchu, décadent, l'all. hinfällig, etc.

rotâr m. «serviteur, domestique». N'est qu'une forme de rrogêtâr même sens, pas un emprunt au sl. ratar «paysan, agriculteur», comme on a pensé jusqu'à présent.

ruaj rruaj «garder, faire la garde, être en guet, en faction; observer». L'explication de ce mot, comme celle de proj mbroj «protéger» et de trruaj «recommander; blasphémer, maudire», par le sl. chraniti «garder, protéger», a été abandonnée, à bon droit, depuis longtemps. N. Jokl a établi la parenté avec rë, dans vë rë «faire attention, regarder, observer» et resë I. (voir ces deux mots). Pour ruaj, pourtant, est à retenir l'appartenance ultérieure au groupe de l'anc. haut all. biwarōn «surveiller» lat. vereor «éprouver une crainte religieuse ou respectueuse pour; observer craintivement, révéler, respecter, craindre» gr. φρουρός «gardien», etc., proposée par Barić.

rúazë rúezë f. «perle», dans F. Blanchus Ruezatë e shpinëzë «renes». Non pas d'un prétendu *prllazë remontant à l'it. perla (G. Meyer), mais, comme l'a bien remarqué N. Jokl dans une étude posthume (et pour l'it.-alb. rózatë déjà Camarda II 167), un postverbal de ruaj «garder, faire la garde», tout aussi comme le néo-gr. φυλακτήριον «amulette, talisman» appartient à φυλάσσω «garder, conserver».

rukë, dans l'expression arrë rukë «noix dépourvue de l'écorce verte», le verbe rukohem «se raser bien». Appartient à rruaj «raser», tout aussi comme rogë «clairière; petite plaine ou pré de montagne» et rugje «coupé jusqu'à la racine, coupé ras (des cheveux)».

runë f. «partie postérieure de la cheminée». D'une hypostase, ndr unë «entre les tisons».

rus, fém. ruse ruskë «roux, rousse», dit des hommes et du sommier. Mot d'origine incertaine, néo-grecque ou slave. Moins probable une provenance aroumaine.

ryj «entrer». D'après ses acceptions dans l'oeuvre de Buzuku (confugi, accurrerunt, irruerunt), semble être un mot divers de son synonyme hyj, avec lequel on l'a mis en rapport étymologique.

rys «exerciter, expérimenter, rendre habile», **rysem** «gagner de l'expérience». N'appartient pas à **rusem** «descendre» (A. Xhuvani), mais plutôt à **ryej rryej** «souffrir i rryem «rompu, expérimenté, versé» rienj «souffrir», voir ce mot. A confronter pour le sens i **vuar** «homme d'expérience»: **vuj** «courir des périls, souffrir».

ryzë f. «Ruta graveolens, rue». Par opposition à l'autre nom de cette plante (**rutë**), **ryzë**, pour des raisons phonétiques, tire son origine du lat. **rūta** plutôt que de l'it. (ou du slave) **ruta**. Par ce mot l'albanais se rapproche une fois encore des langues romanes occidentales.

Rr

rrafsh m. «plaine», **rrafshój** «aplanir, niveler», i **rrafshët** «plan». Comme on sait, mot d'origine slave. Le nom médiéval du sandjac de Novipazar en Serbie, Raška, en albanais **Rrashi** i **Dukagjinit** «la plaine de **Dukagjin**», dans F. Blanchus (1635, p. 196) «Civitas nova, siuè Ducagina aedificata his nostris temporibus in arduis, asperisq. Albaniae montibus. . .», **Gjytetja e rë, ò Dukagjin**», remonte probablement à ce mot albanais.

rrah m. «essarts», **rrah përdhé** «tué sur place, resté sur le carreau», pluriel **rrahje-t** et **rrihna-t**, voir **Rinas**; me **rrahue** «étendre sur le carreau». Un postverbal de **rrah** «battre, frapper».

rrah «battre, frapper». La connexion avec **rashë**, l'aoriste supplétif de **bie** «tomber; battre, frapper» et, en dehors de l'albanais, avec le vieux sl. **u-raziti** «percutere», par G. Meyer, a été combattue à bon droit par H. Pedersen. N. Jokl le rattache tout aussi au mot slave; mais à l'intérieur de la langue, pourtant, il l'unit à **rras** «entasser, amasser, presser, fourrer avec force.» Doute de Barić. Vasmer combine les deux opinions contraires. D'après M.G. Restelli à comparer à l'anc. ind. **ráksas** «tourment, esprit malin» et au gr. **ἐρέχθω** «briser, déchirer». Une affinité avec le vieux sl. **u-raziti**, russe **rasit**, «battre, frapper», soutenue (entre autres) aussi par M.W. Cimochoowski, et, d'autre côté, notamment avec le gr. **ρᾶτω ράσσω** «heurter, frapper, battre» **ρᾶχία** «flux de la mer se brisant contre les rochers; bord de la mer formé de rochers, de falaises; bruit, tumulte», est pour nous très vraisemblable.

rrallë (i) «rare». En abandonnant la vieille idée d'une origine du lat. **rallus** «sans poils», on est d'accord, et avec raison, que ce mot reflète le lat. **rarus**. Dissimilation des liquides comme dans les reflets de ce mot dans quelques langues et parlars romans de l'Occident.

rrap m. «platane», **rrap i egër** «érable, faux platane». Apparenté au vieux sl. **rëpina** «platane»; ni emprunté à ce mot (G. Weigand), ni un emprunt au sl. **grab** «Carpinus, charme» (**Seliščev**); cfr., après **Miklosich** et G. Meyer, notamment **Jokl Slavia XIII 309 sv.** et **Vasmer REW II 513.**

rrasë f. «pierre plate; table, plaque». Apparenté au dedans de l'albanais à son synonyme **dërrasë** «dalle; pierre plate, p.ex. celles qui recouvrent le toit en guise de tuiles», variante à préfixe **dë-**, ce mot n'est pas l'emprunt de l'it. **terrazza**, ni le proche parent du mot celtique **cymr.**

rhath «plaine» rathu «raboter», mais plutôt un dérivé en -ë de rras «entasser, amasser, presser, fourrer avec force». L'évolution de sens est bien possible.

rrasht, pl. rreshtna «os». Non pas, avec rezhdë «hampe qui pend au cou des chèvres», du lat. arista «barbe d'épis; arête» (G. Meyer), mais tout simplement une forme à préfixe rë- rrë-, de asht «os».

rrashtë f. «crâne», rrashta e breshkës «écaille de la tortue», rrashtinë f. «bonnet, bonnet de feutre». Ni ce mot d'un lat. rastus «σκάφιον», ni rrashtë «boîte à ordures, poubelle» de l'it. rasta rastro, mais au fond un seul mot, et identique à rrasht «os» mentionné ci-dessus. rrashtë a évolué au sens de «crâne» probablement à travers une ellipse de rrashta e kresë, littéralement «l'os de la tête», où a été omis le mot déterminant e kresë. Les autres acceptions du mot sont aussi facilement concevables.

rrë rrā f. «ver, lombric». A rejeter la dérivation du lat. crinālis «concernant les cheveux (G. Meyer) aussi bien que celle du lat. ren renis (Weigand). Tout aussi peu sûr un rattachement au groupe de gr. ῥόμος «ver du bois» lat. vermis, etc. (Barić) ou lat. vergo «inchner, pencher vers» (La Piana), cela pour des raisons d'ordre phonétique, le groupe vr- en position initiale ayant abouti en albanais régulièrement à r-, pas à rr-. Parenté possible avec le lat. corrigia «lacet de soulier; corroie, lanière, fouet», vieux irl. conring «j'attache ensemble» cuimrech «lien», et, en outre, avec le moyen h. all. ric rickes «lien». A confronter, pour le sens, les all. Bandwurm : Band «lien», Spulwurm : Spule «bobine», du domaine roman modén. tzintur, véron. sentanino «ascaride, lombric», du lat. cinctūra, de l'albanais même shirft «ruban, galon» et «ver solitaire».

rrej «mentir, tromper par des mensonges», rrenë f. «mensonge, fausseté», i rrem «mensonger, faux, trompeur». Resté inexplicé dans G. Meyer, combiné par Pedersen avec le gr. ἀρνέομαι «nier, repousser, refuser», et de manières diverses par Barić, ce mot résulte être un post-verbal de rë «nuage», premier sens «obscurcir». Cfr. à cet égard le lat. tenebrio «dupeur» (tenebrae), l'all. hinters Licht führen «duper», le russe moročit, «duper», proprement «obscurcir».

rremb rrem rrëmb m. «rameau, chevilles de la ramure du cerf, ride, bras d'un fleuve, d'un ruisseau; veines d'une pierre». Comme il est établi depuis longtemps, du lat. rāmus. La métaphonie a : e est à considérer de caractère morphologique, tirant son origine du pluriel, rremb représentant ainsi un pluriel singularisé. Le -b final par contre est de nature purement phonétique, son homorganique de m.

rretër rretën f. «cordon long de cuir; lacets des sandales dites opinga ou opanga». Du lat. *retina «rêne», qui survit dans les langues romanes occidentales, et d'autre côté, en néo-grec (N. Jokl). La forme rretat pl. est tout aussi régressive comme drap face à drapër, qepë face à qepër, kudh face à kudhër, dhelpe face à dhelpeër.

rreth m., pl. rrathë «cercle, cercle de tonneau, d'une roue, de la bague», comme adverbe et préposition «autour», rrethój «entourer; assiéger». La thèse d'une parenté avec l'anc. h. all. chreiz all. Kreis a été à bon droit

abandonnée. A retenir par contre la connexion avec l'anc. ind. rátha- «char», anc. irl. roth «roue», lit. rātas «roue, cercle», lat. rota, etc., envisagée dans un premier temps par G. Meyer (ASt I 35) et entrevue déjà par Camarda (I 393). Comme forme de base du mot est à considérer (avec Barić) *rrath. L'actuel rreth est un pluriel singularisé.

rreze f. «rayon; rayon d'une roue». L'opinion qu'en raison du roum. rază, it. razza, esp. raya, frç. raie, etc., il faudrait partir, pour rreze aussi, d'une base latine *radia (du pluriel), ne convainc pas. rreze indique avec son -e un ancien *rraz, comparable au dalm. ruaz «foudre», it. raggio, frç. prov. rai, etc. et remontant, comme tel, au lat. radius ou radium, tout aussi comme gaz «joie; rire» à gaudium. L'actuel rreze représente la forme du pluriel passée au singulier, un pluriel singularisé.

rrëfëj «conter, révéler, avouer, montrer», rrëfëhem «confesser», rrëfim m. «conte, confession.» Ni du lat. confiteri «avouer, confesser» (Miklosich), ni du lat. referre «rapporter, rendre; reproduire, représenter, répéter, répondre» (G. Meyer), mais du grec (plutôt moyen qua moderne) φαίνω «faire paraître, rendre visible, montrer» φαίνομαι «paraître, sembler» (phonétiquement féno fénome), composé en albanais du préfixe rrë-.

rrëfëshk m. «chardon» zog rrëfëshku «chardonneret». Appartient, comme rrë-fësh-k, *rrë-ferr-shk, à ferrë «ronce, roncier, buisson», d'où aussi l'autre nom de cet oiseau, ferrcák. Cfr., pour l'évolution sémantique, le lat. carduelis (de cardus) et ses reflets romans, l'all. Distelfink, etc.

rrëgallë f. «lieu plein de pierres de la montagne, débris de rocher; vallée étroite, ripide et pleine d'éboulis». N. Jokl reporte ragál-a «chenil» à l'anc. macéd. ἀργέλλα οἴκημα μακεδονικόν, ὅπερ θεομαίοντε λούονται, le proche parent du cimmérien ἄργιλλα κατάγειος οἰκία, dont on fait dériver le roum. argea «cabane souterraine, niche; châssis; métier» Rapprochement probablement juste. Mais les toponymes Rgal e Madhe et Kodra Rgâlave sont du groupe de rrëgallë cité ci-dessus, de rragám «grand rocher, roc» avec les toponymes du type Rragám Rogám, rrege «pièce de terrain inculte», qui représente le pluriel singularisé d'un *rrag-. Analyse ultérieure incertaine.

rrëgjój «diminuer, amoindrir», d'où rrëgják «mal développé, petit, anémique», combiné avec gjak «sang». Pas d'un lat. *rodiculare (de rodere), supposé et n'existant nulle part, mais un dérivé verbal de regj «apprêter, tanner les peaux», mentionné si-dessus.

rrënd rrâ rëndës m. «présure», d'où l'aroum. arîndză roum. rînză, pénétré aussi en ukrainien. Rattaché par G. Meyer à rëndë «pesant, lourd, difficile», ce mot a été réuni par N. Jokl à rend «courir», et, en dehors de l'albanais, au groupe germanique de got. rinnan «couler, courir» all. gerinnen «se coaguler», etc. A rejeter l'étymologie latine (ren renis) proposée par G. Weigand. Le sens primitif du mot peut être pourtant celui de la caillette. A rrënd rrâ appartient rrashkë «caillette; panse», en albanais de Calabre (Variboba) «jonchère».

rrënjë rranjë rrâjë f. «racine; souche», rrëzë rrânzë même sens, rr. mali «base, pied de la montagne», rrëzój «démolir, abattre, détruire de

fond en comble». Pas un mot latin, rrënjë d'un *râdicia, rrëzë d'un *râdica, etc. Comme l'a remarqué L. Spitzer, mot des sources autochtones, issu d'un * uradniâ, et comme tel apparenté au lat. radix gr. **ράδαμνος** «jeune branche, rejeton», etc. Des deux formes du mot, rrënjë, en tel que nom d'une espèce de chêne, a passé, comme **ρένια**, en grec moderne (Vasmer), peut-être à travers l'albanais de Grèce. A ce même mot appartient rrë m. «sapin, arbre», dans G. Meyer p. 372.

rrëshék m. «outre; soufflet (de forgeron)». Mot d'une richesse protéiforme de variantes: rrëshék, rrëshiq, shek, shiq, shakull, shérkëtë, etc., lesquelles n'emmènent d'aucune façon au serbo-cr. mjesić «outre». Elles se reportent à shakull et en dernière analyse à shark, voir ces deux mots.